

## E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2003

### Në këtë numër:

#### Reforma Institucionale dhe Integrimi European

- Reforma në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes
- Integrimi European - një proces transformimi për gjithë shoqërinë shqiptare

#### E Drejta Kushtetuese

- Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në frymën e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut
- Administrimi ndërkombëtar në Kosovë (dilemat dhe kontraverset)

#### E Drejta Parlamentare

- Hetimi ad hoc parlamentar i Shërbimit Informativ Shtetëror

11

Botim i Qendrës së Studimeve  
Parlamentare

# PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XI, viti 2003

	Faqe
Reforma institucionale dhe integrimi europian:	
Reforma në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, prioritet për Shqipërinë Dr. Alfred MOISIU President i Republikës së Shqipërisë	4
Integrimi European – një proces transformimi për gjithë shoqërinë shqiptare Marko BELLO	16
E Drejta Kushtetuese:	
Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në frymën e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut Sokol SADUSHI	28
Administrimi Ndërkombëtar në Kosovë (dilemat dhe kontraverset) Prof. Dr. Arsim BAJRAMI	42
E Drejta Parlamentare:	
Hetimi ad hoc parlamentar i shërbimit informativ – Një përvojë e re shqiptare e përqasur me legjislacionin europianoperëndimor Fatos BEJA	65
Nga punimet e Kuvendit:	
Nga punimet e Kuvendit për periudhën tetor – nëntor 2002 Ariana MERO	77
Informacion mbi legjislacionin e miratuar Filip LAKO	88
Përmbledhje në anglisht:	
Reforma në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, prioritet për Shqipërinë Dr. Alfred MOISIU President i Republikës së Shqipërisë	100
Informacion mbi legjislacionin e miratuar	112

## TABLE OF CONTENTS

---

11<sup>th</sup> Issue, year 2003

	Page
<hr/>	
Institutional reform and European Integration:	
Reforms on the security and defense sphere, Albania's priorities Dr. Alfred MOISIU President of the Republic of Albania	4
European Integration – a transforming process for the whole Albanian society Marko BELLO	16
<hr/>	
Constitutional Law:	
Jurisprudence of the Constitutional Court in the light of European Convention of Human Rights Sokol SADUSHI	28
International Administration in Kosovo (dilemmas and controversies) Prof. Dr. Arsim BAJRAMI	42
<hr/>	
Parliamentary Law:	
Parliamentary ad hoc inquiry of the intelligent service – An Albanian experience approach to the European legislation Fatos BEJA	65
<hr/>	
Parliamentary proceedings:	
Report on parliamentary proceedings in the period October – November 2002 Ariana MERO	77
Information on laws passed by the Assembly Filip LAKO	88
<hr/>	
Summary in English:	
Reforms on the security and defense sphere, Albania's priorities Dr. Alfred MOISIU President of the Republic of Albania	100
Information on laws passed by the Assembly	112

---

*Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizmin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studjuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanëshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.*

*Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.*

## **Reforma në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, prioritet për Shqipërinë**

*Fjala e Presidentit të Republikës Dr. Alfred Moisiu në Konferencën Ndërkombëtare “Forcimi i kontrollit demokratik në Forcat e Armatosura”, më 15 nëntor 2002*

*Zonja dhe zotërinj,*

Në radhë të parë dëshiroj t’ju falënderoj për organizimin e kësaj Konference dhe për ftesën që më bëtë për të ardhur e mbajtur këtë bisedë me ju për çështjet e sigurimit të vendit dhe të reformimit të Forcave tona të Armatosura. Çështjet e sigurisë janë komplekse, por në këtë prezantim do të përpiqem të trajtoj disa nga problemet kryesore të cilat, për mendimin tim, kanë një rol prioritar për Sigurimin e Mbrojtjen, jo vetëm në aspektin e brendshëm, por edhe në atë rajonal.

Aktualisht ne kemi miratuar në janar të vitit 2000 dokumentin “Strategjia e Sigurimit dhe Politika e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë”. Më datë 9 gusht të këtij viti dekretova dokumentin “Strategjia Ushtrake e Republikës së Shqipërisë”, miratuar nga Kuvendi më datë 25 korrik 2002. Këto dokumente janë një reflektim serioz mbi gjendjen aktuale gjeopolitike të mjedisit ku jetojmë, të rreziqeve dhe këcënimeve që ekzistojnë realisht ndaj sigurisë sonë kombëtare, të mundësive politike, ekonomike, legjislativë, ushtarake, pra, janë një analizë realiste e fuqisë sonë kombëtare, për t’i parandaluar e për t’i përballuar ato në rast se ndodhin. Këto dokumente janë, gjithashtu, edhe një dëshmi tjetër se vendi ynë është i interesuar e do të punojë me të gjitha energjitë e tij për stabilitetin dhe paqen në rajonin tonë, si dhe do t’i përmbahet me rigozitet detyrimeve të tij ndërkombëtare.

Republika e Shqipërisë ndodhet pikërisht në një mjedis gjeopolitik, ku historikisht ka pasur fenomene të ndjeshme. Vetëm gjatë dekadës së fundit përjetuam konflikte të njëpasnjëshme, të cilët kanë dëmtuar ndjeshëm besimin reciprok midis popujve të rajonit, kanë shkaktuar dëme të panumërta njerëzore e materiale, kanë dëmtuar institucionet politike, ekonomike, sociale e ushtarake të rajonit. Shumë nga këto efekte negative duan kohë të rigjenerohen.

Sot mundësia e konflikteve ndërshtetërore në rajon është ulur dhe siguria është rritur e mbahet më mirë nën kontroll nga prezenca aktive e NATO-s dhe e Bashkimit Europian. Ka një rritje të ndërgjegjësimit të popujve se duhet hequr dorë një herë e përgjithmonë nga logjika e konfrontimit, nga dëshira e dominimit të një etnie në dëm të një tjetre, nga mbështetja e atyre rrymave regresive që manipulojnë me ndjenjat patriotike e nacionaliste të njerëzve dhe, që si mjet të vetëm për zgjidhje, shikojnë vetëm dhunën. Ka arritje të rëndësishme edhe në fushën e bashkëpunimit ekonomik, kulturor, ushtarak midis vetë vendeve të rajonit, deri në krijimin e një Brigade të Europës Juglindore (SEEGRNG).

Por, rreziqet që janë shfaqur në dhjetëvjeçarin e fundit, si: nacionalizmat ekstreme, rivalitetet etnike dhe fetare, përdorimi i forcës në vend të dialogut, shkelja e të drejtave të komuniteteve etnike brenda shteteve, kthimet prapa ose dështimet e reformave demokratike etj., mund të vazhdojnë të jenë prezente edhe në të ardhmen. Këto rreziqe mund të përkeqësohen edhe prej krizave sociale, ekonomike e politike. Kjo gjendje e ngarkuar me tensione të natyrave të ndryshme mund të përcillet lehtësisht nga një shtet i caktuar i rajonit në shtete fqinj të tij. Efekte të tilla mund të shoqërohen me efekte pasuese, si tensione, provokime dhe sidomos flukse refugjatësh. E marrë në tërësi, pra, situata aktuale e sigurisë në rajon, megjithëse nuk rezulton me ndonjë kërcënim direkt imediat ndaj vendit tonë, paraqitet e brishtë, komplekse dhe e mbarsur me rreziqe e kërcënime për sigurimin kombëtar e rajonal.

Vendi ynë nuk e shikon sigurinë kombëtare si të shkëputur nga ajo

rajonale, por të lidhur ngushtë e të ndërvarur në një masë të konsiderrueshme prej saj. Për këtë arsye ai është i interesuar që në rajon të mbretërojë paqja e stabiliteti, të mbretërojë bashkëpunimi dhe integrimi.

Sot, tre vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, vërejmë me kënaqësi se situata atje po shkon gjithnjë e në konsolidim. Zgjedhjet e lira më 17 nëntor 2001, ato të 26 tetorit 2002 nën kujdesin e drejtpërdrejtë të UNMIK-ut, KFOR-it, OSBE-së e organizatave të tjera ndërkombëtare, si dhe krijimi për herë të parë i institucioneve që do të qeverisin Kosovën janë hapa të sigurt drejt forcimit të stabilitetit e paqes në rajon. Mendoj se po ecet drejt edhe me gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme nga të gjitha palët për problemin e Mitrovicës. Plani “Shteiner” për Mitrovicën dhe për decentralizimin janë masa të mira që sigurojnë një demokratizim të shpejtë dhe të sigurt të jetës shumetnike në Kosovë. Sikurse dihet, bashkekzistenca midis etnive atje është e cënuar gjatë shumë dhjetëvjeçarëve, por në mënyrë të veçantë, u cënuar pas vitit 1981, duke arritur kulmin e tij në vitin 1999.

Përsa i përket statusit të ardhshëm të Kosovës, ky është një problem ndërkombëtar, pasi vetë Kosova është protektorat ndërkombëtar. Në këtë drejtim duhet respektuar gjithnjë rruga institucionale. Kjo nënkupton rritjen graduale të kompetencave për organet e zgjedhura demokratikisht, fitimin progresiv të përvojës në qeverisje dhe forcimin demokratik të strukturave të vendit. Një gjë e tillë, mendoj, do të mundësonte hap pas hapi krijimin e mjedisit të duhur, për t’iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të lirisë njerëzore e ekonomike, tolerancës multietnike dhe shoqërisë demokratike në tërësi. Në këtë kohë edhe kushtet do të jenë pjekur për të diskutuar në mënyrë më të frytshme statusin përfundimtar, jo vetëm si shprehje e një referendumi popullor brenda Kosovës, por edhe si zbatim realist i konventave ndërkombëtare në fuqi. Çdo këndvështrim tjetër, siç është përcaktimi i ri në projektkushtetutën mes Serbisë dhe Malit të Zi, është i papranueshëm dhe nuk i shërben zgjidhjes së problemeve, zhvillimeve demokratike dhe stabilitetit politik rajonal.

Mendimi im është se një stabilitet sa më i qëndrueshëm në Ballkan do të arrihet nëpërmjet zhvillimit të sistemeve politike të qëndrueshme, me objektiva bazë ato të integritimit euroatlantik. Për të gjitha vendet e rajonit tonë është një sfidë e madhe, që të punojmë për të ndërtuar e forcuar kudo në Shqipëri e Kosovë, në Mal të Zi e Serbi, Maqedoni e Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë një model të ri qytetarie, pra, të qytetarisë europiane. Në këtë drejtim nismat më të rëndësishme janë ato të integritimit rajonal dhe euroatlantik, të cilat duhet të mbështeten fuqimisht me angazhime më serioze dhe më konkrete.

Përsa i përket integritimit rajonal, mendoj se tri janë drejtimet kryesore:

1. Forcimi i marrëdhënieve dhe i fqinjësisë së mirë, duke i zgjidhur me mirëkuptim e mjete paqësore, mosmarrëveshjet që mund të lindin, mbështetur në të drejtën ndërkombëtare; bashkëpunimi me synim ndalimin e përhapjes së pakontrolluar të armëve, të përballimit sa më efikas të emergjencave civile, krijimin e përmirësimin e masave për gjetjen e mekanizmave sa më të përshtatshëm të ndërveprimit në fushën e sigurisë.

2. Vendosjen në baza sa më të shëndosha të bashkëpunimit ekonomik, për të përballuar së bashku sfidat e ndryshme, veçanërisht në luftën kundër varfërisë, streseve sociale e ndotjes së ambientit. Vazhdimi i punës për jetësimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit dhe për projektet e përbashkëta të infrastrukturës, sidomos për ndërtimin e “Korridorit 8”.

3. Demokratizimi i mëtejshëm i shoqërive tona, çka do të thotë rritje e vlerave demokratike, zbatim në praktikë gjithnjë e më mirë i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe, mbi të gjitha, lufta e përbashkët ndaj dukurive në shkallë botërore si krimi i organizuar, pastrimi i parave, trafiku ilegal i armëve, drogës dhe i qënieve njerëzore.

Në rrugën drejt integritimit në strukturat euroatlantike, gjykoj se të gjitha vendet e Ballkanit duhet të përmbushin dy objektiva madhore: Të synojnë të ngrenë standardet e tyre në nivelin e standardeve të NATO-s dhe BE-së



dhe, mbi të gjitha, të plotësojnë hap pas hapi kushtet për futjen dhe integrimin e plotë në këto dy struktura. Kjo është e vetmja mënyrë për përparim, stabilitet e paqe të qëndrueshme.

Nga ana e saj, Shqipëria, në përputhje me këto dy sfida madhore për rajonin tonë, do të jetë gjithnjë e gatshme të bashkëpunojë me çdo shtet e strukturë. Në të kundërt, çdo përpjekje për të shkuar kundër ose për t'u larguar nga këto dy objektiva është e destinuar të dështojë. Si mekanizma institucionalë kryesorë për momentin kemi Procesin e Stabilizim-Asociimit, Partneritetin për Paqe dhe Planin e Veprimit për Anëtarësim në NATO.

Siç jeni në dijeni, më datë 21 tetor 2002 Këshilli i Ministrave i BE-së vendosi të hapë negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Shqipërinë. Ky vendim përbën hapin më të madh që vendi ynë ka bërë deri më sot drejt integrimit në strukturat euroatlantike, por, njëkohësisht, është edhe një tregues i pakontestueshëm se kapacitetet integruese të vendit tonë kanë njohur një stad të ri zhvillimi.

Aktualisht ndodhemi vetëm pak ditë larg mbledhjes së nivelit të lartë të vendeve anëtare të NATO-s që do të mbahet më 21-22 nëntor në Pragë. Siç e dini, në rendin e ditës së këtij Samiti është edhe pranimi i anëtarëve të rinj të Aleancës Atlantike, gjë për të cilën opinioni ynë është shumë i ndjeshëm dhe mbështet të gjitha përpjekjet që shteti dhe Qeveria jonë po bëjnë për anëtarësim në NATO.

Integrimi i vendit në strukturat euroatlantike mbetet objektivi ynë strategjik dhe përputhet me interesat kombëtarë të vendit. Kjo do të forcojë më shumë stabilitetin jo vetëm brenda vendit, por edhe në rajon. Konsensusi i plotë politik që ekziston midis të gjitha forcave politike dhe mbështetja e gjerë publike për anëtarësimin e vendit në Aleancën Euroatlantike përbën një pikë të fortë në mbështetje të këtij procesi. Integrimi në NATO konsiderohet jo vetëm si objektivi, por edhe si një përgjegjësi kombëtare që shoqërohet me përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimin. Në këtë kuadër, ne po punojmë për të realizuar në kohë dhe me cilësi të gjitha angazhimet

tona, të cilat jepen në mënyrë të sintetizuar në Planin e Veprimit për Anëtarësimin në NATO.

Shqipëria ndan të njëjtat vlera me ato të Aleancës dhe të vendeve të saj anëtare. Ne konsiderojmë si treguesin tonë të përbashkët respektin për shtetin ligjor, vlerat e demokracisë, të drejtat e njeriut, të sigurisë dhe të ekonomisë së tregut. Qëllimi i Shqipërisë është jo vetëm të përfitojë nga avantazhet e sigurisë që ofron pjesëmarrja në NATO, por, gjithashtu, të jetë kontribuese në politikat dhe veprimet e Aleancës.

Në funksion të kësaj të fundit, një kompani shqiptare ndodhet me mision në kuadër të SFOR-it në Bosnjë-Hercegovinë, ndërsa një togë jona tashmë ka marrë detyrën dhe po kryen misionin e saj në Kabul të Afganistanit, krahas forcave të tjera që marrin pjesë aktivisht në luftën kundër terrorizmit. Gjithashtu, sidomos nga viti 1999 e në vazhdim, vendi ynë ka qenë një partner aktiv dhe besnik i Aleancës, duke vënë në dispozicion të misioneve të saj çdo gjë që i kërkohej. Për të ardhmen janë planifikuar dhe janë marrë të gjitha masat, në mënyrë që, gradualisht, ne t'i shtojmë nënrepartet, repartet dhe mjetet nga të trija llojet e forcave, për veprime në të mirë të operacioneve që do të drejtohen nga NATO. Prandaj mendoj se Shqipëria e ka të drejtën që të pretendojë, që në këtë mbledhje, për t'u ftuar për anëtarësimin në NATO ose të jetë kandidat e sigurt në Samitin e ardhshëm, mundësisht edhe me vende të tjera të rajonit.

Megjithatë, në Samitin e Pragës vlerësimi do të jetë kompleks dhe duhet të jemi realistë për vetë rrugën e gjatë që kemi përpara, për të arritur atë nivel zhvillimi ekonomik e ushtarak që mundëson integrimin lirisht në strukturat e Aleancës. Pavarësisht nga vendimi që do të merret, ne do ta përshëndesim atë, do të vazhdojmë në rrugën e progresit që kemi nisur për të përmbushur më mirë standardet e NATO-s dhe do të jemi partnerë seriozë. Dita e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO nuk do të jetë e largët.

Zonja dhe Zotërinj,

Për afro gjysmë shekulli Shqipëria ka pasur një sistem qeverisës

dikatorial e shumë të centralizuar; lidhjet e saj me botën ishin në minimum. Shpenzimet në fushën ushtarake shpesh ishin jashtë logjike dhe dëmtuan rëndë përparimin ekonomik të vendit. Pas vitit 1990 Shqipëria bëri shumë përpjekje dhe iu fut rrugës së reformave politike, ekonomike, shoqërore, ushtarake etj., të cilat në vitin 1996 e çuan atë pranë dyerve të NATO-s dhe të BE-së. Ky përparim u dëmtua seriozisht me ngjarjet e vitit 1997, pas skandalit të skemave piramidale, të cilat gllabëruan rreth 60 për qind të kursimeve të popullit. Në vitin 1998 institucionet shtetërore pësuan përkohësisht një goditje tjetër. Jemi dëshmitarë se në momente të veçanta u cënua siguria dhe funksionimi i shtetit. Një tjetër vonesë në zhvillimin tonë u krijua në vitin 1999, gjatë konfliktit të Kosovës, me fluksin e rreth 500 mijë kosovarëve të shpërngulur me dhunë, numër ky i barabartë me 15 për qind të popullsisë së Shqipërisë.

Megjithatë, gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit vendi ynë shënoi një përparim thelbësor në zbatimin e shumë reformave strukturore dhe institucionale, të cilat ishin të domosdoshme për ndërtimin e një sistemi qeverisës demokratik, përfshirë këtu edhe fushën e lirisë e të drejtave të njeriut, të medias së lirë e të pavarur, ndarjes institucionale të pushteteve, decentralizimit të pushtetit vendor etj. Mbas një dekade tranzicioni të vështirë, vendi ynë ka hyrë tashmë në rrugën normale të demokracisë, të zhvillimit më të shpejtë të ekonomisë, të uljes së varfërisë e të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Pra, si shumë vende të rajonit, Shqipëria është duke u konsoliduar në një proces të vazhdimt të reformave, të cilat kërkojnë kohë dhe përpjekje të vazhdueshme. Megjithëse zhvillimi i vendit ka marrë përfundimisht drejtim pozitiv, nuk përjashtohet mundësia e shfaqjes së rreziqeve të brendshme që, siç e ka treguar eksperiencia e dekadës së kaluar, nuk janë zhdukur përfundimisht. Nëse nënvleftësohen, ato mund të shfaqen dhe të përshkallëzohen në destabilitet, lindin tensione, kriza e konfrontime të niveleve të ndryshme. Disa prej tyre, që mund të kërcënojnë stabilitetin dhe sigurinë

e brendshme, mund të jenë trafiket e paligjshme të të gjitha llojeve, krimi i organizuar, ekzistenca e një pjese të armëve akoma në duart e popullsisë, lëvizja e pakontrolluar e njerëzve, korrupsioni, mangësitë në konsolidimin e funksionimit të institucioneve të shtetit ligjor, çështjet social-ekonomike, papunësia etj. Individët dhe grupet që qëndrojnë pas tyre do të vazhdojnë të sofistikojnë metodat, për të ushtruar veprimtari të paligjshme. Veçanërisht, në momente të pasigurisë së shtetit ligjor, të destabilitetit, si dhe të mungesës së kontrollit më të lartë të kufirit shtetëror, veprimet e tyre mund të intensifikohen dhe mund të rëndojnë më tej situatën e sigurinë.

Në këtë aspekt, dua të theksoj nevojën e një pune më të kualifikuar, sidomos përsa i përket parashikimit në kohë të situatave të padëshirueshme dhe të marrjes së masave për parandalim.

Ka ikur tashmë koha kur sigurimi i një vendi imagjinohej vetëm si sigurimi i territorit të shtetit nga ana e ndonjë agresioni të mundshëm ushtarak. Koncepti i sigurisë ka marrë një kuptim më të gjerë nga ai që ka pasur më parë. Pra, krahas ruajtjes së kufijve të shtetit, a është i sigurt populli që jeton brenda këtyre kufijve, a është i çliruar ai nga krimi, nga mungesa e ushqimit, e strehimit, nga rreziku i epidemive, a i ka liritë politike e fetare, a jeton secili i barabartë brenda shtetit, pavarësisht nga përkatësia politike, fetare a etnike?

Jo shumë larg, por vetëm 2-3 muaj më parë ne u ballafaquam seriozisht me 2 fenomene të brendshme, të cilat, në rast se nuk do të kishim marrë masa energjike për t'i përballuar, mund të acaroheshin e të shndërroheshin në cenim direkt për sigurinë e vendit. Në muajin gusht me mijëra shqiptarë që punojnë në Greqi u bllokuan disa javë në pikat doganore të Kakavijës dhe Kapshticës, duke krijuar një situatë tepër të rëndë morale, shëndetësore, ekonomike, të fqinjësisë së mirë etj. Pati edhe një të vdekur dhe rreziku sa vinte e po rritej.

Rasti i dytë është ai i përmytjeve që ndodhën në muajin shtator, ku disa rrethe në veri e në jug të vendit, si pasojë e përmytjeve masive, pësuan dëme të konsiderueshme në të mira materiale shtetërore e private dhe situata

për pak mund të shndërrohej nga emergjencë vendore në një emergjencë kombëtare.

Në të dyja rastet që përmenda, shtroj pyetjen: A mund të parandaloheshin? Përgjigjja ime është po. Ne i kemi mundësitë që të parashikojmë, të planifikojmë e të marrim të gjitha masat parandaluese ose të paktën të marrim masa zbutëse, ndaj efekteve negative të fenomeneve që përmenda më lart. Në radhë të parë është e nevojshme që ne të kemi një koncept të ri për parandalimin, të planizojmë fonde e organizma të posaçëm, mbi bazën e një plani e përvoje të studiuar e të argumentuar mirë. Ligjet nuk mungojnë dhe diçka po lëviz në këtë drejtim, pasi siç thotë populli ynë, pësimi bëhet mësim, po theksoj se kjo ka rëndësi jo të vogël edhe në çështjet e sigurimit të vendit.

Këshilli i Ministrave miratoi në nëntor 2001 Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikut Ilegal dhe Qënieve Njerëzore, që ishte rezultat i ndihmës dhe bashkëveprimit me disa institucione ndërkombëtare dhe disa shtete. Ajo përmban detyrime për të gjitha strukturat ekzekutive shqiptare dhe siguron mjetet dhe mënyrat për parandalimin e trafikut ilegal. Përpjekjet kanë synuar që të parandalojnë dhe ta luftojnë krimin e organizuar, duke forcuar edhe bashkëpunimin rajonal. Vitin e kaluar u krijua në Vlorë Qendra Ndërkombëtare për Luftën kundër Trafiqueve.

Një goditje e fortë iu dha krimit të trafikut të qenieve njerëzore gjatë muajit gusht të këtij viti, me ndërmarrjen e një aksioni të fuqishëm gjatë gjithë bregdetit shqiptar dhe në terren për kapjen dhe sekuestrimin e skafeve dhe ndalimin e elementëve që organizojnë trafikun njerëzor, të drogës dhe trafique të tjera të paligjshme. Rezultatet ishin mjaft të mira për shkak edhe të bashkërendimit të mirë të punës midis strukturave të Ministrisë së Rendit, Ministrisë së Mbrojtjes dhe të strukturave të tjera shtetërore. Goditje të tilla ndaj këtij trafiku do të përbëjnë një angazhim të vazhdueshëm të strukturave tona të Rendit e më gjerë.

Duke njohur arritjet e kësaj lufte, Departamenti Amerikan i Shtetit në

“Raportin për trafikun njerëzor” për periudhën prill 2001 - mars 2002 e klasifikon Shqipërinë në vendet e grupit të dytë.

Siç u shpreha në fillim, më 9 gusht 2002, unë dekretova dokumentin “Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë”, në të cilin bëhet fjalë për programin e zhvillimit të Forcave tona të Armatosura deri në vitin 2010.

Tipari themelor i Strategjisë Ushtarake është natyra dhe karakteri i saj thellësisht mbrojtës. Ajo prezantohet dhe zbatohet si strategji jokërcënuese ndaj fqinjve të saj dhe komunitetit ndërkombëtar. Ajo inkurajon rritjen e bashkëpunimit dypalësh e shumëpalësh me forcat e tjera të rajonit, si dhe pjesëmarrjen në stërvitjet e përbashkëta, operacionet e mbështetjes së paqes në kuadrin e Programit të Partneritetit për Paqe dhe të Brigadës Shumëkombëshe të Europës Juglindore.

Ky programim u krye nga specialistët tanë në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të NATO-s dhe të SHBA-së. Ai merr në konsideratë mjedisin e ri të brendshëm, rajonal dhe global, të krijuar gjatë dekadës së fundit. Dokumenti është në përputhje të plotë dhe reflekton filozofinë e Konceptit të ri Strategjik të Aleancës që u miratua në Samitin e Uashingtonit në prill 1999.

Strategjia Ushtarake thekson krijimin e një force me orientim perëndimor që bazohet mbi konceptin e profesionalizmit, pra, synohet cilësia në vend të sasisë. Dokumenti parashikon zvogëlimin e forcës aktive të kohës së paqes nga 31, 000 vetë në rreth 16, 500 dhe të forcës së kohës së luftës nga 120, 000 vetë në rreth 35, 000.

Reforma që po kryejmë në Forcat tona të Armatosura mbështetet në dy shtylla kryesore:

- Në misionet që ato duhet të përmbushin në mjedisin e ri të sigurisë kombëtare e rajonale.

- Në resurset reale që ka mundësi vendi të verë në dispozicion të mbrojtjes.

Qeveria për herë të parë e përfshiu mbrojtjen në Planin Afatmesëm të Shpenzimeve 2003-2005. Buxheti në fushën e mbrojtjes sot zë 1.2 për

qind të GDP-së. Ky buxhet do të rritet çdo vit me 0.1 për qind, në mënyrë që në vitin 2010 të arrihet në 2 për qind të GDP-së, shifër kjo që i korrespondon mesatares së vendeve anëtare të NATO-s

Strategjia Ushtarake mbështet zhvillimin dhe forcimin me përparësi të strukturave për misione humanitare, për mbrojtjen dhe ndihmën e popullsisë civile në situata të vështira natyrore, industriale ose të shkaktuara nga njeriu.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton qartë se “Forcat e Armatosura ruajnë asnjësinë në çështjet politike dhe i nënshtrohen kontrollit civil.” Aktualisht është siguruar plotësisht kontrolli demokratik në Forcat e Armatosura. Presidenti i Republikës, Kryeministri e Ministri i Mbrojtjes janë të zgjedhur demokratikisht. Buxheti i mbrojtjes, pjesëmarrja e forcave tona ushtarake në misione paqeruajtëse ose legjislativoni në fushën e mbrojtjes miratohen nga Kuvendi.

Në kuadër të forcimit të kontrollit demokratik në Forcat e Armatosura, mendoj se ka ende nevojë për një ndërgjegjësim më të lartë e për një përgjegjësi më të madhe për zhvillimin e sistemit të ri të sigurisë dhe të mbrojtjes. Shpesh përfaqësues të klasës politike nuk e kuptojnë sa duhet rolin dhe peshën që kanë në këtë proces. Roli i tyre është vendimtar. Ata mund të bllokojnë procesin, mund ta ngadalësojnë, ashtu si edhe mund ta përshpejtojnë atë.

Siç e dini, sigurimi i vendit nuk është thjesht një detyrë ekskluzive vetëm e Forcave të Armatosura. Sigurimi i vendit është kompleks dhe kërkon njohjen, zbatimin e harmonizimin e mjaft masave në fushën e politikës, të diplomacisë, ekonomisë, legjislativoni, mbrojtjes, rendit publik, shëndetësisë, ruajtjes së mjedisit etj. Zhvillimet e kohëve të fundit, shumëllojshmëria e krizave dhe luftërave, shpërndarja gjeografike e tyre, krimi i organizuar, trafiket e paligjshme, terrorizmi etj. e kanë rritur së tepërmi ndërvlerësinë e të gjithë faktorëve që përmenda më sipër. Prandaj, për të interpretuar e harmonizuar gamën e gjerë të funksioneve të përbashkëta të shtetit e shoqërisë, sot përdoret termi politikë ose strategji e sigurimit, e cila, në një

shoqëri demokratike, siguron mundësitë më të mëdha për arritjen e suksesit, por edhe që pranohet e mbështetet nga populli.

Të gjitha këto realizohen nga drejtues civilë dhe ushtarakë së bashku, të cilët kërkohet që të njohin në nivel të lartë, krahas të tjerave, edhe çështjet e sigurimit e të mbrojtjes. Aktualisht, kemi shumë ushtarakë të kualifikuar në vendet anëtare të NATO-s, ndërsa, përsa u përket civilëve, kemi një numër të kufizuar. Në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në sturktura të tjera të larta të shtetit punojnë civilë, të cilët drejtojnë sektorë të rëndësishëm dhe që merren direkt me çështjet e sigurisë e të mbrojtjes së vendit.

Për t'i bërë ballë pikërisht atyre sfidave që përmenda më lart, si në aspektin e sigurimit rajonal, ashtu edhe në aspektin e sigurisë së brendshme, është e nevojshme që edhe kontigjenti civil të jetë i kualifikuar. Në të mirë të kësaj detyre, në vitin 1995 u krijua Kolegji i Mbrojtjes, të cilit iu vu si detyrë kualifikimi i drejtuesve të lartë civilë e ushtarakë në fushën e sigurimit kombëtar e rajonal. Ky Kolegj funksionoi e organizoi dy kurse, një në vitin 1995 dhe tjetri në vitin 1996. Më pas u ndërpre për arsye të ngjarjeve të vitit 1997 dhe rifilloi përsëri këtë vit, ku u kualifikuan, krahas ushtarakëve të lartë të Forcave të Armatosura, edhe civilë, midis tyre edhe deputetë, drejtues të lartë nga ministri të ndryshme si ajo e Drejtësisë, Ministrisë së Rendit, gazetarë, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse etj. Dua me këtë rast të përshëndes Ministrinë e Mbrojtjes për rifillimin e Kolegjit të Mbrojtjes, si dhe ta inkurajoj që ky kurs të vazhdojë e të përsoset më tej, pikërisht për të përgatitur kontigjentet e nevojshme në përballimin me sukses të sfidave që shtrohen para nesh në fushën e sigurimit e të mbrojtjes së vendit.

Ju faleminderit për vëmendjen!



## **Integrimi European – një proces transformimi për gjithë shoqërinë shqiptare**

*Marko Bello  
Deputet*

“E duam Shqipërinë si gjithë Europa!” Kjo ishte dëshira kryesore e studentëve shqiptarë në fund të vitit 1990, me të cilët u bashkuan dhjetëra e qindra mijëra vetë për të kërkuar rrëzimin e regjimit diktatorial komunist. Që nga ai moment, kur shqiptarët zgjodhën pa ekuivok rrugën e pluralizmit, të ekonomisë së tregut dhe shtetit të së drejtës, nuk është vënë ndonjëherë në dyshim se përparësia e shoqërisë dhe e politikës shqiptare ka qenë dhe vazhdon të jetë integrimi në strukturat europiane dhe euroatlantike.

Në këtë kontekst, integrimi european ka qenë përcaktuar nga qeveritë shqiptare paskomuniste jo vetëm si një objektiv strategjik, por edhe si një instrument që mund ta çojë shoqërinë shqiptare në nivelet dhe standardet që ajo aspirojnë dhe meriton. Për këtë arsye ne e konsiderojmë integrimin në Europë si angazhimin më të rëndësishëm dhe investimin më me vlerë për të sotmen dhe të ardhmen e vendit. Procesi fillimisht ka nisur me anëtarësimin e Shqipërisë në OSBE dhe më pas në Këshillin e Europës ose Organizatën Botërore të Tregtisë. Megjithatë, Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit e vitit 1992 mbetet dokumenti themelor që ka rregulluar deri tani marrëdhëniet e bashkëpunimit të vendit tonë me BE-në.

Ideja e një përqasjeje serioze të Europës ndaj Ballkanit e ka zanafillën gjatë konfliktit në Bosnjë në vitin 1992, kur Kryeministri i atëhershëm i Francës, Eduard Baladyr përmendi për herë të parë idenë e një Pakti

Stabiliteti, i cili do të mund të sillte paqen e qëndrueshme në këtë rajon të trazuar dhe do ta afronte atë me Europën, duke krijuar aty faktorë sigurie, qëndrueshmërie, bashkëpunimi dhe zhvillimi. Por, ishte konflikti i Kosovës ai që krijoi bindjen se një projekt integrues dhe afatgjatë mbareuropian për Europën Juglindore përbënte tashmë një domosdoshmëri për ta shkëputur rajonin nga e kaluara dhe për ta lidhur me pjesën tjetër të Europës. Në atë kohë, Bashkimi European bëri të njohur për Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit “Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit”, si rruga për arritjen e Marrëveshjeve të Stabilizimit dhe Asociimit. Këto marrëveshje janë një lloj i ri marrëdhëniesh bashkëpunimi me BE-në, të cilat marrin parasysh situatën e veçantë të çdo vendi të Ballkanit Perëndimor dhe përbëjnë hapin e parë formal drejt anëtarësimit të plotë në strukturat europiane. Ky qëndrim i ri konfirmon edhe njëherë ndihmën dhe kontributin e vazhdueshëm të BE-së për reformat demokratike në Shqipëri, të cilat ne i vlerësojmë sinqerisht. Duhet theksuar se marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në nuk janë kufizuar vetëm në këto marrëdhënie kuadër me karakter programor, por kanë konsistuar në hapa konkretë me karakter operacional, ecuria e të cilave është vlerësuar në takimet periodike dypalëshe. Në këtë drejtim, përcaktimi dhe realizimi i përparësive strategjike dhe operacionale është patur vazhdimisht parasysh. Në përputhje me procedurat e hapjes së negociatave me Bashkimin European, Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit është paraprirë nga këto faza:

- Në nëntor 1999, Komisioni European miratoi Studimin e Fizibilitetit, i cili krijoi premisa që pala shqiptare të mund të përcaktonte vetë shpejtësinë e afrimit të mëtejshëm me Bashkimin European.
- Në mars 2000 Shqipëria bëri të njohur në Shërbimet e Komisionit European Status Raportin, i cili përmbante masat konkrete që do të ndërmerre Qeveria Shqiptare në fushën e reformave.
- Në nëntor 2000, u zhvillua Samiti i Zagrebit, i cili u iniciua nga Presidenca Franceze e Bashkimit European, synimet e së cilës në këtë Samit kishin të bënin me arritjen e një opinioni të përbashkët mbi orientimet për një

politike globale të BE-së në rajon. Për Shqipërinë, Samiti i Zagrebit mori vendimin për krijimin e Grupit Drejtues të Nivelit të Lartë BE – Shqipëri, i cili u ngrit për të vlerësuar arritjet dhe progresin e reformave në Shqipëri, si dhe të jepte rekomandime për hapat që Qeveria Shqiptare duhet të ndërmerre për përshpejtimin e Procesit të Stabilizim Asociimit.

- Në fund të punës së këtij Grupi u hartua dhe u dorëzua raporti në Këshillin European gjatë presidencës suedeze. Ky raport vlerësoi përpjekjet dhe arritjet e Shqipërisë, si dhe rekomandoi që Komisioni të fillojë përgatitjen e draft-mandatit për hapjen e negociatave me Shqipërinë për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

- Samiti i Goteborgut në qershor 2001 miratoi rekomandimin e Raportit të Komisionit, duke vendosur që ky i fundit të fillonte hartimin e Draft Mandatit, për ta paraqitur atë përpara fundit të vitit 2001. Në këtë Samit u vendos edhe krijimi i Grupit Konsultativ BE-Shqipëri, i cili ka zhvilluar katër takime në Tiranë: në tetor 2001, 6-7 mars, 18-19 qershor dhe 13-14 nëntor 2002. Rekomandimet e këtyre takimeve janë vlerësuar seriozisht nga Qeveria Shqiptare, e cila ka punuar dhe po punon për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që ka vendi ynë.

Një moment shumë i rëndësishëm ka qenë dhe mbetet Raporti i Komisionit European për Shqipërinë për Procesin e Stabilizim-Asocimit, i prillit 2002. Në këtë raport trajtohet me hollësi dhe realizëm gjendja e vendit në të gjitha aspektet politike dhe ekonomike, si dhe jepen sugjerime se ku duhet të përqëndrohet vëmendja gjatë 12 muajve të ardhshëm. Situata për Shqipërinë në këtë Raport, në pjesën më të madhe, paraqitet kritike dhe me shumë probleme. Për këtë qëllim ky raport u është vënë në dispozicion të gjitha dikastereve (nëpërmjet rrjetit të negociatorëve), duke iu kërkuar të përgatisin studime vlerësuese sektoriale për problemet që ngre raporti, për të pasqyruar qartë progresin e bërë që nga publikimi i këtij raporti gjer më sot, si dhe masat që janë marrë për trajtimin e problematikës që ende ekziston.

Natyrisht që ecuria e mëtejshme e procesit të integritimit pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit do të varet nga ecuria e reformave

brenda vendit dhe nga shkalla në të cilën Shqipëria do të jetë në gjendje të zbatojë angazhimet e saj që rrjedhin nga nënshkrimi i Marrëveshjes. Për këtë qëllim, dhe në ndihmë të këtij procesi, Qeveria Shqiptare ndërmori përgatitjen e Planit Strategjik për ndjekjen e procesit të Stabilizim Asociimit, deri në hapjen e negociatave dhe përfundimin e tyre me nënshkrimin e Marrëveshjes. Synimi kryesor i këtij plani është që, duke përcaktuar qëllimet strategjike, objektivat funksionale, si dhe masat përkatëse, së pari, të qartësojë rolin dhe detyrat për secilin pjesëmarrës në këtë proces dhe, së dyti, të realizojë mirëkuptimin, angazhimin dhe përkushtimin e të gjithë pjesëmarrësve në këtë projekt strategjik.

Në 21 tetor 2002, më në fund, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme vendosi t' i rekomandojë Komisionit që të fillojë negociatat me Shqipërinë, me qëllim nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit. Në vendimin e Brukselit kanë ndikuar disa faktorë pozitivë që karakterizuan jetën politike shqiptare në gjysmën e dytë të vitit 2002.

Së pari, pas takimit të Brukselit, në janar të këtij viti dhe takimit në Vjenë udhëheqësit politikë shqiptarë me parlamentarët europianë, klima politike në vend erdhi duke u shtensionuar, ndërkohë që shumë sugjerime të europarlamentarëve u morën parasysh nga udhëheqësit politikë të shumicës dhe opozitës, të cilët preferuan interesat kombëtare ndaj atyre partizane. Nga i gjithë spektri politik shqiptar u kërkuar njëzëshëm hapja dhe përfundimi i negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes me Bashkimin Europian.

Së dyti, zgjedhja e Presidentit me konsensusin e pozitës dhe opozitës, fillimi i mbarë i punës së komisionit parlamentar dypalësh, si dhe veprime të tjera të ndërmarra bashkërisht nga pozita dhe opozita, kryesisht në mbështetje të procesit të integrimit europian të vendit (që ka shërbyer si shtrat për arritjen e këtyre marrëveshjeve historike), konfirmuan pjekurinë që po tregon klasa politike shqiptare dhe garancitë që ajo ofron për një ecje të përshpejtuar e të pakontestuar në këtë rrugë. Kjo përfundimisht e përjashton këtë proces nga spekulimet e njëanshme për interesa të ngushta partiake.

Së treti, vendi tashmë ka dalë nga faza e emergjencës dhe ka hyrë në një periudhë të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik. Reformat në vend kanë ecur me një ritëm progresiv dhe me tregues ekonomik shumë më pozitiv, sidomos krahasuar me periudhën e viteve 1996-1997. Procesi i konsolidimit të institucioneve, ecuria e reformës në administratën publike dhe zbatimi i ligjit “Për shërbimin civil”, hapat e hedhura për forcimin e gjyqësorit, si dhe lufta ndaj trafikëve, krimet të organizuar dhe korrupsionit janë në qendër të vëmendjes së Qeverisë.

Së katërti, hapja e negociatave me Shqipërinë ka një rëndësi shumë të madhe edhe në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dhe stabilitetit rajonal. Një hap i tillë do të çojë, pa dyshim, në konsolidimin e qëndrimeve konstruktive që Shqipëria ka mbajtur në kuadër të zhvillimeve politike, ekonomike e ushtarake në rajon. Çdo vonesë në hapjen e negociatave, përveç efektit dekurajues ndaj zhvillimeve pozitive në vend, do të shkaktonte dhe një perceptim jo të mirë të vendet e rajonit, për arsyt e shtyrjes së mëtejshme të këtij procesi me Shqipërinë dhe do të bënte pesimiste aspirantët e tjerë të këtij procesi, pa përmendur shijen jo të mirë ndaj trajtimit të diferencuar në krahasim me Kroacinë dhe Maqedoninë.

Me qëllim përmirësimin e funksionimit ndërinstitucional për ndjekjen, bashkërendimin dhe monitorimin e të gjithë procesit të integritit janë marrë këto masa:

- Është ngritur Komiteti Ndërmintor për Integrimin. Ky Komitet mblidhet periodikisht, kryesohet nga Kryeministri dhe në të marrin pjesë titullarët e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore.
- Është krijuar pozicioni i Ministrit të Shtetit për Integrimin European, i cili është dhe kryenegociator i Qeverisë Shqiptare. Gjithashtu, është ngritur dhe funksionon Departamenti i Integritit i kryesuar nga Ministri i Shtetit.
- Është ngritur Grupi Negociator për Integrimin European me përfaqësues nga të gjitha institucionet qendrore. Ky Grup përbën nivelin teknik i cili do të kryesojë negociatat me hapjen e bisedimeve për

Marrëveshjen e Stabilizim. Duke pasur parasysh rëndësinë shumë të madhe që ka puna cilësore dhe profesionale e negociatorëve, si para, ashtu edhe gjatë negociatave, përgjegjesinë që ata do të kenë në këtë proces, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se kjo detyrë që ata kryejnë është një punë shtesë mbi detyrat funksionale në institucionin e tyre, është propozuar rritja e shpërblimit të tyre në një masë të konsiderueshme.

Është propozuar, gjithashtu, përfshirja pranë Strukturës së Ministrit të Shtetit për Integrimin edhe e Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit, aktualisht e vendosur në Ministrinë e Drejtësisë. Kjo Drejtori është përgjegjëse për bashkërendimin dhe monitorimin e procesit të përafrimit të legjislacionit në të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qëndrore në aspektin e përafrimit të legjislacionit.

Këto struktura mbështeten nga Ministria e Punëve të Jashtme, si institucioni më i specializuar, i cili ndjek aspektin politik të procesit të integritit të vendit tonë në BE.

Ndërkohë, është krijuar një Komision Parlamentar ad hoc për Integrimin European dhe Paktin e Stabilitetit, i cili synon të nxisë procesin e integritit, të përshpejtojë realizimin e detyrimeve të Parlamentit në procesin ligjvënës dhe përshtatjen e legjislacionit tonë me atë të BE-së, të rrisë kontrollin parlamentar ndaj ekzekutivit, për të plotësuar të gjitha detyrimet dhe kërkesat e Bashkimit European, të sensibilizojë opinionin publik dhe ta ndërgjegjësojë atë për vështirësitë dhe kostot e procesit të integritit etj. Komisioni ka në përbërjen e tij përfaqësues të të gjitha partive parlamentare.

## SYNIMET DHE PËRPARËSITË E PROCESIT

Kriteret për anëtarësimin e plotë të vendeve kandidatë në BE janë përcaktuar në Samitin e Kopenhagenit të vitit 1993 dhe përfshijnë kriteret politike e ekonomike. Siç përcaktohet në konkluzionet e Samitit të Kopenhagenit, vendi kandidat përpara se të fitojë antarësinë duhet që të këtë arritur:

Stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin juridik, të drejtat e njeriut, respektin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, marrëdhënie të mira me fqinjët dhe politikë konstruktive në rajon;

- funksionimin e plotë të ekonomisë së tregut dhe aftësinë për të përballuar presionin e konkurrencës së forcave të tregut brenda BE-së;

- aftësinë për të marrë përsipër zbatimin e detyrimeve të anëtarësisë së plotë, përfshirë synimin për arritjen e bashkimit politik, ekonomik e monetar.

Bazuar në këto kritere, veprimtaria dhe politika e BE-së me Shqipërinë është fokusuar në arritjen e progresit në fushat e përmendura më sipër. Është më se e kuptueshme, pra, që edhe puna jonë në marrëdhëniet me BE-në të orientohet në të njëjtat drejtime. Është e rëndësishme të kuptohet që Procesi i Integritimit Europian nuk është vetëm çështje politike, por çështje etapash dhe hapash që duhen ndërmarrë për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga thellimi i marrëdhënieve me Bashkimin Europian. Ai është një proces që, në radhë të parë, do të realizohet brenda vendit me plotësimin e kushteve për arritjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Si rezultat, nevojitet progres në reformat e sektorëve strategjikë si:

- Stabilizimi makroekonomik dhe reformat strukturore.
- Procesi i privatizimit të suksesshëm, të shpejtë dhe transparent, duke siguruar në këtë mënyrë jo vetëm rritjen e të ardhurave, por edhe rigjallërimin e sektorëve të ekonomisë, promovimin e nismës private dhe praninë e investitorëve të huaj në privatizimin e sektorëve strategjikë.
- Forcimi i rendit publik dhe shtetit juridik, duke pasur parasysh forcimin dhe profesionalizmin e gjyqësorit dhe të policisë së shtetit.
- Përmirësimi i qeverisjes, zbatimi i reformës së administratës publike.
- Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së. Është krijuar dhe funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Përafrimit të Legjislacionit, e cila ka për detyrë realizimin e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së.

Në kuadrin e objektivave strategjikë të lartpërmendur, Qeveria

Shqiptare, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin European do të fokusohet, vitet e ardhshme, në këto përparësi:

- Administrata publike dhe ligji për shërbimin publik.
- Lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme.
- Ekzistenca e ekonomisë së lirë dhe reformat strukturore.
- Tregu i brendshëm.
- Konkurrenca dhe ndihma shtetërore.
- Prokurimi publik.
- Drejtësia dhe çështjet e brendeshme.
- Lufta kundër terrorizmit.
- Mjedisi.

Gjatë periudhës nga hapja e negociatave deri në përfundimin e tyre dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, vëmendja do të duhet të përqendrohet në ruajtjen e ritmit të reformave dhe rritjen e përpjekjeve për evidentimin e progresit sipas rekomandimeve të bëra nga Komisioni European. Një ndihmë të vyer për realizimin e këtyre përparësive do të japë edhe Programi i Asistencës Teknike të BE-së (CARDS), i cili do t'i akordojë Shqipërisë mbi 175 milionë Euro gjatë viteve 2001-2004. Programi Indikativ Shumëvjeçar 2002-2004 përcakton parimet e Procesit të Stabilizim Asocimit, dhe strategjinë e përbashkët, miratuar nga Këshilli European në Feira, në qershor 2000, për mundësinë e integritit më të plotë të këtyre vendeve në jetën ekonomike dhe politike të Europës. Programi Indikativ Shumëvjeçar fokusohet në përparësitë e mëposhtme:

- Drejtësia dhe çështjet e brendshme për të mbështetur Shqipërinë në forcimin e gjyqësorit, në përmirësimin e rendit publik, në menaxhimin e kufijve dhe në luftën e frytshme kundër krimit të organizuar e korrupsionit;

- Ngritja e kapaciteteve administrative për të përmirësuar implementimin e përgjithshëm dhe forcimin e kapacitetit të administratës publike shqiptare, në veçanti në lidhje me fushat specifike të një Marrëveshjeje Stabilizim-Asocimi në të ardhmen.



- Zhvillimi ekonomik dhe social për të ndihmuar Shqipërinë që të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë socialo-ekonomik, veçanërisht nëpërmjet zhvillimit të tregtisë, përmirësimit të arsimit dhe infrastrukturave vendore në pika kyçe.
- Mjedisi dhe burimet natyrore të ndihmojnë Shqipërinë, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe një përdorim adekuat të burimeve natyrore, veçanërisht kjo nëpërmjet forcimit të institucioneve, monitorimit të indikatorëve të ndotjes dhe një planifikimi më të mirë urban dhe rajonal.
- Demokracia dhe stabiliteti, në veçanti, duke forcuar shoqërine civile.

### VIZIONI DHE PËRCEPTIMI FILOZOFIK I PROCESIT

Përsa i përket objektivave të së ardhmes afatgjatë do të dëshiroj të përmend disa ide dhe mendime që do të na duhet t'i trajtojmë me kujdes, duke filluar nga ky çast. Vendi ynë do të kalojë gjatë këtij procesi një transformim të thellë politik, ekonomik dhe social. Sfida të reja na presin drejt botës globale, liberalizimit të tregtisë, teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Një pyetje që shtrohet para nesh është: Si dhe sa do të na e rrisë mirëqenien hyrja në Europë? Si dhe sa do të preke marrëdhëniet tona në lidhje me kohën, punën, të ardhurat, shëndetin, arsimimin, kulturën, familjen, jetën sociale. Një përgjigje e shpejtë do të ishte: Po! Hyrja në Europë do të sjellë më shumë përfitime. Por, përgjigjja e plotë dhe e saktë e kësaj pyetjeje nuk do të vinte kaq e shpejtë. Ajo do të duhet të presë vite pune, përpjekjesh, mundimesh, por edhe realizimesh vijuese.

Të mos harrojmë se Europa ku ne kërkojmë të integrohemi është ndërtuar dhe zhvilluar duke u mbështetur mbi rritjen e efikasitetit, uljes së kostos së prodhimit, teknologjisë së lartë dhe nxitjes së konkurrencës. Ky mekanizëm funksionon mbi bazën e lëvizjes së lirë të mallrave, kapitaleve, njerëzve dhe ideve. Për të përfituar nga këto liri, ne duhet të bëhemi pjesë e këtij tregu unik dhe rruga është e përcaktuar: së pari, nëpërmjet reduktimit të barrierave midis një grupi të vogël vendesh me afërsi gjeografike (rajonalizimi i tregut)

dhe, së dyti, reduktimi gradual i barrierave midis vendit tonë dhe Bashkimit Europian (multilaterism).

Duke demonstruar një strategji të saktë të integritit dhe bashkëpunimit ekonomik, si në shkallë rajonale ashtu dhe europiane, vendi ynë do të përballët gradualisht me rregulla dhe standarde ndërkombëtare të lojës konkurruese të tregtisë dhe ekonomisë europiane, e thënë ndryshe, politikat e zhvillimit të tregut tonë do të bashkërendohen brenda regjimeve rregulluese, që garantojnë tregti të lirë dhe oportunitete konkurruese të barabarta për firmat vendase dhe të huaja.

Duke parë strukturën ekzistuese ekonomike dhe industriale në Shqipëri, në përballje me objektivat e një hapeje të shpejtë ndaj rregullave të tregtisë së lirë europiane, ne jemi të intriguar nga një pyetje sa interesante, aq edhe sfiduese: Cilët do të jenë sektorët, produktet dhe prodhuesit që do të konkurrojnë në një treg rajonal ose europian në dhjetëvjeçarin që sapo ka filluar?

Ne mendojmë se edhe analisti më me përvojë do ta kishte të vështirë t'i jepte një përgjigje të saktë kësaj pyetjeje. E megjithatë, ne duhet të përpiqemi, edhe pse mund të dështojmë në ndonjë rast, të transformojmë dhe zhvillojmë shoqërinë tonë në parametrat e shoqërisë europiane.

Ndërtimi i një programi strategjik për krijimin dhe zhvillimin e faktorëve që krijojnë dhe zhvillojnë produkte dhe biznese konkurruese është i rëndësishëm në kuadrin e vizionit të integritit ekonomik. Universitetet dhe qendrat kërkimore kanë një rol të rëndësishëm në krijimin dhe zhvillimin e laboratorëve të përbashkët midis tyre dhe bizneseve.

Lëvizjet e popullsisë nga qendrat rurale në ato urbane, gjithashtu, do të sjellin më shumë kërkesa për punë në sektorët e industrisë e të shërbimeve, në raport me sektorin e bujqësisë, i cili do ta humbë gradualisht peshën që zë sot në prodhimin e brendshëm bruto. Shndërrimi i aftësive nga punë e paspecializuar në punë të specializuar do të japë mundësi për më shumë lëvizje të kapitalit dhe teknologjisë në vendin tonë.

Burimet njerëzore dhe materiale, legjislacioni, gjyqësori, shoqëria civile, media, universitetet duhet të bashkërendohen në një program të drejtuar në një nivel politik nga një institucion qendror me role dhe funksione të qarta për zbatimin e projekteve, të strategjive dhe taktikave në mbështetje të procesit të integritimit.

Krahas faktorit të brendshëm dëshiroj të prek dhe një fushë tjetër: Siç e dimë, vlerat kulturore kanë një rëndësi të madhe në prosperitetin ekonomik të një vendi. Shqipëria, ashtu si dhe vendet e tjera të rajonit, diferencon përmasat tradicionale dhe pastradicionale të kulturës në një shkallë të lartë fleksibiliteti. Gjatë viteve të fundit, një numër mjaft i madh shqiptarësh jetojnë, studiojnë dhe punojnë në shtetet më të zhvilluara të Europës dhe disa prej tyre janë të integruar dhe punojnë me sukses në institucione dhe kompani Europiane. Këta shqiptarë, të cilët kombinojnë edukimin universitar, kulturën neotradicionale dhe identitetin european duhet të organizohen në një rrjet operues, i cili do të mund të shërbejë për të gjeneruar projekte europiane në fusha të ndryshme të zhvillimit midis institucioneve ku ata punojnë dhe partnerëve të tyre në Shqipëri.

Realizimi i gjithë këtyre arritjeve edhe për Europën e Bashkuar i është nënshtruar një filozofie që përshkon vetë ndërtimin e saj. Që në 9 maj 1950, kur paraqiti projektin european, Robert Schuman u shpreh: “Europa nuk mund të bëhet me një të goditur, as edhe në një ngrehinë të vetme: ajo do të bëhet me anë realizimesh konkrete, duke krijuar më së pari një solidaritet real”. Më shumë se pesëdhjetë vjet pas paraqitjes së këtij projekti dhe realizimit të sukseshëm të tij, filozofia që e përshkon ngelet e njëjtë. Romano Prodi, Presidenti aktual i Komisionit European shprehet: “Ajo që nevojitet të ndërtojmë tani është bashkimi i zemrave dhe i mendjeve, mbështetur nga një ndjenjë e fortë që ne ndajmë për një të ardhme të përbashkët, nga fryma e një qytetërimi të përbashkët european”.

Më në fund, edhe ne duhet të ndërjegjësohemi se procesi i integritimit kërkon angazhimin e të gjithë shoqërisë shqiptare dhe veçanërisht të trinomit

shtet-komunitet biznesi-shoqëri civile. Pa një bashkim të forcave, ideve dhe energjive të të gjithë shqiptarëve, pa një bashkëpunim në të gjitha fushat, ku do të na duhet të përballojmë sfida të rëndësishme në të ardhmen, ne nuk mund të arrijmë qëllimin final – integrimin e plotë të Shqipërisë në Europën e Bashkuar, në Europën e lirive dhe të vlerave demokratike.

# Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në frymën e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut

*Sokol Sadushi*

*Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese*

Nisur nga formulimi i nenit 122 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë që parashikon se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të rëndësishme të sistemit të brendshëm juridik që zbatohet drejtpërdrejt, përveç rasteve kur për të kërkohet nxjerrja e një ligji, pranohet tashmë epërsia e të drejtës ndërkombëtare në raport me të drejtën e brendshme dhe afirmohet në këtë mënyrë shkëputja nga zgjidhja doktrinare dualiste.

Duke pranuar epërsinë e së drejtës ndërkombëtare, edhe normat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut bëjnë pjesë ndër burimet normative të Republikës së Shqipërisë. Ky pozicion specifik i Konventës Europiane në raport me vetë Kushtetutën, me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe me ligjet e vendit pasqyrohet me një status *supralegjislativ* në nenin 17 paragrafi i dytë i Kushtetutës, në të cilin thuhet: “*Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.*”

Mënyra e formulimit të këtij paragrafi kushtetues të shpie në konkluzionin se të drejtat dhe liritë themelore të individit, të parashikuara në Kushtetutë, duhen interpretuar në funksion të dispozitave përkatëse të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ky *status i veçantë kushtetues*, që i

jepet dispozitave të Konventës Europjane, lidhet vetëm me kufizimet dhe veçanërisht ndaj këtyre të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë. Pikërisht kjo pozitë e veçantë kushtetuese që i është dhënë dispozitave të Konventës e bëjnë atë të vetëzbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Gjykata Europjane për të Drejtat e Njeriut në këtë drejtim ka pranuar qoftë karakterin e vetëzbatueshëm të Konventës, ashtu edhe kryerjen e veprimeve pozitive nga ana e shteteve, për të përputhur të drejtën e brendshme me parimet e shpallura në të.

Në realitetin shqiptar duhet pranuar se, përgjithësisht, normat ndërkombëtare dhe specifikiisht dispozitat e Konventës Europiane, nuk kanë arritur ende të konceptohen si pjesë integrale e jurisprudencës gjyqësore. Pranimi nga ana e Republikës së Shqipërisë i juridiksionit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut do të thotë se prokurorët dhe gjyqtarët shqiptarë duhet të kuptojnë tashmë se vendimet e tyre nuk përfundojnë brenda kuadrin të legjislacionit të brendshëm, por mund t'i nënshtrohen edhe kontrollit gjyqësor të kësaj gjykate, në raport me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Një shkelje e të drejtave dhe lirive të shtetasve, e parashikuar nga Konventa përpara se të konstatohet nga Gjykata e Strasburgut, duhet detyrimisht t'i nënshtrohet juridiksionit të brendshëm gjyqësor. Shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të konstatuar nga Gjykata e Strasburgut nënkupton një moszbatim të dispozitave të Konventës nga autoritetet e vendit përkatës.

Konventa Europiane, duke qenë pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe drejtpërdrejt e zbatueshme, kërkon dhe *mjetin ligjor efikas* me anë të të cilit të ballafaqojë shkeljet që mund t'i bëhen individëve, si dhe të kërkojë dhe të përshtasë pajtueshmërinë e ligjit me të.

E drejta për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për të kërkuar një gjykim të karakterit kushtetues, iu përket disa subjekteve të përcaktuara në nenin 134 të Kushtetutës. Ajo që ndeshet më tepër në jurisprudencën e kësaj

gjykate lidhet me kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe me gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet ligjore për fitimin e këtyre të drejtave, të parashikuara nga nenin 131 shkronja “a” dhe “f”.

Këto dy kompetenca të Gjykatës Kushtetuese lidhen me konceptin e zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin e brendshëm ligjor. Referimi drejtpërdrejt te dispozitat e Konventës Europiane dhe te jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut për rastet e sipërcituara gjendet në shumë vendime të Gjykatës Kushtetuese.

Më poshtë po i referohem jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese që ka për orientim zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të Konventës Europiane.

#### 1. Papajtueshmëria e ligjit me Konventën Europiane.

Kjo përbën kompetencën kryesore të Gjykatës Kushtetuese në rrugën e kontrollit të kushtetutshmërisë së normave. Në çështjen që u paraqit për shqyrtim në këtë gjykatë nga Gjykata e Lartë, bazuar në nenin 145 pika 2 të Kushtetutës, lidhur me shpalljen të papajtueshme me Kushtetutën të dënimit me vdekje, rishtazi ndeshet koncepti për të kryer interpretim dhe zbatim të drejtpërdrejtë të dispozitave të Konventës Europiane.

Neni 21 i Kushtetutës nuk do të kuptohej plotësisht dhe interpretohej drejt nëse nuk do të analizohej nën frymën e Konventës Europiane. Gjykata Kushtetuese ka interpretuar nenin 2, pika 2 të Konventës, që parashikon rastet kur jeta e njeriut mund të hiqet dhe kjo lloj vdekje, që i shkaktohet atij qoftë dhe nga shteti, nuk ka të bëjë dhe nuk mund të jetë e njëjtë me dënimin me vdekje, si lloj dënimi të dhënë nga gjykata, por është e lidhur me rastet përjashtimore.

Kushtetuta në shumë dispozita dhe kryesisht në kreun e të drejtave dhe lirive themelore i referohet kryesisht Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Konventa, duke i respektuar në maksimum të drejtat dhe liritë themelore, si dhe duke e konsideruar të drejtën për jetën dhe dinjitetin njerëzor

si të drejta të padhunueshme e të pakufizueshme që përbëjnë thelbin e çdo të drejte tjetër njerëzore, nuk e pranon, por e ndalon ekzistencën e dënimit me vdekje për shtetet anëtare të saj. Prandaj interpretimi i nenit 21 të Kushtetutës në këtë vendim u pa domosdoshmërisht i lidhur ngushtë sidomos me nenin 17 pika 2.

Në kohën që gjykohej kjo çështje nga Gjykata Kushtetuese, Shqipëria nuk kishte arritur që të ratifikonte Protokollin nr.6 të Konventës që hiqte dënimin me vdekje. Megjithatë, nisur nga fakti që Kushtetuta në nenin 17 pika 2 nuk lejon për asnjë rast kufizime të lirive dhe të drejtave të njeriut që mund të tejkalojnë ato kufizime të parashikuara në Konventë, kuptohet se dënimi me vdekje përbënte një tejkalim të konceptit dhe frymës së Kushtetutës, si dhe të vetë Konventës, e cila nuk e parashikonte një kufizim të tillë.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj arsyeton: *“I analizuar sipas frymës së Kushtetutës dhe Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, dënimi me vdekje është i papajtueshëm me thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive. Ai është një mohim i së drejtës për jetën dhe në vetvete përbën një dënim çnjerëzor e mizor, që shteti e realizon nëpërmjet pushtetit të tij gjyqësor. Dënimi kapital nuk lidhet me kufizimin, por me eliminimin përfundimisht të subjektit nga shoqëria.”* Më tej Gjykata arsyeton: *“Duke e analizuar këtë dispozitë kushtetuese...del se kufizimet në të drejtën për jetën, siç është rasti i dënimit me vdekje nuk mund të bëhet, sepse në këtë rast jo vetëm që çënohet, por mohohet tërësisht thelbi i saj. Nga ana tjetër, kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut nuk kanë të bëjnë me dënimin me vdekje si lloj dënimi penal.”*

Edhe lidhur me ekzistencën e dënimit me vdekje në kohë lufte, argumentin kryesor Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj e gjen përsëri te Konventa Europiane. Ajo arsyeton në vendim: *“Neni 15 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut u njuh të drejtën shteteve palë në këtë Konventë, që*



*në raste lufte ose të ndonjë rreziku tjetër publik që kërcënon jetën e një kombi, të mund të marrin masa që u shmangen detyrimeve të parashikuara në të, ndërsa neni 2 i Protokollit 6 të Konventës parashikon se “një shtet mund të parashikojë në legjislacionin e tij dënimin me vdekje për veprime të kryera në kohë lufte ose rreziku shumë të afërt të luftës...” Pikërisht në këtë aspekt është e lejueshme nga vetë Konventa aplikimi i dënimit me vdekje në kohë lufte dhe, për rrjedhojë, edhe dispozitat e Kodit Penal Ushtarak që parashikojnë këtë lloj dënimi në kohë lufte nuk bëjnë përjashtim dhe si të tilla janë në përputhje me to.”*

Në jurisprudencën kushtetuese gjen edhe raste kur Gjykata Kushtetuese për shpalljen të papajtueshëm të ligjit me Kushtetutën, në dispozitivin e vendimit i është referuar drejtpërdrejt jo ndonjë neni konkret të Kushtetutës, por marrëveshjes ndërkombëtare. Në vendimin 16/2000 arsyetohet: “Shtesa e parashikuar në ligjin nr.7916, datë 12.4.1995, ku i njihet e drejta e pronësisë edhe atyre personave që u është sekuestruar pasuria nga ligji “Për tatimin e jashtëzakonshëm”, e barazon padrejtësisht këtë masë me karakter fiskal me zhveshjen e padrejtë të pronës, njëlloj si dhe në rastet e tjera që parashikon kjo dispozitë. Neni 1 paragrafi i dytë i Protokollit të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, njeh të drejtën e shteteve për të miratuar ligjet që ato i çmojnë të domosdoshme për të siguruar pagesën e taksave, të kontributeve të tjera ose të gjobave. Sipas neneve 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës, kjo normë e së drejtës ndërkombëtare është e zbatueshme dhe ka përparësi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Ajo do të thotë se ligjvënësi mund të hartojë ligje që parashikojnë edhe privim të së drejtës së pronës, kur kjo masë çmohet e domosdoshme për të siguruar pagimin e detyrimeve me karakter fiskal. Sipas kuptimit të normave kushtetuese e ndërkombëtare të lartpërmendura dhe, vetëm për këto qëllime, prona e sekuestruar

*trajtohet si pronë e ligjshme shtetërore, e cila gëzon të njëjtën mbrojtje me ligj ashtu si dhe ajo private...”*

2. E drejta për një proces të rregullt ligjor sipas Kushtetutës dhe Konventës Europiane.

E drejta për një proces të rregullt ligjor nuk është një e drejtë që mund të mbulojë të gjitha të drejtat e tjera kushtetuese të individit. Po t'i referohemi nenit 6 të K.E.D.NJ, do të gjejmë një kuptim më të gjerë në formulimin e tij. Në konceptin e nenit 6 të Konventës Europiane parashikohen disa nga të drejtat dhe liritë e njeriut, të cilat në Kushtetutën tonë nuk gjenden të parashikuara vetëm në nenin 42 të saj. Janë edhe nenet 30, 31 dhe 33 të Kushtetutës, të cilat në tërësinë e tyre të japin kuptimin e një përafrimi me nenin 6 të Konventës.

Procesi i rregullt ligjor është një nga të drejtat e individit që lidhet me rregullsinë e një gjykimi të zakonshëm. Neni 42 pika 1 e Kushtetutës vetëm sa e përmend procesin e rregullt ligjor, por pa i dhënë atij ndonjë kuptim të hollësishëm. Atë që nuk e jep Kushtetuta, është përpjekur ta zgjidhë praktika e Gjykatës Kushtetuese, e cila është orientuar kryesisht edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut e të gjykatave kushtetuese europiane.

Në të drejtën e individëve për një proces të rregullt gjyqësor përfshihen mjaft të drejta dhe garanci kushtetuese e ligjore. *Shkelja e garancive kushtetuese*, që parashikohen në kreun e lirive dhe të drejtave vetjake të analizuara nga këndvështrimi i procedurave të ndjekura, janë konsideruar nga Gjykata Kushtetuese pjesë përbërëse të një procesi të parregullt ligjor.

Megjithëse jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka filluar të marrë një fizionomi të saj në drejtim të kuptimit që paraqet neni 42 dhe 131 shkronja “f” e Kushtetutës, për procesin e rregullt ligjor ende nuk ka një qëndrim të konsoliduar dhe nuk kuptohet lehtë se çfarë përfaqëson ai. Prandaj, nuk mendoj se i jep zgjidhje kuptimit të procesit të rregullt ligjor interpretimi si objekt i këtij koncepti kushtetues, pasi është jurisprudenca e Gjykatës

Kushtetuese, e cila, duke u pozicionuar gradualisht edhe duke u orientuar më drejt, shmang njëkohësisht çdo keqkuptim.

Nëpërmjet procesit të rregullt ligjor kontrollohet më shumë procedura e rregullt gjyqësore, por jo vetëm ajo, pasi nuk përjashtohet edhe procedura administrative nga ky koncept. Në vendimin 76/2002, Gjykata Kushtetuese përpiket të bëjë dhe dallimin që ekziston ndërmjet nenit 6 të K.E.D.NJ. dhe nenit 42/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. *Ndërsa në Konventë parashikohet e drejta e individit për një gjykim të drejtë penal ose civil, në nenin 42/1 të Kushtetutës dhe në jurisprudencën e saj, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ.*

Në këtë çështje jurisprudenca kushtetuese e konsolidoi qëndrimin e mbajtur më parë, duke mos e kufizuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor vetëm për çështjet gjyqësore. Në vendim thuhet: *“Gjykatës Kushtetuese i rezulton se Kuvendi gjatë procedurës së ndjekur për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm nuk i është përmbajtur pikërisht respektimit të këtyre standardeve. Kështu, Kuvendi i ka konsideruar të mirëqena të gjitha akuzat e drejtuara ndaj kërkuesit, duke u mbështetur vetëm në diskutimet e deputetëve pa argumentuar shkeljet konkrete, pa njoftuar rregullisht kërkuesin për përmbajtjen e materialit në ngarkim të tij, pa i dhënë kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe pa e dëgjuar atë për të parashtruar prapësimet rreth këtyre akuzave.”*

Gjykata Kushtetuese është përpjekur në praktikën e saj gjyqësore të bëjë një dallim thelbësor të rolit të saj si autoritet që garanton respektimin e Kushtetutës nga funksioni i dhënies së drejtësisë që mbetet atribut i organeve të pushtetit gjyqësor. Kjo është një çështje mjaft delikate, që në fakt ka krijuar edhe ndonjë keqkuptim në praktikë. Në këtë drejtim, nuk ka qenë dëshira e Gjykatës Kushtetuese të gjejë parregullsitë e procesit vetëm në

procedurat gjyqësore, por në fakt, vetë formulimi i nenit 131 shkronja “f”, që kërkon paraprakisht shterrimin e mjeteve juridike për t’iu drejtuar kësaj gjykate, nuk e shmang kontrollin kushtetues mbi vendimet gjyqësore. Tendenca për ta orientuar Gjykatën Kushtetuese në një pozicion që të mos konfondohej me shkallët e tjera të gjykimit, por të evidentojë nga kontrolli i kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore vetëm problemet esenciale që prekin procesin e rregullt ligjor, ndjehet vazhdimisht në praktikën e saj.

Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese për çështje të ndryshme, si dhe qëndrimeve të mbajtura, të cilat duhet të analizohen për çdo rast konkret, vihet re se qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ka qenë dhe nuk është të orientojë dhe të vëre detyra për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por të krijojë dhe të konkludojë një praktikë të saj sa më të konsoliduar, për t’i dhënë kuptimin kushtetues të drejtës së individëve për një proces të rregullt ligjor.

*E drejta për një seancë të drejtë e të ndershme* përfshin të gjitha procedurat dhe garancitë dhe qëndrojnë në thelb të konceptit për gjykim të drejtë. E drejta për një shqyrtim të drejtë në gjykimet penale specifikohet nga një numër i të drejtave konkrete, si e drejta për t’u konsideruar i pafajshëm, e drejta për t’u gjykuar pa vonesë të panevojshme, e drejta për të përgatitur mbrojtjen, e drejta për t’u mbrojtur vetë personalisht ose përmes avokatit, e drejta për të thirrur dëshmitarë etj. Sidoqoftë, standardet ndërkombëtare që udhëheqin drejtimin e gjykimit bëjnë të qartë se këto të drejta të përmendura specifikisht përbëjnë *garanci minimale*. Respektimi i secilës prej këtyre garancive nuk siguron në të gjitha rastet e rrethanat se një seancë ka qenë e ndershme dhe e drejtë. E drejta për gjykim të drejtë është më e gjërë se shumica e garancive individuale dhe varet nga i gjithë drejtimi i gjykimit.

Garancitë që ofron neni 31 i Kushtetutës, në analizë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane, të cilat lidhen *me njoftimin e akuzës të pandehurit* nga organi procedues dhe *me dhënien e kohës së mjaftueshme për t’u*

*mbrojtur*, kur ato janë konstatuar nga Gjykata Kushtetuese se janë shkelur, kanë sjellë cenimin e të gjithë procesit dhe shfuqizimin e vendimeve gjyqësore si antikushtetuese. Në vendimin 4/2001 Gjykata Kushtetuese arsyeton: “*I pandehuri nuk është njohur me të gjitha materialet në ngarkim të tij nga prokurori, para se çështja të kalonte për gjykim dhe janë bërë, gjithashtu, një sërë veprimesh procedurale pa praninë e mbrojtësit, ç’ka përbën shkelje të garancisë për realizimin në kohë të mbrojtjes.*”

*E drejta për të qenë i pranishëm në gjykim është pjesë përbërëse e të drejtës për të mbrojtur veten. Megjithëse kjo e drejtë nuk është shprehimisht e përmendur në Konventë, Gjykata Europiane ka deklaruar se qëllimi dhe objekti i nenit 6 nënkuptojnë që një person i akuzuar për një veprë penale ka të drejtë të marrë pjesë në seancë gjyqësore. E drejta për të qenë i pranishëm në gjyq i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë të akuzuarin dhe mbrojtësit në kohë të mjaftueshme, për datën dhe vendmbajtjen e procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë në to të të akuzuarit dhe për të mos e përjashtuar padrejtësisht të akuzuarin nga gjykimi. Në vendimin nr. 17/2001, Gjykata Kushtetuese arsyeton : “ ...Mosvënia e të pandehurit në dijeni të apelit të prokurorit dhe mosnjoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes...i kanë mohuar atij...njëkohësisht disa të drejta themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, si e drejta për t’u mbrojtur ... e drejta për t’u dëgjuar para se të gjykohet ... shkelje këto që e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt...”*

Ndërsa në vendimin nr.109/2002 arsyetohet se “*do të ishte pa vlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces, në rast se atyre nuk do t’u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim.*”

Realizimi i së drejtës së të pandehurit për t’u mbrojtur përbën thelbin e procesit të rregullt ligjor. Në vendimin nr.3/2001 Gjykata Kushtetuese arsyeton se “*nga Gjykata e Apelit, ku është shqyrtuar apeli i prokurorit që kërkonte ndryshimin e vendimit në një dënim më të rëndë, edhe pse*

*kërkuesi ishte në mungesë, nuk është marrë asnjë masë për të realizuar mbrojtjen e tij... Kjo do të garantonte një minimum të domosdoshëm të mbrojtjes së të drejtave të tij dhe do të siguronte një proces të rregullt ligjor.”*

Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese vihet re qëndrimi tashmë i konsoliduar për të mos hyrë në analizën dhe vlerësimin e provave, të rrethanave, si dhe të mënyrës së zgjidhjes së çështjeve, pasi dihet që kjo është një atribut i gjykimit të zakonshëm. Në vendimin nr.20/2000, pretendimit të kërkuesit për proces të parregullt ligjor, ajo i përgjigjet duke arsyetuar: *“Nëse ky gjykim është shoqëruar me mangësi në hetime ose në vlerësim të gabuar të provave, kjo është një çështje që i takon vetëm juridiksionit gjyqësor...”*

I njëjti konkluzion pasqyrohet edhe në vendimin nr.38/2000, ku Gjykata Kushtetuese arsyeton se *“nga përmbajtja e rekursit drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë rezulton se në të janë parashtruar vetëm argumente që kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes dhe në këto rrethana vendimi nuk ka shkak të deklarohet antikushtetues.”*

Një kriter thelbësor i një seance të drejtë e të ndershme është *parimi i “barazisë së armëve”* midis palëve në një çështje. Barazia e mjeteve, që duhet respektuar gjatë gjithë procesit të gjykimit, do të thotë që të dyja palët të trajtohen në një mënyrë që i siguron ato të kenë pozitë të barabartë procedurale gjatë rrjedhës së gjykimit dhe të jenë në pozita të barabarta për të paraqitur çështjen e tyre. Ajo do të thotë që secilës palë duhet t’i ofrohet mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet, në kushte që nuk e vënë atë në disavantazh të konsiderueshëm ndaj palës kundërshtarë. Në gjykimet penale, ku prokurori ka të gjithë makinerinë e shtetit pas tij, parimi i barazisë së armëve është një garanci thelbësore e së drejtës për të mbrojtur vetveten. Ky parim siguron që mbrojtja të ketë mundësi të arsyeshme për të përgatitur e paraqitur çështjen e vet në pozita të barabarta me atë të

prokurorit. Në vendimin nr.9/2001, Gjykata Kushtetuese arsyeton: *“Për më tepër gjykata e apelit nuk ka caktuar as mbrojtës kryesisht, por ka dëgjuar vetëm prokurorin, duke mos respektuar parimet e rëndësishme të barazisë së armëve –shën. i autorit- mbrojtjes e të kontradiktoritetit në gjykim.”*

Kushtetuta, mundësinë e individit për t’iu drejtuar gjykatave për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese e atyre ligjore për shkak të rëndësisë së posaçme e ka parashikuar shprehimisht si të drejtë vetjake në nenin 42 të saj. Me vendimin nr. 25/2002 Gjykata Kushtetuese shfuqizoi si antikushtetuese pikën 2 të nenit 34 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikonte se dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të prokurorit është i paankimueshëm, duke arsyetuar: *“E drejta e ankimit pranohet si e drejtë themelore edhe nga Konventa Europiane... dhe se ushtrimi i kësaj të drejte është i pakufizuar. Kufizimi që i bën kësaj të drejte dispozita e ligjit ... nuk gjen mbështetje edhe tek neni 17 i Kushtetutës.*

Zhvillimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme përbën një tjetër aspekt të rëndësishëm të kuptimit të procesit të rregullt ligjor. Paanësia e gjykatës në një proces është jo vetëm një garanci kushtetuese për respektimin e të drejtave dhe lirive të individit, por njëkohësisht ndikon në konsolidimin e sistemit gjyqësor. E drejta për gjykim përpara një gjykate të paanshme nënkupton që *“drejtësia jo vetëm duhet dhënë, por ajo, gjithashtu, duhet të shihet se po jepet.”* Paanshmëria e vërtetë dhe të treguarit si i paanshëm janë që të dyja themelore për ruajtjen e respektit ndaj drejtësisë. Ky parim kërkon që gjyqtarët të mos kenë interesa në një çështje të veçantë dhe të mos kenë mendime të paraformuara rreth saj.

Një gjyqtar i shkarkuar i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se është shkelur parimi i paanësisë, sepse në përbërje të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që kishin gjykuar ankesën e tij ndaj masës së shkarkimit nga detyra, kishin marrë pjesë dy anëtarë të Këshillit të Lartë

të Drejtësisë. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.48/1999 konkludon se *“pjesëmarrja si gjyqtarë e dy anëtarëve të KLD-së në gjykimin e çështjes në KB të Gjykatës së Lartë, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje.”* Në një vendim të mëvonshëm, Gjykata Kushtetuese i referohet përsëri qëndrimit të mbajtur, duke arsyetuar se kjo *“është një çështje paanshmërie që nuk duhet ngatërruar me rastet e papajtueshmërisë ndërmjet funksioneve.”*

Ndërsa në rastin kur gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, që kishin dhënë një vendim në kolegjin përkatës, merrnin pjesë në gjykimin e së njëjtës çështje në Kolegjet e Bashkuara, Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi mangësi të paanshmërisë. Në vendimin nr.15/2000, Gjykata Kushtetuese arsyeton: *“Interpretimi që i është bërë dispozitave kushtetuese, lidhur me parimin e paanësisë në gjykim dhe respektimi i këtij parimi nuk duhet të keqkuptohet dhe as të bëhet shkak që çështjet, të cilat paraqiten për shqyrtim pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të mbeten pa u gjykuar me arsyetimin se shkelet parimi i paanësisë në gjykim dhe çenohet procesi ligjor. Parimi i paanësisë në gjykim është i detyrueshëm të respektohet dhe zbatohet nga çdo organ gjyqësor, por kjo nuk duhet të krijojë pamundësi në marrjen e vendimit dhe krizë institucionale për organin gjyqësor, siç janë K.B.G.J.L, i cili është i vetëm në ushtrimin e kësaj kompetence dhe që detyrë parësore ka përmbushjen e funksionit të tij kushtetues.”*

Një qëndrim i shprehur në disa vendime të Gjykatës Kushtetuese lidhet dhe me mpleksjen e kompetencave ndërmjet kolegjit të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, me atributet që ai ushtron gjatë seancës gjyqësore, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në procesin ligjor. Në vendimin nr.24/2001, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se *“moskalimi i çështjes në seancë*



*gjqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndërkohë që shqyrtimi dhe dhënia zgjidhje shkaqeve ligjore të parashtruara në rekurs nuk i përket dhomës së këshillimit, i ka mohuar kërkesve të drejtën për t'u mbrojtur dhe dëgjuar nëpërmjet avokatit të tyre, duke mos u garantuar njëkohësisht zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.”*

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim për çdo rast që asaj i janë parashtruar pretendime për antikushtetutshmërinë e vendimeve të kolegjeve në dhomën e këshillimit. Në vendimin nr.8/2002 ajo argumenton se veprimtaria e Kolegjit Civil në shqyrtimin paraprak nuk mund të jetë vetëm konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs. *“Në rastet kur kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave e bindjen e brendshme të gjykatave të hallkave më të ulta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranoj rekursin.”* Këtë qëndrim ajo e konsolidon më tej në vendimin nr.205/2001, ku ndërmjet të tjerave thekson: *“Kjo analizë që bën kolegji nuk mund t'ia heqë atij të drejtën për të vendosur mospranimin e rekursit, kur bindet se shkaqet e ngritura në rekurs lidhen me mënyrën e të vlerësuarit të provave. Gjithashtu, kur kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë i përket atij të vlerësojë dhe të vendosë konform kërkesave të ligjit për moskalimin e çështjes në seancë gjyqësore.”*

Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese është konsideruar shkelje e procesit ligjor rasti i dhënies së vendimit nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që ligji kërkonte trup gjykues. Dhënia e vendimit nga një gjyqtar i vetëm, në rastin konkret lidhet me mungesën e kompetencës së organit përkatës dhe njëkohësisht shkel konceptin kushtetues që parashikohet në nenin 42 të saj, si dhe në nenin 6 të Konventës Europiane për zhvillimin e gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

Gjithashtu, dhënia e dy vendimeve nga e njëjta gjykatë në të njëjtën ditë

për të njëjtët palë, por me zgjidhje të ndryshme, sigurisht që lidhet me kërkesat kushtetuese për rregullsinë e procesit gjyqësor. Zgjidhje të tilla dëmtojnë thelbin e drejtësisë dhe të procesit të drejtë. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese nuk mund të pranonte ekzistencën njëkohësisht të dy vendimeve të tilla dhe, për rrjedhojë, ajo arsyeton në vendimin nr. 76/1998 se, *meqenëse vendimi është sintezë e të gjithë gjykimit, nuk mund të quhet proces i drejtë dhe i rregullt ligjor kur jepen njëkohësisht dy vendime të ndryshme për të njëjtën çështje gjyqësore, pasi kjo nuk është një shkelje formale, por një cënim i rëndë i parimeve kushtetuese të dhënies së drejtësisë dhe të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.*

Qëndrimi i mbajtur deri tash në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese përgjithësisht ka krijuar fizionominë për një kuptim më të drejtë të nocionit kushtetues për një proces të rregullt ligjor. Praktika e kësaj Gjykate edhe mund të ndryshojë (mbi bazën e faktorëve që lejojnë ndryshimin e jurisprudencës), megjithatë, mendoj se qëndrimet e deritashme shkojnë në përshtatje edhe me konceptin që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht K.E.D.Nj kanë sanksionuar për mënyrën e shqyrtimit të ankesave të individëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka filluar të pasqyrohet dhe të zerë një vend të konsiderueshëm edhe në praktikën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, të cilat kanë arritur të kuptojnë tashmë se vendimet e tyre nuk mund të mbeten për t'u vlerësuar e gjykuar vetëm brenda legjislacionit shqiptar. Kjo për faktin se integrimi i Shqipërisë drejt strukturave europiane e kanë bërë evidente rastin kur në një të ardhme jo të largët, të ndodhemi përpara shqyrtimit të çështjeve shqiptare nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, vendimet e së cilës, për nga efektet juridike, mbartin në vetvete edhe sanksione ndaj shtetit, kur ai nuk ka respektuar të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve të tij.

## Administrimi ndërkombëtar në Kosovë (dilemat dhe kontraverset)

*Prof.dr.Arsim Bajrami*

Administrimi Ndërkombëtar në Kosovë, i përcaktuar me Rezolutën 1244, është i karakterit të përkohshëm dhe synon krijimin e kushteve të përshtatshme demokratike për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Specifika i këtij modeli të administrimit ndërkombëtar shprehet me faktin se ai paraqet modelin e parë të OKB-ës në përmasa kaq të gjera. Ky model është specifik për faktin se, krahas vendosjes së administratës civile dhe ushtarake ndërkombëtare, kombinohet edhe me një vetëqeverisje vendore dhe me një proces demokratik dhe institucional, i cili krahas zhdukjes së shkaqeve të krizës dhe armiqësive ndëretnike, synon të merret me mënjanimin e shkaqeve që kanë prodhuar krizën, pra, të zbulojë burimin e krizës dhe të mundësojë një zgjidhje politike dhe statusore afatgjate të krizës.

Rezoluta 1244, si akt këshillimor i vendosjes së administrimit ndërkombëtar në Kosovë, më tepër është marrë me pasojat e krizës sesa me burimin e saj. Ajo, në aspektin juridik dhe politik, ka sanksionuar gjendjen që ka ekzistuar para rrënimit kundërkushtetues të pozitës së Kosovës, të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974. Ajo ka përcaktuar një zgjidhje balancuese, duke mos njohur pushtimin institucional të Kosovës nga Serbia, që ka pasur pas vitit 1990, kur Serbia në mënyrë kundërkushtetuese vendosi Kosovën në juridiksionin e plotë dhe vendosi zbatimin e politikës së genocidit shtetëror dhe politikën e aparteidit ndaj shqiptarëve si popullsi me shumicë dërmuese në Kosovë.

Në aspektin juridik, kjo rezolutë paraqet akt konstitutiv të vendosjes së Kosovës në administrimin e OKB-ës, duke vendosur një prani civile dhe ushtarake ndërkombëtare. Miratimi i kësaj rezolute i dha fund agresionit serb ndaj Kosovës dhe ndërpreu genocidin shtetëror serb, i cili synonte spastrimin etnik të Kosovës. Praktikisht, kjo rezolutë shënoi përfundimin e luftës çlirimtare të UÇK-ës, e cila, në sajë të ndihmës së NATO-s, u kurorëzua me lirinë e Kosovës dhe me largimin e forcave policore, ushtarake dhe të gjitha forcave paraushtarake nga territori i Kosovës. Duke vendosur forcat e KFOR-t në territorin e Kosovës, miratimi i kësaj rezolute mundësoi kthimin e afër 1 milion shqiptarëve në Kosovë, të cilët gjatë kohës së luftës ishin deportuar me dhunë, në shumë shtete fqinje dhe anembanë botës.

Nisur nga kjo, Rezulta 1244 është plotësisht e papërcaktuar sa i përket statusit final kushtetues dhe politik të Kosovës, sa i përket statusit të përkohshëm juridik. Rezoluta 1244 për Kosovën promovon një status të një vetëqeverisjeje (autonomisë) substanciale brenda integritetit të RF të Jugosllavisë. Pikërisht ky përcaktim, pra, vetëqeverisja substanciale, në njërën anë, dhe integriteti territorial i RF të Jugosllavisë, paraqet njëkohësisht absurdin dhe kundërthënien më të madhe të saj.

Koncepti i vetëqeverisjes substanciale, që promovohet në Rezolutën 1244, e më vonë edhe në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme (e cila buron nga ajo) është mjaft i padefinuar dhe jo i plotë. Kjo vetëqeverisje nuk përmban atributet e nevojshme, që cilësojnë Kosovën si entitet shtetëror, por attribute që atë e shquajnë si njësi autonome me kompetenca të kufizuara. Megjithatë Rezoluta promovon konceptin e vetëqeverisjes për Kosovën, kompetencat substanciale të karakterit shtetëror rezervohen dhe ushtrohen nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UMNIK-u), i cili paraqet autoritetet përfundimtar, në funksionimin e pushtetit në Kosovë në tri trajtat e tij: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Parimi i integritetit territorial të RF të Jugosllavisë ndaj Kosovës është jo vetëm një absurd juridik, por edhe një nga defektet dhe të metat kryesore të

kësaj Rezolute. E ashtuquajtura “RF e Jugosllavisë” ka humbur të gjitha të drejtat juridike, politike, morale dhe ndërkombëtare në raport me Kosovën. Kjo krijesë shtetërore-juridike nuk kishte as historikisht të drejta, për të shtrirë juridiksionin e saj në Kosovë. Në rrethanat e reja politike, pas shpërbërjes së saj dhe zbatimit të politikës së genocidit shtetëror ndaj Kosovës, Serbia dhe RF e Jugosllavisë, përfundimisht në raport me Kosovën mund të jenë vetëm në raporte ndërshtetërore.

### **Përmbajtja e Rezolutës 1244**

Rezoluta 1244 është një akt specifik, që parasheh një mori zgjidhjesh të karakterit humanitar, politik, juridik dhe ushtarak. Formulimet në Rezolutë janë mjaft të përgjithësuara dhe në disa aspekte mjaft kundërthënëse.

Baza juridike për nxjerrjen e Rezolutës ka qenë Karta e Kombeve të Bashkuara që parasheh të drejtën dhe përgjegjësinë parësore të Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Pjesa humanitare e Rezolutës bën thirrje për sanimin e pasojave të krizës së rëndë humanitare si pasojë e agresionit serb dhe për marrjen e masave për kthimin e sigurt dhe të lirë të gjithë refugjatëve dhe të shpërngulurve në shtëpitë e tyre, ndalimin e akteve të dhunës dhe ndërmarrjen e masave të tjera të mirëbesimit.

Në aspektin juridik, Rezoluta parasheh një autonomi (vetëqeverisje) substanciale të Kosovës brenda Republikës Federale të Jugosllavisë. Pa dyshim, ky parim është kontradiktor dhe shprehje e raportit të forcave në momentin e miratimit të Rezolutës. Në të vërtetë, autorët e Rezolutës më tepër kanë pretenduar ndaljen e luftës dhe të konfliktit, se sa zgjidhjen e qëndrueshme politike për statusin e Kosovës. Kjo ngase qenia e Kosovës brenda të ashtuquajturës RF e Jugosllavisë ka qenë edhe shkas dhe burim i konfliktit që është shquar me aspiratën e luftës çlirimtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Së këndejmi rrjedh se Këshilli i Sigurimit, me rastin e miratimit të kësaj Rezolute, ka pasur këta objektiva kryesorë:

a. Ndalja e luftës dhe konfliktit të armatosur midis UÇK-ës dhe forcave ushtarake dhe paraushtarake të Serbisë.

b. Vendosja e administrimit ndërkombëtar të OKB-ës në Kosovë nëpërmjet pranisë civile dhe ushtarke ndërkombëtare.

c. Përcaktimi i një statusi të përkohshëm për Kosovën në shkallën e një vetëqeverisjeje substanciale brenda RF të Jugosllavisë.

ç. Përgatitja e zgjidhjes finale-statusore për Kosovën dhe kalimi i të gjitha përgjegjësisive në organet e Kosovës, të cilat do të themelohen pas zgjidhjes finale statusore për Kosovën.

Rezoluta 1244 është akt i përkohshëm juridik. Edhe pse në pikëpamje kohore nuk është bërë afatizimi i këtij dokumenti, rrjedh se ai do të jetë në fuqi derisa nuk shfuqizohet nga Këshilli i Sigurimit me ndonjë Rezolutë të re ose deri në gjetjen e zgjidhjes përfundimtare për statusin e Kosovës, kur duhet të përfundojë misioni i OKB-ës në Kosovë, fakt ky që duhet të konstatohet me vendim të veçantë të Këshillit të Sigurimit.

Është interesante se Rezoluta, duke iu referuar statusit politik të Kosovës thirret në Marrëveshjen e Rambujes, gjë që paraqet një absurd juridik, kur dihet se kjo marrëveshje nuk është nënshkruar nga pala serbe dhe, si e tillë, nuk mund të prodhojë pasoja juridike.

### **Disa të meta të Rezolutës 1244**

Rezoluta 1244 paraqet një akt shumë të përgjithësuar, që në vetvete ngërthen mjaft zgjidhje kontradiktore. Ajo paraqet një kombinim të parimeve juridike dhe politike, të cilat përcaktojnë mandatin e administratës ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Në anën tjetër, kjo Rezolutë ka shumë pjesë të karakterit ushtarak dhe humanitar, të cilat mund të përcaktoheshin me rezolutë të veçantë. Paqartësitë, dilemat dhe kontraverset e kësaj Rezolute lejojnë mundësinë e interpretimeve të ndryshme, fakt ky që në implementimin praktik ka shkaktuar mjaft paqartësi. Me këtë rast do të veçojmë disa nga vërejtjet kryesore ndaj kësaj Rezolute.

1. Rezoluta përmban mjaft *formulime të përgjithësuara*, të cilat nuk japin një përkufizim të qartë për mandatin e Misionit të Përkohshëm Ndërkombëtar në Kosovë dhe mënyrën e realizimit të tij. Në të vërtetë, Rezoluta nuk përcakton në mënyrë të qartë vijën e përkufizimit midis kompetencave të autoriteteve ndërkombëtare dhe të institucioneve demokratike të Kosovës.

2. Rezoluta përmban parimin kontradiktor *për vendosjen e një vetëqeverisjeje (autonome) substanciale të Kosovës, brenda Republikës Federale të Jugosllavisë*, fakt ky që paraqet një absurd juridik dhe politik, pasi pikërisht qenia e dhunshme e Kosovës brenda Serbisë dhe Jugosllavisë ishte burim i krizës dhe i luftës çlirimtare të popullit të Kosovës për realizimin e aspiratës së tij për liri dhe pavarësi.

3. Element tjetër i papranueshëm i Rezolutës 1244 është *referimi i saj te Marrëveshja e Rambujes*. Në të vërtetë, Rezoluta, duke përcaktuar elementet e zgjidhjes politike për Kosovën në dy vende në pikën 11 (a) dhe 11 (e), i referohet Marrëveshjes së Rambujes dhe parimeve që ajo përcakton. Një referim i këtillë në Marrëveshjen e Rambujes, në aspektin juridik, është plotësisht i papranueshëm, pasi kjo Marrëveshje nuk është nënshkruar nga pala serbe, pra ka munguar nënshkrimi i njëjës palë negociuese, çka i humbet legjitimitetin juridik. Në aspektin politik, referimi i zgjidhjes përfundimtare politike për Kosovën te Marrëveshja e Rambujes është e paqëndrueshme, pasi ajo ka marrë për bazë një realitet tjetër faktik. Ky realitet, pas ushtrimit të genocidit serb në Kosovë, sot është krejtësisht i ri.

4. *Pacaktueshmëria kohore e Rezolutës 1244* paraqet një të metë tjetër të saj. Rezoluta edhe pse vetëpërcaktohet si e përkohshme, siç atribuohet edhe vetë misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara, nuk kufizon me asnjë limit kohëzgjatjen e saj. Për dallim nga Marrëveshja e Rambujes, e cila shprehimisht përcaktonte një zgjidhje të përkohshme për intervalin prej tri vitesh. Rezoluta 1244 edhe pse e përkohshme, nuk përcakton asnjë afat kohor të përfundimit të saj. Rezoluta 1244, mund të ndryshohet në dy mënyra:

me zëvendësimin e saj me ndonjë rezolutë të re të Këshillit të Sigurimit dhe me realizimin e misionit përfundimtar të saj, pra përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës dhe bartjen e të gjitha përgjegjësiave në organet e Kosovës, të themeluar në bazë të zgjidhjes përfundimtare politike për Kosovën.

5. Rezoluta 1244 nuk përcakton mekanizmin përfundimtar të statusit politik të Kosovës. Zgjidhjet që ajo përcakton janë të karakterit të përkohshëm dhe në pritje të një zgjidhje përfundimtare. Mirëpo, mekanizmi i zgjidhjes përfundimtare nuk është pjesë e Rezolutës 1244 dhe kjo çështje mbetet të përcaktohet në një periudhë të mëvonshme. Në këtë aspekt, Rezoluta 1244 paraqet një hap prapa në raport me Marrëveshjen e Rambujes, e cila në fund të saj ka përcaktuar në një klauzolë të veçantë, mundësinë reale që, pas tri vitesh, statusi final i Kosovës të përcaktohet në bazë të vullnetit (referendumit) të popullit të saj. Edhe pse referendumi nuk ishte përcaktuar si formë e vetme e caktimit të statusit përfundimtar të Kosovës, mbajtja e tij ishte një mundësi reale. Ndërkaq Rezoluta e më vonë edhe Korniza Kushtetuese nuk kanë përcaktuar shprehimisht marrjen parasysh të vullnetit të popullit të Kosovës, si mekanizëm i veçantë për zgjidhjen përfundimtare të statusit politik të Kosovës.

6. Një paqartësi tjetër e Rezolutës 1244 ka të bëjë me *dhënien e autorizimeve të gjera Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në Kosovë*. Autorizimet e PSSP-ës sipas Rezolutës 1244 dhe Kornizës Kushtetuese janë mjaft të gjera në tri degët e qeverisjes shtetërore, legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Këto kompetenca tejkalojnë fuqinë politike edhe të presidentit në shtetet presidenciale. Po të krahasohet gjerësia e autorizimeve të PSSP-së me autorizimet e shefave të shtetit, mund të konkludojnë se ai gjendet diku në mes të monarkut absolut dhe kushtetues. Shumë autorizime të PSSP-së janë të karakterit shtetëror, sepse ai paraqet autoritetin përfundimtar në shumë çështje. Si mekanizma të këtillë konsiderohen e drejta e PSSP-së për të përdorur të drejtën absolute të vetos



ndaj ligjeve të Kuvendit të Kosovës dhe të organeve të tjera të vetëqeverisjes së përkohshme, e drejta e shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës, si dhe një varg autorizimesh të tjera të karakterit diskrecional, që janë tipike për monarkitë absolute.

7. *Mosdefinimi i konceptit të vetëqeverisjes substanciale* paraqet një çështje tjetër të paqartë në Rezolutën 1244. Ajo vetë promovon se populli i Kosovës gjatë administrimit të përkohshëm do të gëzojë një autonomi substanciale, pa i përcaktuar limitet e kësaj autonomie. Më vonë, Korniza Kushtetuese ka promovuar konceptin e vetëqeverisjes së përkohshme, i cili është i zhveshur nga të gjitha atributet shtetërore. Në të vërtetë, vetëqeverisja e përkohshme e promovuar me Rezolutën 1244 dhe Kornizën Kushtetuese, më tepër atribuohet si vetadministrim publik sesa qeverisje shtetërore.

8. Rezoluta 1244 *nuk ka bërë përkufizimin e qartë të kompetencave në mes organeve të Misionit të Përkohshëm në Kosovë (UNMIK) dhe organeve vendore si në nivelin vendor, ashtu edhe në atë qendror*. Si pasojë e kësaj, në praktikë janë shfaqur mjaft paqartësi dhe konflikte për kompetencat midis organeve të UNMIK-ut dhe organeve të pushtetit vendor dhe qendror.

9. Rezoluta 1244, në dallim nga Marrëveshja e Rambujes, *nuk përmban dispozitat për lirim të të gjitha pengjeve dhe robërve të luftës, si dhe të burgosurve të tjerë politikë që mbahen në Serbi, si dhe për fatin e qindra personave të zhdukur nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë*. Pa dyshim, se ky lëshim është mjaft serioz dhe ka ndikuar që fati i këtyre personave të mos zgjidhet dhe ata padrejtësisht të mbahen në burgjet serbe.

10. Rezoluta 1244, në aneksin 1, pika 6, shprehimisht përcakton se *“pas tërheqjes, një numër i miratuar i personelit jugosllav dhe serb, do të lejohen të kthehen për të ushtruar funksionet e mëposhtme:*

- Lidhjet me misionin e forcës civile ndërkombëtare dhe forcës ndërkombëtare të sigurisë.

- Shënim/pastrimi i fushave të minuara.

- Mbajtja e një pranie në qendrat kulturore serbe.
- Mbajtja e një pranie në pikat kyçe të kufirit.

Edhe pse një rikthim i mundshëm i personelit serb dhe jugosllav është i limituar në disa qindra dhe i kushtëzuar me lejen e Komandantit të KFOR-it dhe PSSP-së, vetë ideja e një rikthimi të këtillë është mjaft e rrezikshme dhe me pasoja të paparashikuara. Për një rikthim të këtillë nuk ka asnjë arsye, sepse prania e sigurisë në Kosovë nëpërmjet trupave të KFOR-it, të policisë ndërkombëtare dhe tanimë edhe të Shërbimit Policor të Kosovës janë të mjaftueshme për të garantuar sigurinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallime etnike dhe dallime të tjera.

### **Fazat e administrimit ndërkombëtar në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244**

Rezoluta 1244 parashih një proces dinamik në Kosovë, që pretendon një sërë zhvillimesh politike, që nga ndalja e luftës dhe e armiqësive, ngritja e institucioneve demokratike e gjerë në krijimin e mjedisit të përshtatshëm për gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare të statusit juridiko-politik të Kosovës. Dinamika e realizimit të këtyre qëllimeve nuk është përcaktuar në aspektin kohor, por është e qartë se ato realizohen shkallë-shkallë varësisht nga zhvillimet politike në Kosovë dhe rreth Kosovës. Megjithatë, mund të veçojmë tri faza kryesore të administrimit ndërkombëtar, të cilat njëkohësisht paraqesin fazat e implementimit të Rezolutës 1244.

*Faza e parë* fillon nga miratimi i Rezolutës 1244 më 10 qershor 1999 dhe vazhdon gjerë në mbajtjen e zgjedhjeve vendore në nëntor të vitit 2000 dhe të zgjedhjeve të para parlamentare në tetor të vitit 2001. Gjatë kësaj faze në Kosovë instalohet prania civile ndërkombëtare (UNMIK-u) dhe ajo e sigurisë (KFOR-i) dhe krijohet administrata e përkohshme civile e bazuar në sistemin e bashkëqeverisjes (KPA, KTK etj.).

*Faza e dytë* e administrimit ndërkombëtar dhe e implementimit të Rezolutës 1244 fillon pas ndërtimit të institucioneve vendore demokratike, si

në nivelin vendor, ashtu dhe në atë qendror. Gjatë kësaj faze, krahas ndërtimit të institucioneve demokratike mbi bazën e zgjedhjeve, fillon bartja progresive e përgjegjësisë nga autoritetet ndërkombëtare në autoritetet vendore. Kjo fazë përfshin funksionalizimin e konceptit të vetëqeverisjes (autonomisë) substanciale, të përcaktuar me Rezolutën 1244, si zgjidhje të përkohshme, e cila duhet të shpejtojë zgjidhjen përfundimtare për statusin juridiko-politik të Kosovës.

*Faza e tretë* dhe e fundit e implementimit të Rezolutës 1244 është përcaktimi i statusit final për Kosovën. Kjo fazë nuk përfshihet në vetë Rezolutën 1244, por paraqet një nga qëllimet e saj. Në të vërtetë, të gjitha zgjidhjet juridiko-politike të Rezolutës 1244, janë në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare për Kosovën dhe synojnë krijimin e kushteve të përshtatshme për gjetjen e kësaj zgjidhjeje. Mekanizmi me të cilën do të përcaktohet statusi final i Kosovës nuk përfshihet me Rezolutën 1244 dhe paraqet një çështje hipotetike, që do të përcaktohet në të ardhmen nga faktorët me relevancë për Kosovën. Rezoluta përcakton se pas zgjidhjes finale të statusit të Kosovës, të gjitha autorizimet e faktorëve ndërkombëtarë në Kosovë do të barten në organet dhe autoritetet e Kosovës, të cilat do të themelohen pas zgjidhjes përfundimtare të statusit të saj.

## KORNIZA KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJEN E PËRKOHSHME NË KOSOVË

Shprehja “kornizë kushtetuese” është pak e njohur në teorinë dhe praktikën kushtetuese. Në thelb, fjala kornizë nënkupton limitet, përkatësisht kufinj të brenda të cilit rregullohet një materie e caktuar. Nisur nga kjo, emërimi “kornizë kushtetuese” do të përfshinte parimet e përgjithshme të rregullimit të një materieje kushtetuese. Megjithatë, ky akt është i natyrës konstitucionale dhe synon të përcaktojë bazat e rendit kushtetues të Kosovës në periudhën e administrimit ndërkombëtar.

Miratimi i Kornizës Kushtetuese ka filluar procesin e ndërtimit të

institucioneve legjislativë ekzekutive dhe gjyqësore në Kosovë. Njëkohësisht, me këtë akt fillon themelimi i vetëqeverisjes së përkohshme për Kosovën dhe bartja progresive e përgjegjësisë nga autoritetet ndërkombëtare, në institucionet vendore demokratike, të themeluara në zgjedhjet e lira. Baza juridike për nxjerrjen e kësaj Kornize Kushtetuese është përcaktuar në Rezolutën 1244, që parasheh ushtrimin e një qeverisjeje të mirëfilltë (substanciale) për Kosovën gjatë periudhës kalimtare. Pra, edhe ky akt, sikur edhe Rezoluta 1244, ka karakter të përkohshëm dhe do të vlejë deri në nxjerrjen e një rezolute të re nga KS të OKB-së, ose gjer në gjetjen e zgjidhjes finale statusore për Kosovën. Është interesant se Korniza Kushtetuese, duke përcaktuar parimet politike dhe juridike të statusit të Kosovës, i referohet Marrëveshjes së Rambujes që paraqet një absurd juridik, kur dihet se ajo nuk është nënshkruar nga palët negociuese dhe, si e tillë, nuk mund të prodhojë pasoja juridike. Në anën tjetër, referimi të kjo Marrëveshjeje, për rrethanat e reja (të krijuara pas genocidit serb në Kosovë) nuk është real, sepse tani kemi realitete faktike, të cilat duhet të avancojnë zgjidhjet juridike dhe politike.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme ka tre qëllime kryesore:

1. Të krijojë bazën juridike për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare dhe për krijimin e institucioneve legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore në nivel të Kosovës;

2. vendosjen e Vetëqeverisjes së Përkohshme për Kosovën brenda kornizës së përcaktuar me Rezolutën 1244 për periudhën kalimtare; dhe

3. përgatitjen e Kosovës për zgjidhjen finale politike, proces ky që është për një fazë të mëvonshme, pas përfundimit të administrimit ndërkombëtar të përcaktuar me Rezolutën 1244.

### **Çështjet kontestuese me rastin e hartimit të Kornizës Kushtetuese**

Procesi i miratimit të Kornizës Kushtetuese ka qenë mjaft i ndërlikuar dhe është karakterizuar me mospajtueshmërinë rreth disa zgjidhjeve

kushtetuese. Teksti i Kornizës, është hartuar nga grupi i përbashkët i përbërë nga 15 ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë. Hartimi i Kornizës nuk ka qenë vetëm një proces i thjeshtë i shkruarjes së një kushtetute, por ka pasur edhe mjaft elemente të negociatave politike rreth gjërësisë së qeverisjes që duhet të ketë Kosova në fazën kalimtare, strukturës institucionale të saj, kompetencave të organeve etj.

Në këtë proces ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt edhe Këshilli i Përkohshëm Administrativ (KPA), i cili me shumicë votash ka bërë miratimin politik të Kornizës Kushtetuese, të cilën e ka nënshkruar dhe shpallur PSSP-ja. Ekspertët kosovarë, të cilët kanë marrë pjesë në Grupin e Përbashkët, kanë këmbëngulur në katër kërkesa kryesore:

1. *Kosova edhe gjatë administrimit ndërkombëtar të ketë një Kushtetutë të Përkohshme.* Kjo, nga që Rezoluta 1244 nuk e kundërshton të drejtën e Kosovës për ta pasur Kushtetutën si akt më të lartë politik dhe juridik. Në anën tjetër, Kosova kishte një traditë kushtetuese, që nga viti 1969, 1974, 1990 (Kushtetuta e Kaçanikut). Madje, edhe në Konferencën Paqësore të mbajtur në Rambuje për Kosovën parashihej të ketë një Kushtetutë kalimtare për periudhën trevjeçare. Të gjitha këto argumente, të cilat u shtruan mjaft profesionalisht, nuk u morën parasysh nga UMNİK-u dhe dokumenti u emërtua si Kornizë Kushtetuese. Autoritetet ndërkombëtare në Kosovë emërtimin e dokumentit si Kushtetutë e kualifikonin si element që prejudikon statusin përfundimtar të Kosovës. Ky qëndrim nuk është i qëndrueshëm, sepse praktika konstitucionale vërteton se shumë entitete, edhe pse nuk ishin shtete me subjektivitet ndërkombëtar, kishin kushtetuta të tyre. Raste të tilla edhe sot hasim në shumë shtete federative. Së fundi, Kosova edhe në kohën kur nuk ishte shtet i pranuar ndërkombëtarisht (1974-1990) kishte kushtetutën e saj.

2. *Kërkesa për garancionin kushtetues lidhur me referendumin, përkatësisht shprehjen e lirë të vullnetit të popullit të Kosovës për statusin përfundimtar të Kosovës.* Pra, fjala është për garancionin

kushtetues, se zgjidhja përfundimtare për Kosovën do të bazohet në vullnetin e popullit të Kosovës. Kjo kërkesë ishte e propozuar nga ekspertët kosovarë dhe përkrahej nga opinioni i gjerë i Kosovës. Edhe pse u dha një argumentim, se kjo kërkesë është legjitime dhe në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe parimet e njohura për të drejtën e vetëvendosjes së popujve, ajo nuk hasi në mirëkuptim të UMNİK-ut dhe nuk është inkorporuar në tekstin e Kornizës Kushtetuese. Autoritetet ndërkombëtare konsideronin se kjo kërkesë bie ndesh me Rezolutën 1244 dhe prejudikon statusin përfundimtar. Kjo nuk është e qëndrueshme nga fakti se referendumi paraqet instrumentin më të vjetër të demokracisë, që nga Greqia Antike e deri te demokracitë moderne, të cilat njohin dhe zbatojnë këtë institucion. E dyta, referendumi ka qenë instrument me të cilat të gjitha ish-republikat jugosllave (me përjashtim të Malit të Zi) shpallën pavarësinë dhe morën njohjen ndërkombëtare. Edhe Kosova, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, mbajti referendumin, me të cilin deklaroi pavarësinë, që nuk mori njohjen ndërkombëtare. Në Konferencën e Rambujes ishte pikërisht klauzola për referendumin vendimtar me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes nga delegacioni shqiptar.

Është interesant se argumentet kryesore të autoriteteve ndërkombëtare kundër kërkesës për referendum bazohen në dy fakte kryesore: *e para*, se dhënia e kësaj garancie kushtetuese do të prejudikonte statusin final të Kosovës dhe, *e dyta*, teoria e re që tani po promovohet për rrezikshmërinë e referendunit në shtetet e tranzicionit, sidomos për shoqëritë e reja me përbërje shumetnike. Do të hedhim argumente juridike dhe politike, të cilat vërtetojnë paqëndrueshmërinë e këtyre konstatimeve.

Pohimi se përcaktimi i referendunit në Kornizën Kushtetuese është në kundërshtim me Rezolutën 1244 dhe se kjo do të prejudikonte statusin final nuk është i qëndrueshëm. Kërkesa për referencën për marrjen për bazë të vullnetit të popullit (referendunit) ka të bëjë me një periudhë të ardhshme, kur do të shtrohet zgjidhja përfundimtare, e jo për periudhën kalimtare deri sa Kosova do të jetë nën administrimin ndërkombëtar. Pra, ideja e

referendumit ka konsistuar në kërkesën që, kur të gjendet zgjidhja përfundimtare e statusit kushtetues dhe politik (që sigurisht do të jetë një proces ndërkombëtar), të merret për bazë vullneti i popullit të Kosovës, i cili do të shprehej përmes referendumit. Ky referendum, për shkak të pranisë aktuale ndërkombëtare në Kosovë, do të mund të ishte ndërkombëtar, pra, të shpallet, udhëhiqet dhe mbikëqyret nga autoritetet ndërkombëtare. Kërkesa për garancitë kushtetuese, për mbajtjen e referendumit, me rastin e zgjidhjes përfundimtare për Kosovën, nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244. Kjo Rezolutë, duke përcaktuar vetëqeverisjen e përkohshme, edhe vetë është në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare për Kosovën. Edhe Marrëveshja e Rambujes, së cilës i referohet Rezoluta 1244, ishte e karakterit të përkohshëm trevjeçar dhe përcaktonte referendumin si pjesë konstituive të zgjidhjes finale për statusin e Kosovës. Autoritetet ndërkombëtare nuk e kanë kuptuar drejt një kërkesë të këtillë. Madje ka pasur edhe keqkuptime, duke krijuar opinion se referendumi kërkohet për periudhën kalimtare, derisa Kosova ndodhet nën administrimin ndërkombëtar në bazë të Rezolutës 1244.

Argumenti i dytë, i cili është potencuar kundër përfshirjes së referendumit në Kornizën Kushtetuese, konsiston në teorinë, që tani po promovohet për gjoja rrezikshmërinë e referendumit në shtetet e Europës Lindore dhe përvojën e ish-republikave jugosllave, të cilat pas referendumeve për pavarësi, u ndeshën me agresionin dhe luftën e Serbisë në realizimin e aspiratës për liri dhe pavarësi. Si fakt tjetër theksohet se referendumi është i rrezikshëm për demokracitë e reja, sidomos ato që nuk janë homogjene në pikëpamje etnike dhe se mundëson majorizimin, përkatësisht mbivotimin e pakicave. Në vend të referendumit, me këtë rast favorizohen instrumentet e demokracisë përfaqësuese (parlamentare), pra, marrja e vendimeve nga parlamenti, qeveria etj. Një teori e këtillë bie ndesh edhe me praktikën ndërkombëtare, e cila është në favor të përdorimit të referendumit. Këtë e vërtetojnë referendumet e shpeshta të shteteve europiane për integrimin e tyre në Bashkimin Europian, si dhe referendumet kombëtare për çështjet e ndryshme,

në anën tjetër, praktika ka vërtetuar se shumica e shteteve të Europës Lindore, sidomos ato të Ballkanit, përmes referendumit kanë përcaktuar statusin e tyre dhe kanë hyrë në fazën e tranzicionit.

Në bazë të këtyre argumenteve mund të konkludojmë se kërkesa për referendum është kërkesë legjitime e shqiptarëve të Kosovës, në pajtim të plotë me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare, të cilat njohin dhe garantojnë të drejtën e vetëvendosjes së popujve. Zgjidhja politike e statusit final për Kosovën, përmes referendumit dhe deklarimit të drejtëpërdrejtë të qytetarëve të saj, është një zgjidhje demokratike, e cila do t'i jepte fund krizës në Kosovë dhe do të krijonte stabilitetin në rajon dhe me gjerë.

Përkundër argumentimit të bollshëm profesional, autoritetet ndërkombëtare refuzuan kërkesën e ekspertëve kosovarë (të cilët kanë dhënë tri kërkesa për referendumin) për një referim eksplicit të referendumit. Në vend të kësaj, në preambulën e Kornizës Kushtetuese, është dhënë një referim i cili parasheh marrjen parasysh të vullnetit të popullit në pajtim me Rezolutën 1244 dhe faktorë të tjerë. Ky formulim përcakton se bartja progresive e përgjegjësisive tek institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes bëhet *“me qëllim për të lehtësuar përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës nëpërmjet një procesi gjatë një faze të ardhshme të përshtatshme në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i cili do të marrë parasysh vullnetin e popullit dhe të gjithë faktorët e tjerë.”*

Një formulim i tillë nuk përcakton referendumin si instrument i përcaktimit të statusit final të Kosovës. Referenca që është dhënë për “marrjen parasysh të vullnetit të popullit dhe të gjithë faktorëve të tjerë”, e deplason idenë e referendumit, duke e lidhur mbajtjen e tij me Rezolutën 1244 dhe përcaktimet e saj juridike dhe politike.

Një kufizim i tillë i referendumit e kufizon deklarimin e vullnetit të popullit, sepse ai në formulimin që është dhënë kushtëzohet me Rezolutën 1244, që



për Kosovën parasheh një vetëqeverisje (autonomi) substanciale brenda “RF të Jugosllavisë”. Për një deklaram të këtillë, populli i Kosovës nuk ka nevojë, pasi qenia e dhunshme e Kosovës në kuadrin e RF të Jugosllavisë ishte burim i krizës dhe shkak i luftës çlirimtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Mendojmë se referendumi do të duhej plotësisht të ndahet nga Rezoluta 1244. Ky mekanizëm do të duhej zbatuar me rastin e zgjidhjes përfundimtare statusore për Kosovën. Pra, atëherë kur edhe vetë autoritetet ndërkombëtare do ta vlerësojnë se janë krijuar kushtet për gjetjen e zgjidhjes përfundimtare për Kosovën. Me arritjen e këtij procesi do të pushonte së funksionuari Rezoluta 1244 dhe do të kalohej në një fazë shumë më të avancuar të procesit politik – pra, në fazën e zgjidhjes përfundimtare për Kosovën. Në këtë fazë, referendumi do të ishte elementi konstitutiv i zgjidhjes finale. Themi element konstitutiv, sepse mekanizmi i zgjidhjes finale (i cili nuk është përcaktuar as me Rezolutën 1244) (të citohet mekanizmi i Rambujes që përcakton mbajtjen e konferencës ndërkombëtare), sigurisht do të jetë mjaft e komplikuar dhe do të involvojë faktorin ndërkombëtar, por edhe palët e interesuara në rajon. Në këtë proces referendumi do të mund të vinte në shprehje në dy rrethana: E para, pas përfundimit të administrimit ndërkombëtar dhe kryerjes së Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Në këtë rast Kombet e Bashkuara, para tërheqjes së tyre nga Kosova do të mund të shpallnin referendumin për statusin final të Kosovës dhe të udhëheqin realizimin e tij. Një veprim i këtillë do të ishte legjitim dhe demokratik, sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë, në bazë të deklaramit të qytetarëve të Kosovës, do të zgjidhej statusi politik i Kosovës. Rrethana e dytë, do të vinte në shprehje poqese zgjidhja përfundimtare do të ishte rezultat i ndonjë procesi ndërkombëtar (konferencë ndërkombëtare, marrëveshje ndërkombëtare). Edhe në këtë rast, zgjidhja politike ndërkombëtare do të duhej pranuar nga populli i Kosovës me referendum. Pra, edhe në rastin e dytë referendumi do të ishte me karakter konstitutiv dhe vendimtar dhe nga rezultati i tij do të varej zgjidhja përfundimtare për Kosovën.

Korniza Kushtetuese, duke mos pranuar kërkesën e ekspertëve kosovarë për një garanci më eksplicite kushtetuese për mbajtjen e referendumit për statusin final të Kosovës, ka bërë një interpretim dogmatik dhe mjaft të kufizuar të Rezolutës 1244. Duke pasur parasysh rrethanat e reja të krijuara në Kosovë dy vite pas miratimit të Rezolutës 1244, pra, avancimin e rrethanave politike dhe krijimin e realiteteve të reja, është pritur që kjo Kornizë të bëjë një interpretim më krijues të kësaj Rezolute, duke avancuar zgjidhjet politike, të cilat do të mënjanonin shumë paqartësi dhe kundërthënie që ngrihen në vetë këtë Rezolutë. Në këtë kontekst, garancia për referendumin në periudhën e mëvonshme nuk ka qenë në kundërshtim me vetë Rezolutën 1244, e cila siç dihet është akt i përkohshëm, në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare. Së fundi, shumë zgjidhje kufizuese kushtetuese, që Korniza Kushtetuese përcakton në sistemin e qeverisjes, të cilën do ta ushtrojë Kosova në periudhën kalimtare, si dhe pushteti që do të ngelë në autoritetin e PSSP-së, do të ishte i përkohshëm dhe do të pranohej më lehtë nga qytetarët e Kosovës, sikur ata të merrnin garancinë kushtetuese se zgjidhja finale do të jetë demokratike dhe do të marrë parasysh vullnetin e popullit që do të shprehej në referendum. Megjithatë, na mbetet të shpresojmë se në proceset politike, të cilat do të zhvillohen pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare përmes amendamenteve kushtetuese, Kuvendi i Kosovës do të mund të inkorporojë referendumin si pjesë të Kornizës Kushtetuese.

3. *Struktura e plotë institucionale për Kosovën* ishte kërkesë tjetër e ekspertëve kosovarë me rastin e hartimit dhe miratimit të Kornizës Kushtetuese. Kosova, edhe gjatë periudhës kalimtare, ka mundur të ketë të gjitha institucionet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, pra, Kuvendin, Qeverinë, Kryetarin, Gjykatën Kushtetuese, sistemin e plotë të gjyqësisë dhe organet dhe institucionet tjera. Korniza Kushtetuese parasheh këto organe të Kosovës: Kuvendin, Qeverinë, Kryetarin, Gjykatën Supreme dhe organe të tjera të gjyqësisë. Në vend të Gjykatës Kushtetuese është paraparë formimi i një kolegji të posaçëm për Mbajtjen e Kornizës Kushtetuese. Edhe pse

Korniza Kushtetuese në Parimet Themelore proklamoi parimin e ndarjes dhe ballancës midis tri pushteteve, dispozitat kushtetuese kanë lënë në autoritetin e PSSP-së mjaft çështje nga kompetenca e këtyre organeve, të cilat atë e bëjnë të jetë autoritet përfundimtar në sferën legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore. Autorizimet e tij janë mjaft të gjera dhe autoriteti i tij, që buron nga Rezoluta 1244, nuk është kufizuar me Kornizën Kushtetuese. Ai ka të drejtë të shpërmdajë Kuvendin, të shpallë ligjet, të përdorë të drejtën e vetos ndaj ligjeve të Kuvendit, të emërojë dhe shkarkojë gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe një mori kompetencash të tjera, të cilat janë tipike për pushtetet presidenciale. E tërë kjo vërteton se vetëqeverisja, të cilën do ta ketë Kosova gjatë periudhës kalimtare, jo vetëm që do të jetë e kufizuar me elementet shtetërore, por edhe e mbikqyrur dhe kontrolluar nga PSSP-ja. Kjo do të thotë se, në vend të një koncepti të një qeverisjeje efektive dhe funksionale, Korniza Kushtetuese përcaktoi një koncept të qeverisjes së kontrolluar, e cila duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 1244.

4. *Korniza Kushtetuese, edhe pse paraqet një akt të përkohshëm juridik, nuk është kufizuar në pikëpamje kohore.* Kërkesa për të caktuar kohëzgjatjen e periudhës kalimtare, pra, edhe të administrimit ndërkombëtar, nuk është pranuar nga autoritetet ndërkombëtare. Si arsye për këtë ata theksojnë se edhe Rezoluta 1244 nuk është e kufizuar në pikëpamje kohore dhe ajo do të vlejë gjerë në nxjerrjen e ndonjë rezolute tjetër të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që do t'a shfuqizojë atë ose deri në përcaktimin e zgjidhjes përfundimtare për Kosovën.

Përkundër këtij kufizimi legal, mendojmë se ka mundur që me Kornizën Kushtetuese të përcaktohet periudha trevjeçare e vlefshmërisë së saj, duke pasur parasysh se edhe kohëzgjatja e mandatit të organeve të Kosovës (Kuvendi, Qeveria dhe Kryetari) është tre vjet. Kufizimi kohor i Kornizës Kushtetuese nuk do të thotë edhe kufizim i administrimit ndërkombëtar në Kosovë. Mendohet se periudha prej tre vitesh është e mjaftueshme për të përgatitur kushtet për një zgjidhje përfundimtare për Kosovën.

### **Mekanizmi i zgjidhjes përfundimtare të statusit të Kosovës**

Një nga objektivat themelore të Rezolutës 1244 dhe të misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë është krijimi i kushteve të përshtatshme për gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare për statusin juridiko-politik të Kosovës. Ky qëllim do të realizohet pas një periudhe kalimtare dhe administrimi të përkohshëm ndërkombëtar në Kosovë, në momentin kur qendrat relevante të vendosjes ndërkombëtare do të vlerësojnë se janë plotësuar kushtet për përcaktimin e statusit final të Kosovës. Rezoluta 1244 nuk ka përcaktuar mekanizmin e zgjidhjes finale të statusit të Kosovës, duke e lënë këtë për një fazë të mëvonshme. Pra, zgjidhja finale e statusit të Kosovës nuk është pjesë e Rezolutës 1244 dhe e Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Detyrë e këtij misioni është avancimi i procesit në Kosovë dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për përcaktimin e statusit final të Kosovës.

Edhe pse Rezoluta 1244 paraqet një akt të përkohshëm juridik, kohëzgjatja e saj nuk mund të prejudikohet dhe varet nga një mori rrethanash juridike dhe politike, të cilat janë të lidhura për Kosovën. Me këtë rast shtrohet pyetja se si mund të ndryshohet kjo Rezolutë. Kjo shtrohet tani kur është më se e qartë, se shumë përcaktime të saj janë tejkaluar dhe nuk përputhen me realitetin e ri të krijuar në Kosovë tre vjet pas miratimit të saj. Për aq më tepër, disa përcaktime politike të Rezolutës, të cilat njohin integritetin e RF të Jugosllavisë ndaj Kosovës, janë anakronike dhe burim i tensioneve të vazhdueshme politike dhe e pakënaqësisë së popullit të Kosovës. Bazat e ndryshimit të Rezolutës 1244 janë të natyrës juridike dhe politike. Motivet politike mbështeten në vlerësimin për ndërrimin e rrethanave politike në Kosovë, kurse ato juridike shprehen në instrumentet dhe procedurat adekuate për ndryshimin e Rezolutës. Gjykimi politik për arsyeshmërinë e ndryshimit të Rezolutës 1244 e jep Këshilli i Sigurimit të OKB-së, i cili është edhe autor i saj, në bazë të një konsensusi të pesë shteteve që janë anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit. Instrumenti juridik me të cilin ndryshohet kjo Rezolutë,

do të ishte një rezolutë e re, e cila do të shfuqizonte ose plotësonte Rezolutën 1244. Ndërkaq, procedura e ndryshimit është plotësisht identike me atë të miratimit të Rezolutës 1244, pra, me pëlqimin e pesë shteteve anëtare të përhershme të KS të OKB-së, përkatësisht pa përdorimin e së drejtës së vetos nga ndonjëra prej tyre. Një mundësi tjetër e shfuqizimit të Rezolutës 1244 është realizimi i misionit të saj me gjetjen e zgjidhjes finale të statusit politik të Kosovës dhe përfundimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Për këtë arsye, është vështirë të prejdukohet se kur do të përcaktohet dhe zbatohet mekanizmi i zgjidhjes finale të statusit të Kosovës. Kjo çështje paraqet një çështje faktike dhe objektive, e cila do të vlerësohet nga faktorët ndërkombëtarë dhe ata vendor. Në këtë aspekt, Marrëveshja e Rambujes ishte shumë më decisive dhe shprehimisht përcaktonte se, tri vjet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, do të thirret një mbledhje ndërkombëtare, për të determinuar një mekanizëm për një vendosje (zgjidhje) finale për Kosovën, në bazë të vullnetit të popullit, të mendimeve të autoriteteve relevante, të përpjekjeve të secilës palë në lidhje me implementimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të Aktit Final të Helsinkit, dhe që të ndërmerren vlerësimet e përgjithshme për implementimin e kësaj Marrëveshjeje, duke i konsideruar propozimet nga secila palë për masat shtesë. Edhe pse mekanizmi i zgjidhjes finale me këtë rast nuk ka qenë shprehimor, ai ka paraprirë se pas tri vjetësh do të mbahet një konferencë e re ndërkombëtare e nivelit të lartë, që do të përcaktojë se cili do të jetë mekanizmi përfundimtar për zgjidhjen e statusit të Kosovës, duke marrë për bazë vullnetin e popullit (referendumin) të Kosovës dhe fakte të tjera relevante.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme nuk ka përcaktuar asnjë kufi kohor përsa i përket zgjidhjes finale të statusit të Kosovës. Ajo, në preambulë, përcakton qëllimet e Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Me këtë rast, si një nga detyrat kryesore të këtij Misioni, theksohet krijimi i kushteve, të cilat do të lehtësojnë marrjen e vendimit

për statusin e ardhshëm të Kosovës nëpërmjet një procesi gjatë një faze të ardhshme të përshtatshme në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i cili do të marrë për bazë të gjithë faktorët relevantë, duke përfshirë vullnetin e popullit. Nuk ka dilemë se ky formulim është mjaft i përgjithësuar dhe konfuz dhe nuk vë në pah fare se cili do të jetë mekanizmi për zgjidhjen finale dhe se çfarë roli në këtë mekanizëm do të ketë vullneti i popullit të Kosovës.

Duke qenë se mekanizmi i zgjidhjes finale aktualisht paraqet një çështje hipotetike dhe të papërcaktuar, lidhur me këtë mund të jepen vetëm paragjykimet dhe parashikimet dhe asesi fakte të vërteta. Ky mekanizëm do të përcaktohet në një fazë të mëvonshme, varur nga avancimi i procesit politik dhe shpejtësia e kalimit të fazës kalimtare në Kosovë. Sigurisht që rol zotërues në përcaktimin e statusit final të Kosovës do të ketë faktori ndërkombëtar dhe sidomos Kombet e Bashkuara, të cilat tani administrojnë Kosovën dhe kanë për detyrë përsheptimin e procesit të zgjidhjes finale të statusit të Kosovës. Në qarqet politike dhe profesionale përfaqësohen tri opsione lidhur me mekanizmin e zgjidhjes finale të statusit përfundimtar të Kosovës.

1. Opsioni i parë përfaqësohet nga ekspertët kosovarë dhe të gjitha subjektet politike të shqiptarëve të Kosovës. Sipas këtij opsioni, mekanizmi i zgjidhjes finale duhet të konsistojë në të drejtën e popullit të Kosovës që, pas skadimit të administrimit ndërkombëtar, statusi final i Kosovës të përcaktohet me referendum, ku populli i Kosovës do të shprehte vullnetin e tij politik. Kjo kërkesë është e bazuar dhe paraqet një zgjidhje demokratike të statusit të Kosovës. Kërkesa për referendum ishte një nga përparësitë kryesore të shprehura në Konferencën e Rambujes dhe me rastin e hartimit të Kornizës Kushtetuese. Referendumi, si një nga instrumentet më të vjetra të demokracisë, do të mundësonte vetëvendosjen e popullit të Kosovës dhe do të krijonte një zgjidhje të qëndrueshme për Kosovën. Duke qenë se Kosova aktualisht administrohet nga Kombet e Bashkuara, do të ishte logjike që në

mbarim të këtij administrimi do mbahet referendumi, nga i cili do të buronte zgjidhja finale për Kosovën. Rreth një koncepti të këtillë ende nuk ekziston një mbështetje e plotë ndërkombëtare. Kundërshtarët e këtij mekanizmi theksojnë rrezikshmërinë e referendumit në shtetet e Europës Lindore, e sidomos në ish-republikat jugosllave. Duke u nisur nga praktika e referendumeve në ish-Jugosllavi, ata pohojnë se pas çdo referendumi atje ka filluar një luftë e përgjakshme. Në këtë kontekst, sipas tyre, referendumi në Kosovë do të rezultonte me një votim absolut pro pavarësisë së Kosovës dhe do të majorizonte pakicat e tjera, sidomos atë serbe. Këto vërejtje nuk janë të qëndrueshme, sepse shumica e shteteve të reja lindin dhe konstituohen pikërisht përmes referendumit si instrument demokratik. Ai do të shprehte vullnetin burimor të popullit të Kosovës, pa dallim përkatësie etnike.

2. Mekanizmi tjetër i zgjidhjes përfundimtare të statusit të Kosovës përfaqësohet nga qarqet ndërkombëtare shkencore dhe profesionale dhe propozon mbajtjen e një konference të re ndërkombëtare për gjetjen e zgjidhjes përfundimtare të statusit të Kosovës. Një mundësi e tillë ishte parashikuar shprehimisht në Marrëveshjen e Rambujes dhe ajo ka mjaft ithtarë në qendrat ndërkombëtare të vendimmarrjes. Ky mekanizëm konsiderohet si formë adekuate e pjesëmarrjes së Kosovës dhe Serbisë në negociata politike me ndërmjetësimin e fuqishëm ndërkombëtar. Duke pasur parasysh joefektivitetin e Kombeve të Bashkuara në zgjidhjen e krizave në të kaluarën, si dhe heterogjenitetin e UNMIK-ut në Kosovë, një mekanizëm i këtillë do të mund të ishte i frytshëm vetëm nëse udhëhiqet nga SHBA-ja, e cila duhet të ketë rolin përparësor dhe vendimtar në procesin e zgjidhjes politike të statusit final të Kosovës.

Duke pasur për bazë zhvillimet e reja në rajon, mundësinë eventuale të pavarësimit të Malit të Zi, si dhe krizën aktuale ndëretnike në IRJ të Maqedonisë, nuk janë të rralla nismat, që zgjidhja politike e statusit juridiko-politik të Kosovës, të jetë pjesë e një zgjidhjeje globale për Ballkanin si tërësi. Këto tendenca bien në kundërshtim me aspiratat e popullit të Kosovës për integritime euroatlantike dhe për përfshirjen e saj në proceset globaliste.

3. Opsioni i tretë i mekanizmit për zgjidhjen e statusit final të Kosovës përfaqësohet nga autoritetet serbe dhe aleatët e tyre dhe konsiston në bisedimet e drejtpërdrejta shqiptaro-serbe dhe për një status të avancuar të Kosovës brenda RF të Jugosllavisë. Është më se e qartë se ky opsion është i pamundshëm dhe plotësisht i papranueshëm për popullin e Kosovës dhe përfaqësuesit e tij politikë. Me autoritetet serbe, përfaqësuesit politik të shqiptarëve mund të bisedojnë vetëm për një proces të ndarjes paqësore dhe për kushtet e tjera të kësaj ndarjeje, siç janë: reperacionet e luftës, kompensimet e dëmet si pasojë e plaçkitjes së pasurisë së Kosovës, dorëzimi i robërve të luftës dhe ndriçimi i fakteve për fatin e tyre, procesin e mëpastajmë etj.

Krahas dilemës rreth mekanizmit final për zgjidhjen e statusit të Kosovës është e paqartë se cila do të jetë zgjidhja e këtij statusi. Në këtë aspekt ende nuk ka një pajtueshmëri të plotë për pavarësinë e Kosovës, si zgjidhje e drejtë e krizës. Disa shtete ende vazhdojnë të mbajnë rezervat e tyre ndaj opcionit të pavarësisë së Kosovës, duke e trajtuar atë si një opsion të skajshëm. Me këtë rast, jo vetëm në qarqet politike, por edhe në ato profesionale, theksohen dy vërejtje themelore të opcionit të pavarësisë së Kosovës.

E para, teza se pavarësia e Kosovës do të destabilizonte rajonin dhe të rredukonte efekte zinxhirore në rajone të tjera të krizës dhe sidomos të IRJ të Maqedonisë, ku vitin e kaluar shpërtheu një konflikt i armatosur ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonëve. Një pohim i këtillë është i paqëndrueshëm dhe pa bazë shkencore, sepse njohja e pavarësisë së Kosovës jo vetëm që nuk destabilizon situatën në Maqedoni, por mund të ndikojë në mënyrë qetësuese në këtë vend, duke orientuar kërkesat e shqiptarëve në rrugë institucionale dhe në drejtim të realizimit të barazisë dhe shtetformësisë së tyre në këtë republikë.

E dyta, teza se pavarësia e Kosovës do të përbënte një precedent të rrezikshëm, të cilin do të mund ta ndiqnin grupe të tjerë, si kurdët, baskët ose



kushdo tjetër, është po ashtu e paqëndrueshme. Ata që mbështesin këtë tezë nuk e njohin mirë realitetin e Kosovës, faktin se ajo ishte e aneksuar dhunshëm nga Serbia, si dhe të drejtën e saj legjitime për vetëvendosje, që aktualizohet pas shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave. Pavarësia e Kosovës nuk paraqet kurfarë precedenti të ri, por përsëritjen e asaj që ndodhi në Slloveni, Kroaci, Maqedoni ose Bosnjë gjatë viteve 1991-1992. Ajo që ndodhi gjatë këtyre dy viteve nuk ishte shkëputje nga një shtet jugosllav që ende ekzistonte, por ishte shpërbërja e plotë e Federatës Jugosllave dhe një proces legjitim i pavarësisht të konstituentëve të saj. Në aspektin kushtetues, Kosova përbënte një nga subjektet konstitutive të kësaj Federate, prandaj edhe ajo, njësoj sikur njësitë e tjera federale, kishte të drejtën e deklarimit të pavarësisë së saj.

Disa nga autorët, si një nga variantet e mundshme të zgjidhjes së krizës në Kosovë theksojnë ndarjen e territorit të saj. Këta sikur harrojnë se pikërisht me vendimet e padrejta historike territori i Kosovës është ndarë dhe coptuar, duke u rudhur në kufijtë e saj të sotshëm. Çdo ide eventuale e ndarjes së territorit të Kosovës bart në vete rrezikun e eskalimit të ri të konfliktit, me pasojë të paparashikueshme për rajonin.

Së fundi, si një nga opsionet për zgjidhjen e statusit të Kosovës paraqitet projekti për Pavarësinë e Kushtëzuar për Kosovën, nga Grupi Internacional i Krizës, i udhëhequr nga Riçard Goldston. Sipas këtij projekti, Kosovës i njihet pavarësia e kushtëzuar, duke siguruar një kontroll ndërkombëtar të kufijve të jashtëm të saj dhe duke monitoruar të drejtat e komuniteteve të tjera. Edhe pse një opsion i tillë është mirëpritur nga shumë qarqe ndërkombëtare dhe vendore, mendoj se ai mund të paraqesë vetëm një zgjidhje të përkohshme, përkatësisht një kompromis kalimtar që duhet të rezultojë me pavarësinë e plotë të Kosovës.

# Hetimi ad hoc parlamentar i shërbimit informativ

*- Një përvojë e re shqiptare e përqasur me legjislacionin europianoperëndimor -*

*Fatos Beja  
Deputet*

Krijimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së Shërbimit Informativ të Shtetit, pavarësisht nga motivi i krijimit të tij dhe mënyra e hartimit të raportit përfundimtar ose qëndrimin e Kuvendit ndaj këtij raporti, përbën pa asnjë dyshim një hap përpara në veprimtarinë parlamentare shqiptare dhe rritjen e ndjeshmërisë së publikut ndaj një veprimtarie të Kuvendit. Kemi tashmë një përvojë të re shqiptare, edhe pse sprova janë bërë edhe më parë, për një instrument parlamentar të përdorur gjerësisht në vendet e Bashkimit Europian, pavarësisht nga diversiteti i përbërjes, i bazës ligjore ose i kompetencave të tij.<sup>1</sup>

Në të vërtetë, ligji shqiptar e njëjtte hetimin parlamentar, qoftë në Kushtetutë (neni 77 pika 2), qoftë në rregulloren e Kuvendit (nenet 164 e 165). Megjithatë, miratimi, në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Kushtetutës, i ligjit nr.8891, datë 2.5.2002, me 25 nene, plotëson me një bazë të gjerë ligjore ushtrimin e kontrollit parlamentar nëpërmjet komisioneve të hetimit. Krijimi i këtij

---

<sup>1</sup> Shih: Berberi S., “Komisionet parlamentare të hetimit: instrumente të rëndësishme kontrolli”, revista “E Drejta Parlamentare dhe Politikat Ligjore”, 2001/5 , f.36-46.

Komisioni të parë Hetimor, për të kontrolluar në një fushë kaq delikate si shërbimi i fshehtë, e bëri edhe më të vështirë funksionimin normal të tij. Nga ana tjetër, ndjeshmëria e përgjithshme me të cilën u përcoll veprimtaria e këtij Komisioni dhe rëndësia politike, për maxhorancën dhe opozitën, e përfundimeve që do të dilnin nga hetimi, nxori në pah disa defekte të rëndësishme të ligjit, korrigjimi i të cilave bëhet i domosdoshëm për funksionimin e komisioneve të tjera në të ardhmen.

Unë do të ndalem këtu kryesisht në një aspekt, i cili përbën një kundërvënie në parim midis ligjit organik dhe Kushtetutës dhe që, në provën e parë të ligjit, gjatë punës së Komisionit për Hetimin e veprimtarisë së shërbimit të fshehtë, dëshmoi në praktikë efektin e saj bllokues për qëllimin e krijimit të Komisionit.

1. Pika 2 e nenit 77 të Kushtetutës thotë midis të tjerave se “*Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një të katërtës të të gjithë anëtarëve të tij është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë.*” Me fjalinë e mësipërme Kushtetuta njeh dy mundësi për krijimin e një komisioni hetimor:

a) me nismën e një numri deputetësh më të vogël se  $\frac{1}{4}$  e numrit të anëtarëve të tij dhe në këtë rast Kuvendi *ka të drejtë* të vendosë për ta krijuar ose për të mos ta krijuar komisionin e kërkuar;

b) me nismën e  $\frac{1}{4}$  ose më tepër të deputetëve të tij, Kuvendi *është i detyruar* të miratojë komisionin. Dhe në këtë rast Kuvendit i mohohet e drejta që të vendosë për krijimin ose moskrijimin e komisionit të kërkuar.

Kjo do të thotë: në qoftë se nismën për krijimin e Komisionit e marrin deputetë të opozitës, në rastin e parë (a) krijimi i Komisionit varet nga vullneti i maxhorancës parlamentare, mbasi kërkesa do t'i nënshtrohet votimit në Kuvend. Ndërsa në rastin e dytë (b), kërkesa e 35 ose më shumë deputetëve nuk i nënshtrohet votimit dhe Komisioni krijohet edhe kundër vullnetit të maxhorancës parlamentare.

Ky nen i Kushtetutës krijon një hapësirë të vërtetë veprimi parlamentar

për një çështje që përbën shqetësim për një numër të konsiderueshëm të deputetëve edhe kundër vullnetit të maxhorancës parlamentare. Vlera e kësaj hapësire bëhet edhe më e rëndësishme, kur 35 nismëtarët janë të gjithë deputetë të opozitës, sepse i jep mundësi kësaj të përdorë një instrument ligjor për të hetuar një çështje të rëndësishme për të ose për opinionin public, kundër vullnetit të maxhorancës qeverisëse. Kuptohet, në analizë të fundit, frytshmëria e komisionit shkon në dobi të mirëqeverisjes së vendit, të transparencës së qeverisjes dhe të rritjes së rolit të Kuvendit në kontrollin e pushteteve të tjera. Një e drejtë e tillë për një të katërtën e Parlamentit gjendet vetëm te rregullorja e Bundestagut Gjerman, ndërkohë që te vendet e tjera anëtare të BE-së, miratimi i komisioneve hetimore i nënshtrohet votes, pra, dhe vullnetit të maxhorancës parlamentare. Futja në Kushtetutën Shqiptare e kësaj të drejte është tërësisht në përputhje me trendin e përgjithshëm të respektit të zërit minoritar, trend që shkon në rritje në forma e mënyra të ndryshme në vendet e BE-së dhe pa dyshim ndihmon në rritjen e demokracisë. Në Danimarkë e Hollandë të drejtën e nismës për të krijuar një komision hetimor e ka edhe një deputet, ndërsa në Spanjë e Portugali, përveç deputetëve, këtë të drejtë e ka edhe qeveria (kuptohet për të vënë në lëvizje kontrollin parlamentar edhe në drejtim të pushteteve të tjera jashtë fushës së veprimit të ekzekutivit).

Megjithatë, si në parlamentet e tjera të Europës, ashtu dhe me Kushtetutën e ligjin shqiptar, përfundimet e hetimit dhe rekomandimet e sugjerimet e mundshme, që mund të sjellin deputetët nismëtarë, i nënshtrohen procesit të zakonshëm vendimmarrës të Kuvendit, pra, votës dhe vullnetit të maxhorancës parlamentare. Pra, liria që i njihet një të katërtës së Kuvendit tretet para të drejtës vendimmarrëse të maxhorancës, çka përbën në analizë të fundit një rritje të demokracisë brenda parlamentit, pa e cenuar funksionimin bazë të tij.

Për fat të keq, ky hap përpara i Kushtetutës u neutralizua nga ligji nr.8891 datë 2.5.2002 “Për komisionet hetimore”, i cili në nenin 9 pika 2 kërkon që

*“Komisioni (të) përbëhet nga deputetë të partive të pozitës dhe të opozitës, në raporte sa më të afërta përfaqësimi.”* dhe në nenin 13 pika 2 kërkon që *“Komisioni (të) marrë vendime të ndërmjetme me shumicën e anëtarëve të pranishëm, ndërsa vendimet përfundimtare merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.”* Është e qartë se, ndërsa Kushtetuta u jep të drejtë 35 ose më shumë deputetëve të ngrejnjë një komision kundër vullnetit të shumicës, e drejtë që, megjithatë, po nga Kushtetuta kufizohet kur thotë se *“Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t’i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore.”* (neni 77 pika 2) dhe se *“Kuvendi vendos me shumicën e votave”* (neni 78), ligji, i cili e rimerr këtë kufizim në nenin 14/dh, që kërkon miratimin e raportit përfundimtar nga Kuvendi, e *neutralizon krejt Kushtetutën* kur bërjen e konkluzioneve të hetimit ia heq përfaqësuesve të 35 deputetëve kërkues të hetimit dhe ia jep maxhorancës parlamentare edhe në Komision!

Megjithë kundërshtimin e opozitës në seancën e miratimit të ligjit, maxhoranca votoi për futjen e pikës 2 në nenin 9, të pikës 2 në nenin 13 dhe të shkronjës “dh” në nenin 14, të cilat garantojnë kontrollimin e tërë procesit të hetimit nga shumica parlamentare dhe jo nga grupi nismëtar që ka kërkuar hetimin.

Në kushtet kur Kushtetuta ia jep të drejtën një të katërtës së deputetëve të hetojnë për një çështje kundër vullnetit të shumicës parlamentare dhe ligji organik u a mohon këtë të drejtë, kuptohet se çdo komision i zënë midis dy vullneteve të tilla të kundërta është i shtrënguar të dështojë në hetimin e tij, aq më tepër që komprometimi i Gjykatës Kushtetuese në raport me opozitën nuk lë hapësirë shprese për një rol lirues prej saj.

2. Komisioni i parë Hetimor që u krijua mbi bazën e këtij ligji, dëshmoi tërësisht këtë bllokim të funksionimit normal të Komisionit nga kundërvënia e ligjit organik me kushtetutën. Në vendimin nr.52, datë 31.7.2002 “Për krijimin e komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e akuzave lidhur me veprimtarinë e SHISH-it dhe të Drejtorit të tij, z.F.Klosi” pika III thotë se *“Komisioni*

*përbëhet nga 9 anëtarë, prej të cilëve 5 nga partitë e opozitës dhe 4 nga partitë e opozitës*". Shtojmë se ky vendim është njëkohësisht në kundërvënje me paragrafin e fundit të nenit 164 të rregullores së Kuvendit për komisionet e hetimit<sup>2</sup>, i cili thotë: *"Në përbërjen e komisionit përfaqësohen të gjitha grupet parlamentare në përpjesëtim me numrin që ato zënë në Kuvend."* Por, ajo që ka rëndësi për argumentin është se vendimi i Kuvendit cakton në Komision 4 përfaqësues të 37 deputetëve të opozitës që kanë nënshkruar për të hetuar veprimtarinë e SHISH-it dhe 5 deputetë socialistë që nuk e kanë këtë dëshirë, por që vendosin në Komision.

Ky vullnet negativ pati pasojat e tij konkrete e të kuptueshme në punën e Komisionit, duke e nxjerrë atë nga hulla e një instrumenti të mirëfilltë të kontrollit e të hetimit parlamentar dhe duke i dhënë më shumë funksionin e një forumi të show-t publik. Vullnetet e kundërta u shfaqën gjatë gjithë punës së Komisionit:

- Qysh në fillim, komisionerët socialistë kërkuan në Komision që të caktonin ekspertët e "tyre", si reagim ndaj ekspertëve të gjetur nga Kryetari i Komisionit, mbasi dy prej tyre kishin qënë oficerë të SHIK-ut në kohën e qeverisjes së PD-ës ( në një moment tensioni, kur komisionerët socialistë dolën nga seanca e dëgjimit të dëshmimeve në shenjë proteste, menjëherë pas tyre dolën nga seanca edhe "ekspertët e tyre").

- Mandej, komisionerët socialistë i u imponuan Komisionit me votë, duke bllokuar kërkesën për të thirrur para Komisionit ish-Presidentin Meidani, i cili me dëshminë e tij, ashtu si Kryeministri Nano dhe ish-Presidenti Berisha, do të mund të ndihmonte shumë Komisionin në hetimin e veprimtarisë së SHIK-ut kur ai ishte President.

---

<sup>2</sup> Në të vërtetë kemi të bëjmë me një tjetër defekt të ligjit, i cili duhej të kishtë shfuqizuar nenet 164 dhe 165 të rregullores së Kuvendit për komisionet e hetimit, të cilat me miratimin e ligjit zëvendësohen prej tij.

- Komisionerët socialistë nuk dëshmuuan asnjë interes për të hetuar dhe nuk morrën pjesë në kontrollet që komisionerët opozitarë bënë në SHISH. Të gjitha dokumentet që administroi Komisioni janë dokumente të gjetura e të tërhequra me nënshkrimin e komisionerëve të opozitës dhe janë shumë më të pakta në numër sesa dokumentet që komisionerët opozitarë panë në SHISH.

- Vullneti i kundërt *vis a vis* objektit të hetimit nga të dy grupet e Komisionit u shfaq edhe në seancat e dëgjimit, gjatë të cilave komisionerët socialistë u bënë palë *en bloc* me dëshmitarët që depononin në favor të ish-Kryetarit të akuzuar nga opozita. Ky qëndrim ishte fare i qartë gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë të dëshmisë së Klosit në Komision, kur telespektatorët, në vend të një komisioni parlamentar që i bënte pyetje ish-Drejtorit të SHIK-ut për të kuptuar funksionimin e këtij institucioni nën drejtimin e tij, panë të renditura ballëpërballë dy palë: nga një anë komisionerët opozitarë me pyetjet e tyre akuzuese dhe nga ana tjetër ish-Drejtorin Klossi me komisionerët socialistë që i kundërviheshin këtyre akuzave.

Ky qëndrim kundërvënës brendapërbrenda Komisionit u projektua shumë shpejt e me intensitet në të gjithë opinionin publik, i cili, ç'është e vërteta, dëshmoi një interes të jashtëzakonshëm për punën e Komisionit.<sup>3</sup> Duke përjashtuar Kryeministrin Nano, i cili, i dëshmoi mbështetje punës së Komisionit, duke ardhur me nismën e tij dy herë para Komisionit e duke i prurë rezultatet e kontrollit të tij administrativ, përfaqësuesit e tjerë më në zë të maxhorancës socialiste iu kundërvunë publikisht punës së Komisionit dhe madje, ekzistencës së tij. Përmendim, për shembull, deklaratën e Kryetarit

---

<sup>3</sup> Mund të themi se objekti i hetimit të këtij komisioni vuri në punë sa deputetët komisionerë, aq dhe shtypin e shkruar e median elektronike, të cilët në mënyrë të përditshme i hapën faqet e para të gazetave dhe emisionet radiotelevizive me veprimtarinë e tij, i rezervuan emisione e faqe të veçanta anëtarëve të Komisionit e gazetarëve më të njohur etj. Mjafton të përmendim se dëshmitë në Komision të ish-Drejtorit Klossi e të ish-Presidentit Berisha u transmetuan drejtpërdrejt nga televizionet kombëtare e TV private më të fuqishme.

të Kuvendit, Pëllumbi e të Kryetarit të Komisionit të Ligjeve e të Çështjeve Kushtetuese, Braho për ndërprerjen e hetimeve të Komisionit, deklaratën e Kryetarit të Grupit Parlamentar të PS, Ruçi që përcaktonte paraprakisht qëndrimin e komisionerëve socialistë gjatë hartimit të raportit përfundimtar, kundërvënien publike të ish-Presidentit Mejdani ndaj Komisionit e deklaratat e mjaft deputetëve të tjerë të njohur të maxhorancës kundër Komisionit, para se ai të mbaronte hetimet e të delte me një raport mbi bazën e dokumenteve e dëshmime të grumbulluara prej tij.

Preteksti i këtij qëndrimi kundër Komisionit u bë akuza se komisionerët e opozitës po nxirrnin sekretet e shërbimit inteligjent, duke e dëmtuar rëndë atë, akuzë që u formulua publikisht nga ish-Drejtori nën hetim dhe mbështetësit e tij e që kulmoi me një letër proteste që Drejtori i komanduar i SHISH-it i dërgoi urgjentisht Komisionit gjatë seancës së dëgjimit të Klosit në Komision të transmetuar drejtpërdrejt në televizion. Në të vërtetë, pretendimet e pabaza se deputetët opozitarë po dekonspironin sekrete agjenturore, mund të kenë krijuar panik në rrjetin informativ, çka e detyroi Drejtorin e komanduar të deklarojë në Komisionin e Përhershëm të Rendit dhe SHISH-it se hetimet parlamentare nuk kishin nxjerrë sekrete.

Arsyeja e vërtetë duket se ishte akuza e komisionerëve opozitarë se shërbimi inteligjent kishte operuar në kundërshtim me ligjin kundër opozitës gjatë pesë vjetëve të fundit dhe se shërbimi kishte përgjegjësi në vrasjen e deputetit të opozitës Azem Hajdari. Në fakt, ky “politizim i hetimit” që dha shkas për një ndërprerje *de facto* të punës hetimore të Komisionit <sup>4</sup> buron

---

<sup>4</sup> Pas akuzave publike të Klosit, komisionerët e opozitës, që shkonin për hetime në zyrat e SHISH-it filluan të pengoheshin në marrjen e dokumenteve që kërkonin. Drejtori i komanduar krijoi një “grup specialistësh” që filtronte çdo dokument që kërkonin deputetët hetues dhe vendoste nëse dokumenti që kërkohet ishte ose s’ ishte i dobishëm për objektin e hetimit. Ky veprim që nuk mbështetet në ligj, ishte tërësisht kundërproduktiv, sepse linte në dyshim deputetin se dokumenti që refuzohej mund të ishte pikërisht dokumenti që vërtetonte fajësinë



që nga kërkesa e 37 deputetëve të opozitës, për të hetuar për këto dy çështje dhe pasqyrohet edhe në vendimin e Kuvendit për krijimin e Komisionit. Por, çdo hetim nga deputetët e çdo opozite do të mund të “politizohet” nga maxhoranca, po qe se kjo e fundit ndjehet “e cenuar”, kur ata denoncojnë një shkelje ligji që i ka shërbyer interesit të saj partiak. Kjo do të thotë se një “politizim” i tillë i hetimit, siç ndodhi me Komisionin tonë parlamentar, vjen më shumë nga mendësia dhe perceptimi dhe lidhet me fazën e tanishme të tranzicionit në shoqërinë tonë, se sa nga mundësia që një hetim parlamentar i jep një opozite për të kontrolluar maxhorancën.

Politizimi i punës hetimore të Komisionit u bë më flagrant në momentin e hartimit dhe të miratimit të raportit përfundimtar të hetimit. Neni 14 shkronja “d” i ligjit përcakton si detyrë të Komisionit *“të përgatisë dhe miratojë vendimin përfundimtar të hetimit, së bashku me mendimin e pakicës”*, ndërsa neni 21 kërkon që mendimet ndryshe të pakicës *“t’i bashkangjiten vendimit përfundimtar”*. Në kundërshtim flagrant me këto kërkesa ligjore, të pesë komisionerët socialistë në Komision rrëzuan në mënyrë të kundërligjshme me vendim shumice përfundimet e katër komisionerëve të opozitës dhe hartuan e miratuan, pa pjesëmarrjen e këtyre të fundit, një raport që injoronte të gjitha faktet dhe dëshmitë e mbledhura në ngarkim të ish-Drejtorit të SHISH-it nga opozita dhe e çuan atë në Kuvend si raport përfundimtar të hetimeve të Komisionit. Por, neni 20 i ligjit ngarkon Kryetarin e Komisionit të paraqesë raportin përfundimtar të hetimeve në Kuvend dhe Kryetari i Komisionit, përfaqësues i opozitës, refuzoi të paraqeste si raport përfundimtar një raport në të cilin mungonin, qoftë dhe si mendim pakice, përfundimet në të cilat kishin arritur komisionerët që kryen hetimin.

---

e Shërbimit ose të ish-Drejtorit. Ekspertët e marrë nga Komisioni dhe të parashikuar nga ligji nuk u lejuan të punonin në SHISH, megjithëse ishin ish-oficerë drejtues e me përvojë të shërbimit inteligjent dhe u pajisën sipas ligjit me certifikatën përkatëse nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Këshillit të Ministrave. Drejtori i komanduar ndërpreu dërgimin në Komision të dokumenteve, të kërkuara nga deputetët, që provonin akuzat e ngritura prej tyre.

Vullneti kundërvënës i maxhorancës ndaj hetimit të kërkuar nga opozita u rishfaq në përpjekjen finale për ta dështuar raportimin e përfundimeve në Kuvend. Pas negociatash intensive midis grupeve parlamentare të maxhorancës e opozitës, u arrit të pranohej që Kryetari i Komisionit të paraqiste në Kuvend të dy raportet, me përfundime diametralisht të kundërta, si mendime të shumicës dhe pakicës në Komision. Debati parlamentar që pasoi dëshmoi përsëri dy qëndrime diametralisht të kundërta të maxhorancës dhe opozitës, çka në vetvete nuk përbën një dalje nga norma e veprimtarisë parlamentare. Ajo që e theu përsëri ligjin ishte votimi nga Kuvendi vetëm i gjysmëraportit të hartuar nga komisionerët e maxhorancës dhe që injoronte faktet, dëshmitë dhe përfundimet e komisionerëve opozitarë që kryen hetimin, çka bëri që opozita të mos marrë pjesë në votim dhe të dalë nga salla. Në përfundim të veprimtarisë së këtij Komisioni, mund të thuhet se nisma e mbi ¼ së deputetëve, për të kryer një hetim dhe për ta çuar Kuvendin në miratimin e disa rekomandimeve të dala nga përfundimi i hetimeve, nuk i a arriti qëllimit, edhe pse mendimet e të dy palëve konvergonin përsa i përket rekomandimeve që duhej të miratonte Kuvendi.

Megjithëse, politizimi i veprimtarisë së Komisionit, për interesa vetjake nga të akuzuarit e drejtpërdrejtë ose për shkak të mendësive të vjetra të ruajtjes së pushtetit partiak në institucionet shtetërore nga disa përfaqësues të maxhorancës dëmtuan funksionimin normal të komisionit hetimor, mund të themi se krijimi dhe veprimtaria e tij janë një sukses për sa i përket përdorimit të tij si një instrument kontrolli parlamentar.

3. Vështirësitë e funksionimit të këtij Komisioni hetimor parlamentar u përforcuan edhe nga fakti se hetimi lidhej me veprimtarinë e Shërbimit Informativ, një fushë kjo delikate për një kontroll parlamentar edhe në vende me një demokraci të konsoliduar, siç janë vendet e Bashkimit Europian<sup>5</sup>.

---

<sup>5</sup> Përmirësimi i kontrollit parlamentar të shërbimeve inteligjente dhe reformimi i tyre, për t'iu përgjigjur kërkesave të një demokracie të sotme dhe harmonizimi i strukturave e veprimtarive të tyre në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar në vendet e BE-së,

Nga një vëzhgim i kontrollit parlamentar të shërbimit informativ të vendeve të BE-së del se janë dashur disa dekada që të krijohen hapësira për një kontroll të tillë, madje në disa prej tyre kjo ka ndodhur vetëm vitet e fundit si, për shembull, në Spanjë (1992), Austri (1993), Angli (1994), Belgjikë (1999) dhe në Francë ende nuk ka një instancë parlamentare të ngarkuar posaçërisht për kontrollin e shërbimeve informative, megjithëse në 2002-in edhe në këtë vend është krijuar një komision me dy deputetë, dy senatorë e dy anëtarë të Gjykatës së Llogarive për të kontrolluar përdorimin e fondeve speciale.

Mënyrat dhe gjerësia e kontrollit parlamentar të shërbimeve informative janë të ndryshme në vendet e ndryshme të BE-së. Megjithatë, mund të thuhet se përgjithësisht këto vende kanë një instancë të specializuar për të kryer këtë kontroll. Në Hollandë, për shembull, ky kontroll kryhet qysh prej vitit 1952 nga një *komision për shërbimet informative*, në të cilin bëjnë pjesë kryetarët e katër grupeve parlamentare kryesore. Në Angli, Kryeministri, pas këshillimit me udhëheqësit e opozitës, i cakton vetë nëntë parlamentarët e *Komitetit të Kontrollit*. Në Spanjë, *Komisioni i Posaçëm* i krijuar për këtë qëllim kryesohet nga Kryetari i Kongresit të Deputetëve dhe në të bëjnë pjesë nga një deputet për çdo grup parlamentar. Në Itali, ky *Komitet Parlamentar i Kontrollit (Copaco)* të shërbimeve informative përbëhet nga katër deputetë e katër senatorë, sipas rezultatit proporcional të grupeve politike. Në Gjermani, kontrolli parlamentar i shërbimeve informative kryhet nga një *delegacion* prej nëntë anëtarësh të Bundestagut, nga një për çdo grup politik, duke përfshiruar PDS (ish-komunistët). Në Austri, ky mision kryhet nga *nënkomisionet* përkatëse të komisioneve parlamentare të Brendshme e të Mbrojtjes të Dhomës së Ulët për shërbimet civile e

---

ka qenë objekt i Direktivës 707, qershor 2002 të Asamblesë Parlamentare të BE-it dhe e Seksionit të 48-të të Asamblesë së BE-it, të mbajtur më 2-4 dhjetor 2002 në Paris, në të cilin morën pjesë edhe deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, F. Beja e G. Bizhga (për më gjerë shih: Dokumenti C/1801 të paraqitur në këtë Seksion nga raportjuesja Kestelijn- Sierens).

ushtarake. Në Belgjikë, kryhet nga një *komision i përhershëm i Senatit* që mbikqyr komitetin e ekspertëve, të krijuar nga Senati për këtë qëllim.

Në të gjitha këto vende, përbërja dhe kompetencat e këtyre organeve të posaçme rregullohen me ligj, përveç Hollandës e cila e rregullon veprimtarinë e komisionit të saj me rregulloren e Dhomës së Ulët.

Nga ana tjetër, gjerësia e kontrollit nga deputetët e shërbimeve informative ndryshon duke kaluar nga njëri vend në tjetrin. Përgjithësisht, kontrollohet veprimtaria e përgjithshme e shërbimeve, zbatimi i ligjit prej tyre, përdorimi i fondeve të veçanta, respektimi i të drejtave themelore të njeriut, bashkërendimi dhe efienca e veprimtarisë së shërbimeve paralele etj. Në disa vende si Anglia dhe Italia e drejta e informimit për deputetët është më e vogël. Në Angli e në Hollandë ministri përkatës vendos për informacionet që u jepen deputetëve; në Itali, Kryeministri mund të refuzojë t'u përgjigjet kërkesave të Copaco-s; në Angli, Kryeministri mund ta censurojë raportin e bërë nga deputetët para se ai t'i paraqitet Parlamentit; në Belgjikë, raportin e hartuar e shikojnë vetëm parlamentarët që janë anëtarë të Komitetit përkatës të kontrollit; në Austri e në Gjermani, ministri mund të kundërshtojë kërkesën e deputetëve për të parë dokumente të caktuara. Ndërkaq, deputetët spanjollë kanë të drejtë akses në dokumentet më konfidenciale dhe kontrollojnë fondet speciale; në Belgjikë, punonjësit e shërbimit janë të zgjidhur nga sekreti profesional, kur u përgjigjen pyetjeve të Komitetit të Kontrollit; deputetët gjermanë mund të bëjnë kontrole në vend e për gjëra të veçanta.

Megjithatë, si rregull i përgjithshëm, deputetët janë të detyruar të ruajnë sekretet shtetërore dhe e drejta e tyre e informimit kufizohet gjithmonë nga nevoja e mbrojtjes së disa burimeve informative ose e zhvillimit të veprimtarive operacionale, çka nuk i pengon ata që të paraqesin raporte në parlament, t'i botojnë këto raporte ose t'ia nënshtrojnë ato debatit në seanca publike, siç ka ndodhur në Gjermani, Itali, Angli, Hollandë etj. Trendi i përgjithshëm është që kontrolli nga parlamentet të rritet e të zgjerohet nëpërmjet reformave e ligjeve që po miratohen e diskutohen në ditët e sotme.

Hetimet e kontrollet në shërbimet informative konsiderohen si të një fushe delikate dhe trajtohen me kujdes e seriozitet. Vëmendje i kushtohet trajtimit jopartiak të tyre. Kujtojmë se Kryeministri britanik konsultohet me liderin e opozitës para caktimit të deputetëve që do të bëjnë pjesë në komitetin e kontrollit (ISC) dhe deri në korrik 2001, kryetar i ISC ka qenë ish-Ministri konservator Tom King, pra i opozitës . Në Itali, tradicionalisht, Kryetari i Komitetit Parlamentar të Kontrollit i përket opozitës (aktualisht Copaco-ja drejtohet nga ish-ministri i brendshëm i qeverisë së qendrës së majtë, ndërsa gjatë legjislaturës së mëparshme, kryetar i tij ishte një nga ministrat e qeverisë aktuale). Pra, megjithëse shërbimet informative varen drejtpërdrejt nga ekzekutivi, ato trajtohen si një instrument shtetëror dhe jo thjesht qeveritar. Përvojë kjo që duhet të merret në konsideratë nga politikanët shqiptarë, për t'i dhënë këtij shërbimi edhe në Shqipëri një karakter institucional shtetëror në të mirë të interesave të vërteta të sigurisë kombëtare.

Veprimtaria e Komisionit Hetimor për Shërbimin Informativ që ndërmori Kuvendi i Shqipërisë ngjalli një interes të pazakontë te publiku dhe rriti transparencën e funksionimit të këtij shërbimi, që në vendin tonë për dekada të tëra ka qenë mbuluar nga misteri. Nga ana tjetër, kjo veprimtari do të ndikojë në përmirësimin e ligjit të këtij shërbimi dhe në zbatimin më rigoroz të tij në të ardhmen, qoftë nga Drejtori, qoftë nga punonjësit e tjerë të Shërbimit, duke hedhur një hap të mëtejshëm në demokratizimin e shoqërisë shqiptare.

# **Nga punimet e Kuvendit për periudhën tetor - nëntor 2002**

*Përgatiti Ariana Mero*

## **I. Raport i Komisionit të posaçëm për Integrimin Europian dhe Paktin e Stabilitetit mbi procesin e Stabilizim - Asociimit. (Raport i mbajtur në seancën plenare të Kuvendit, tetor 2002).**

Kryetari i Komisionit të posaçëm të Integritimit Europian dhe Paktit të Stabilitetit, Fatmir Mehdiu, raporton para Kuvendit mbi veprimtarinë e këtij Komisioni, drejtimi i punës së të cilit është njohja me procesin dhe ecurinë e kontrollit parlamentar mbi Qeverinë, për zbatimin e detyrimeve të vendosura nga Bashkimi Europian, për nxitjen e procesit të integritimit të Shqipërisë në BE, dhe zbatimi i paktit të stabilitetit, si instrument që afron vendin me Europën. Pas një përmbledhjeje të ecurisë së marrëdhënieve Shqipëri - Bashkimi Europian, për arritjen e objektivit për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit, duke vlerësuar maturinë që po tregon klasa politike shqiptare, e shprehur veçanërisht në arritjen e konsensusit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, konkludohet se, para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dalin dy detyrime të mëdha, ecuria e të cilave ndiqet me vëmendje nga BE-ja:

1. Puna e Komisionit Bipartizan për zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR - it, në lidhje me zgjedhjet e vitit 2001.
2. Përgatitja e një ligji për pronën, në përputhje me standardet ndërkombëtare, Konventën “Për të Drejtat e Njeriut” dhe Kushtetutën Shqiptare.

Në vazhdim theksohet se ecuria e mëtejshme e integritimit, pas nënshkrimit

të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit, do të varet nga ecuria e reformave në vend dhe nga shkalla në të cilën Shqipëria do të jetë në gjendje të zbatojë angazhimet e saj, që rrjedhin nga nënshkrimi i Marrëveshjes.

Raporti mbyllet me propozimet e Komisionit për:

1. organizimin e një tryeze të drejtuar nga Presidenti i Republikës, me pjesëmarrjen e Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, Ministrit të Jashtëm, Ministrit të Integritimit, kryetarëve të Komisionit të Jashtëm dhe atij të Integritimit të Kuvendit, si dhe të kryetarëve të partive parlamentare, që do të mbledhet në mënyrë periodike;

2. organizimin e një Konference kombëtare për Integrimin Ekonomik në BE;

3. ngritjen pranë Kuvendit të një stafi për ndjekjen progresive të detyrimeve të Kuvendit në këtë proces, si dhe për rritjen e rolit të kontrollit parlamentar mbi qeverisjen.

## **II. Raport për marrëdhëniet dypalëshe shqiptaro - maqedonase**

Më 29 tetor Komisioni i përhershëm i Politikës së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Kuvendit mori në shqyrtim gjendjen dhe ecurinë e marrëdhënieve shqiptaro-maqedonase. Në përfundim, Komisioni vlerëson se në fushën e marrëdhënieve dypalëshe, Shqipëria është shprehur gjithmonë për ruajtjen dhe respektimin e sovranitetit dhe integritetit të Shtetit Maqedon. Angazhimi i vazhdueshëm i politikës shqiptare ka qenë ndjekja e politikës së fqinjësisë së mirë. Në lidhje me marrëdhëniet ndërparlamentare, Komisioni i vlerëson ato si pozitive, me shkëmbime të herëpashershme. Në vazhdim vlerësohet marrëveshja e Ohrit, duke e konsideruar atë si një pikë kthese në zhvillimin e situatës në Maqedoni, krijimin e një klime të re mirëkuptimi, paqeje dhe stabiliteti jo vetëm për Shtetin Maqedon, por edhe më gjerë. Duke përshëndetur qëndrimin e ri të forcave politike në Maqedoni, Komisioni vlerëson edhe qëndrimin e partive politike shqiptare, për garantimin e zbatimit të plotë të kësaj marrëveshjeje.

Komisioni, ndërmjet të tjerash, i rekomandon Ministrisë së Jashtme dhe agjencive të tjera të përfshira në procesin e marrëdhënieve shqiptaro – maqedonase, sa më poshtë:

- të punohet për krijimin e një dinamike të re në marrëdhëniet dypalëshe dhe në rritjen e bashkëpunimit rajonal;
- të vazhdojë bashkëpunimi në kuadrin e projekteve të Paktit të Stabilitetit;
- të ndiqet me përparësi situata lidhur me ecurinë për punimet e korridorit të 8-të;
- të ndiqet procesi i regjistrimit të popullsisë në Maqedoni, në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtare;
- të forcohet bashkëpunimi rajonal në luftën kundër krimit dhe dukurive të paligjshme në zonat kufitare.

### **III. P/ligji “Për buxhetin faktik të vitit 2001” dhe Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit**

Në muajin tetor, Komisioni i përhershëm i Ekonomisë dhe Financave diskutoi p/ligjin “Për buxhetin faktik të vitit 2001” dhe Raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilët më pas kalojnë në seancë plenare, ku dhe miratohen. Nga shqyrtimi i dy raporteve për zbatimin e buxhetit të shtetit rezulton se ka një përputhje të shifrave të paraqitura nga Këshilli i Ministrave për buxhetin faktik të vitit 2001, me shifrat e paraqitura nga raporti i KLSH-së. Komisioni, duke konstatuar se oponenca e përgatitur nga KLSH -ja nxjerr në pah një sërë problemesh të rëndësishme, jep rekomandime, në lidhje me të cilat kërkohet që Këshilli i Ministrave të mbajë një qëndrim dhe veprim institucional. Nga kjo analizë qeveria duhet të dalë me propozime konkrete për marrjen e masave për uljen e evazionit fiskal, kufizimin e korrupsionit dhe kontrabandës etj.

Duke qenë në tërësi dakort me të dy raportet, komisioni kërkon të tërheqë vëmendjen e qeverisë për disa çështje të përsëritura, të cilat janë përmendur edhe në raportin e KLSH-së, ndërmjet të cilave:

- shumat debitore ndaj organeve tatimore e doganore vazhdojnë të rriten;



- evazoni fiskal vazhdon të jetë ende i lartë - nuk është evidentuar asnjë rast që, për mosshlyerjen e detyrimeve tatimore për subjektet që procedohen në gjykatë, të jenë zbatuar procedurat e falimentimit;

- mangësitë e konstatuara në përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave, konkluzion edhe i KLSH -së;

- buxheti i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ende nuk ka arritur të përballojë shpenzimet me të ardhurat që realizon;

- borxhi i jashtëm ka vazhduar të rritet, si për shkak të kredive të marra për infrastrukturën, ashtu edhe për kreditë e marra për kompanitë publike;

- është rritur stoku i borxhit të brendshëm;

- janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në kryerjen e shpenzimeve në shumë institucione buxhetore.

Ndërkaq, mendimi i opozitës për raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit është se, pavarësisht nga disa përmirësime që ka pasur në krahasim me raportin e një viti më parë, ky është një raport i përgjithshëm, i cili nuk identifikon rastet konkrete dhe mbetet në nivelin e nëpunësve të rangut të ulët dhe të mesëm, përse i përket përgjegjësive. Përveç kësaj, në raport duhet të përfshiheshin edhe ato raste të cilat kanë qenë identifikuar në raportin e mëparshëm dhe ndaj të cilave nuk janë marrë as masa penale dhe as masa administrative.

Në seancën plenare të datës 31 tetor foli dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili paraqiti punën që ka bërë ky institucion gjatë këtij viti. Duke analizuar treguesit e përgjithshëm të buxhetit të shtetit për vitin 2001, me shifra dhe fakte, theksoi se shkeljet më të mëdha janë konstatuar në abuzimin e fondeve publike në administratën shtetërore, në fushën e doganave dhe tatimeve, në evazionin fiskal etj. Ai paraqiti edhe masat që ka marrë ky kontroll për punonjës të ndryshëm të sektorëve civilë dhe publikë.

**IV. Raport i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës para Kuvendit, në seancë plenare**

Në seancën plenare të datës 28 tetor 2002, raportoi Prokurori i Përgjithshëm, Dhori Sollaku, në bazë të ligjit për informimin periodik të Kuvendit. Në raport u paraqit puna rezultative e Prokurorisë në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve të qënieve njerëzore, pastrimit të parave, terrorizmit etj. Në vazhdim, Prokurori parashtroi nevojën për ndryshime në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin “Për policinë gjyqësore”, për përmirësimin e punës së Prokurorisë dhe përsosjen e ligjeve që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit, ato që lidhen me administrimin e pasurisë publike etj.

#### **V. Mocion për shkarkimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë**

Në seancën plenare të datës 6 nëntor 2002 u diskutua mocioni i mosbesimit i paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, nëpërmjet të cilit kërkohet miratimi i një rezolute, ku i propozohet Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë shkarkimi e Guvernatorit Shkëlqim Cani, i cili, ndërmjet të tjerave, akuzohet për përgjegjësi ligjore në vjedhjen e shumës 600 000\$, e cila vlerësohet si “evidente dhe e patolerueshme”. Mocioni nuk miratohet në seancë plenare me shumicë votash, me argumentin se, sipas ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, shkarkimi i Guvernatorit është tej kompetencave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

#### **VI. Deklaratë e Komisionit të Politikës së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare mbi projekt-preambulën e Kartës Kushtetuese të Bashkimit të ri Serbi - Mali i Zi.**

*(Deklaratë e mbajtur në seancën plenare të Kuvendit, nëntor 2002)*

Në deklaratën e mbajtur nga kryetari i Komisionit, Ilir Zela, në seancë plenare, ngrihet shqetësimi për projektin e preambulës së Kartës Kushtetuese të bashkimit Serbi -Mali i Zi, hartuar nga një komision i përbashkët serbo-malazez, ku Kosova përcaktohet si pjesë e Serbisë. Komisioni deklaroi se ky përcaktim është në kundërshtim të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit

të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e cila parasheh një proces për përcaktimin e statutit të Kosovës, duke u bazuar në vullnetin e shprehur të popullit të Kosovës, në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar. Gjithashtu, theksohet se nga faktori ndërkombëtar ende nuk është përcaktuar koha e diskutimit të këtij problemi. Një përcaktim i tillë vlerësohet si provokues. Ndaj, me anë të kësaj deklarata, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë fton Parlamentin e Serbisë dhe Malit të Zi të jetë më realist në lidhje me këtë problem, për të mos rënë ndesh me vullnetin e popullit të Kosovës dhe qëndrimin e komunitetit ndërkombëtar. Komisioni beson në një ndërhyrje energjike të komunitetit ndërkombëtar për të shmangur zhvillimet provokuese, që rrezikojnë proceset e ndërtimit të institucioneve demokratike në Kosovë dhe janë me pasoja negative ndaj proceseve demokratizuese dhe të sigurisë në të gjithë rajonin e Europës Juglindore.

## **VII. Komisioni për hetimin e veprimtarisë së SHISH-it dhe drejtorit të tij, Fatos Klosi**

Komisioni për hetimin e veprimtarisë së Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror, Fatos Klosi, i ngritur me vendim të Kuvendit, raportoi në seancën plenare të Kuvendit, më 14 nëntor 2002, ku u paraqit me dy raporte, sipas përfaqësimit pozitiv - opozitë.

Në raportin e tyre, përfaqësuesit e Partisë Socialiste konstatojnë shkelje në veprimtarinë ekonomike - financiare të SHISH-it.

Në raportin e përfaqësuesve të Partisë Demokratike konstatohet se:

- Drejtori, Fatos Klosi, ka nxjerrë shërbimin jashtë objektit të vet, ka abuzuar me pushtetin dhe me tagrin ligjor që i është dhënë me ligj nga Kushtetuta.

- Ka shkelje të rënda në veprimtarinë ekonomike dhe veprime të dyshimta financiare në këtë institucion.

- Shërbimi informativ ka përdorur median për interesa të ngushta.

Pas diskutimeve në seancë plenare, votohet dhe miratohet me shumicë votash raporti i hartuar nga përfaqësuesit e PS-së mbi veprimtarinë e Drejtorit të Shërbimit Informativ Kombëtar.

### **VIII. P/ligji “Për disa masa në fushën e transmetimeve radiotelevizive”**

Propozimi i një grupi deputetësh të Komisionit për Mjetet e Informimit Publik të p/ligjit “Për disa masa në fushën e transmetimeve radiotelevizive” mori shkas nga nevoja për rregullimin e veprimtarisë radio-televizive në Republikën e Shqipërisë. Mungesa e një plani të frekuencave për transmetime radio-televizive, gjë e cila pengon edhe hartimin e një strategjie për zhvillimin e mediave elektronike në Shqipëri, ka shkaktuar një gjendje të vështirë në fushën e transmetimeve radiotelevizive. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në bashkëpunim me OSBE - në, projektin Danida dhe IREX, si donatorë dhe rekomandues, miratoi një memorandum mirëkuptimi, duke kërkuar mbështetjen ligjore të Komisionit parlamentar. Ligji në fjalë kërkon ngrirjen e përkohshme të dhënies së licencave për operatorët radiotelevizivë, deri në realizimin e hartës së frekuencave për transmetimet radio-televizive, që do të përfundojë 5 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar për këtë qëllim ndërmjet KKRT, OSBE/Shqipëri, Danida/Shqipëri dhe IREX/Shqipëri. P/ligji u miratua në seancë plenare të Kuvendit, në muajin nëntor 2002.

### **IX. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8449, dt. 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”**

Gjatë diskutimit në seancë plenare të muajit nëntor, u shprehën mendime të kundërta nga përfaqësuesit e pozitë - opozitës, të cilat çuan në shtyrjen e miratimit të këtij projektligji.

Mendimi i pozitës është që të mbyllet dyqanet e ngritura në zonat kufitare, me përjashtim të zonës doganore të aeroporteve, të quajtura ndryshe *duty free shops*, sepse ekzistenca e tyre krijon mundësinë e abuzimit. Kjo ndodh

pasi në këto dyqane shiten mallra pa paguar akcizë dhe taksa doganore, të cilat kanë tjetër destinacion. Po kështu, konstatohet pamundësia për mirëadministrim i veprimtarisë së *duty free shop* - eve.

Opozita shprehet kundër mbylljes së *duty free shop*-eve me argumentin se ato ekzistojnë në të tëra vendet dhe mbyllja e tyre do të pengonte zbatimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me Maqedoninë apo me shtete të tjera. Kërkesa për mbylljen e tyre vjen nga pamundësia e strukturave shtetërore për miradministrim, ndaj zgjidhja më e mirë shikohet pikërisht në përmirësimin e administrimit të tyre.

### **X.P/ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”**

Gjatë shqyrtimit të p/ligjit në seancën plenare të muajit nëntor, një nga problemet më të debatuar ishte pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, mënyra e emërimit dhe e largimit të tij nga detyra. Lidhur me këtë pozicion u shprehën dy mendime: njëri që e konsideron atë si nëpunës politik dhe tjetri si nëpunës në të lartë civil. U shprehën mendime se p/ligji nuk rregullon në tërësi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave. Ai nuk merret me strukturën e Këshillit të Ministrave, të institucioneve qendrore e të funksioneve që kryejnë ato, duke lënë të hapur shtegun për ndryshime të shpeshta, të paargumentuara dhe subjektive. Në veçanti, përfaqësuesit e opozitës kërkuan përcaktimin e saktë të numrit të ministrive.

Pas debateve të shumta dhe për mungesë kuorumi, projektligji nuk miratohet në seancë plenare.

### **XI.Komisioni i posaçëm parlamentar “Për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001”**

*(Raport i mbajtur në seancë plenare të Kuvendit, nëntor 2002)*

Komisioni “Për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001”, pas vendimeve nr.50, dt 29.7.2002 dhe nr. 56, dt. 5.9.2002, të cilat zgjatën afatin e punës së tij, duke ndryshuar disa anëtarë dhe bashkëkryetarin, përfaqësues të Partisë Socialiste, vazhdoi veprimtarinë e tij, duke u mbështetur në asistencën e përfaqësuesit të OSBE-së në Shqipëri, si dhe në atë të ekspertëve të ODIHR-it. Me vendim të Komisionit është ngritur një nënkomision për hetimin e plotë të problemeve që dolën në zonën 60 dhe të fenomeneve të tjera të konstatuara në raportin e OSBE/ODIHR-it. Çështjet që janë diskutuar në këtë periudhë, ndër të tjera, janë: përmirësimi i sistemit zgjedhor; rishqyrtimi i ligjit “Për ndarjen e zonave zgjedhore”; roli i forcave të rendit dhe i medias në procesin zgjedhor; regjistrimi i subjekteve politike, ai i kandidatëve dhe afatet përkatëse; listat shumëmbrore që depozitohen në KQZ; votimi i emigrantëve, i personave me aftësi të kufizuara; financimi i fushatës zgjedhore etj. Është zhvilluar një takim me KQZ-në, ku janë analizuar roli dhe veprimtaria e këtij institucioni gjatë zgjedhjeve, në frymën e vërejtjeve të konstatuara në raportin e OSBE/ODIHR-it. Po kështu, është analizuar veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese, mbështetur në raportin e sipërcituar, në lidhje me shkeljet e vërtetuara në vendimmarrje. Pas diskutimeve të disa varianteve për amendime në Kodin Zgjedhor, në lidhje me rolin e mediave, ka përfunduar drafti i plotë dhe është në proces drafti i rolit të forcave të rendit gjatë fushatës elektorale dhe procesit zgjedhor. Në bashkëpunim me përfaqësues të OSBE-së dhe ODIHR-it, Komisioni ka hartuar tematikën e 4 seminareve lidhur me problemet e dala nga raporti i OSBE/ ODIHR-it, të zhvilluara gjatë muajve nëntor - dhjetor 2002. Deri më tani janë organizuar 3 tryeza.

## **XII.Komisioni i posaçëm për Kthimin e Pronave**

Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të një grupi deputetësh, me vendim nr.25 të Kuvendit, datë 15.4.2002, vendosi krijimin e një komisioni të posaçëm, me pjesëmarrës nga përfaqësues të pozitës dhe opozitës, për shqyrtimin e

projektligjeve të paraqitura në Kuvend nga Qeveria dhe grupe deputetësh, për problemin e kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve. Në programin e punës së këtij komisioni përfshihet dhe një numër seancash dëgjimi me subjektet e interesuara për problemin. Gjatë punës së tij Komisioni është asistuar nga përfaqësues të OSBE -së.

Më 13 nëntor 2002, përfaqësuesit e partive Republikane, të Legalitetit dhe të Ballit Kombëtar deklarojnë largimin e tyre nga ky Komision, deri në realizimin e kërkesave të tyre të mëposhtme:

1. Të shfuqizohet ligji nr.7501 “Për tokën”. Prona t’u kthehet pa kufizim pronarëve të ligjshëm, me përjashtim të shpronësimeve për nevoja publike.

2. Përpara miratimit të ligjeve, Qeveria të përcaktojë burimet për kompensimin në natyrë dhe vlerë të pronave të zëna për nevoja publike dhe ndërtime të ligjshme për nevoja strehimi.

3. Njohja e së drejtës së pronësisë pronarëve të bëhet nga viti 1944 deri në hyrjen në fuqi të ligjit.

4. Të anulohen të gjitha kontratat e dhënies me qira nga shteti të trojeve, të tokës bujqësore dhe pyjore, livadheve dhe kullotave, pronë shtetërore dhe private.

5. Të anulohen vendimet abuzive që i kanë dhënë të drejtën e pronësisë pushtetarëve dhe personave të lidhur me ta.

Përfaqësuesit e PD-së në Komision janë kundër shfuqizimit të ligjit nr. 7501 “Për tokën”. Për zgjidhjen e këtij problemi ato japin këto zgjidhje:

- kompensim fizik të pronarëve;
- kompensim në para;
- kompensim nëpërmjet privatizimit të objekteve shtetërore.

Përfaqësuesit e PS - në Komision janë kundër shfuqizimit të ligjit nr. 7501 dhe pro projektligjit të paraqitur nga Qeveria “Për disa ndryshime në ligjin nr.7698, dt.15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, ndryshuar me ligjet nr.7756, dt.2.11.1993, nr. 7808, dt. 30.3.1994, nr. 7879, dt. 1.12. 1994, nr.7916, dt 12.4.1995, nr.8024, dt. 2.11.1995 dhe

nr.8084, dt 3.7.1996", me ndryshimet përkatëse. Përfaqësuesit e PS-së e shohin zgjidhjen e këtij problemi nëpërmjet kompensimit fizik të ish-pronarëve, duke vlerësuar se mundësitë e kompensimit në vlera monetare janë të vogla.

Pranë Komisionit të posaçëm për Kthimin e Pronave është ngritur një grup ekspertësh, i cili po harton një projektligj të ri për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve të ligjshëm. Kërkohet shtyrja e mandatit të Komisionit, i cili mbaroi më datë 30 nëntor 2002.



## Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

*Filip Lako*  
*Jurist*

**Ligji nr. 8828, datë 5.11.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë së zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për zhvillim (IDA) për projektin e shërbimeve bujqësore”.** Kjo Marrëveshje është lidhur më 3 korrik 2001. Në nenin 1 të saj, përveç kushteve të përgjithshme të zbatueshme për marrëveshjet e kredive, jepen edhe përkufizime për temat që do të përdoren në përmbajtjen e saj. Në nenin 2 flitet për kredinë, e cila është në masën 7.850.000 USD. Data e përfundimit të Marrëveshjes do të jetë 31 dhjetori i vitit 2007. Në nenin 3 përshkruhet ekzekutimi i projektit. Për paktin financiar (neni 4), huamarrësi do të mirëmbajë një sistem menaxhimi financiar, për të reflektuar veprimet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me projektin. Pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje janë edhe disa krerë dhe anekse. Në kreun I bëhet fjalë për tërheqjen e fondeve të kredisë, kurse në aneksin “A” të po këtij kreu tregohet se si do të veprohet kur tërheqjet nuk janë bërë në bazë të Raporteve të Menaxhimit Financiar. Në kreun II bëhet përshkrimi i projektit. Sipas kësaj, objektivi i projektit është rritja e të ardhurave rurale në territorin e huamarrësit nëpërmjet përmirësimit të hyrjes së fermerëve të vegjël me fara cilësore, ndihma për një funksionim të mirë të tregut të tokës, të përmirësimit të pjesëmarrjes së fermerëve të vegjël me veprimtaritë e tregut, të përmirësimit të teknologjisë, të marketingut, rendimentit etj. Në krerët e tjerë flitet për prokurimin dhe shërbimet e konsulencës, programin

e zbatimit etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 12.12.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 54 të vitit 2001, faqe 1698. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja e Kredisë së Zhvillimit, e cila ndodhet në Fletoren Zyrtare 54/1.

**Ligji nr. 8829, datë 5.11.2001 “Për ratifikimin e “Konventës nr. 183 “Mbrojtja e amësisë, 2000” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Konventa “Mbrojtja e Amësisë 1952” është miratuar në vitin 1952.** Meqenëse Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës ka vërejtur nevojën për ndryshime në këtë Konventë, është mbledhur më 30 maj 2000 në Gjenevë. Këto ndryshime janë bërë me qëllim që të nxisë më shumë barazinë e të gjitha grave në fuqinë punëtore dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin e nënës dhe të fëmijës, si dhe për të siguruar mbrojtje për shtatzaninë. Konventa bën fjalë, gjithashtu, për lejën e barrë lindjes, për lejën në rastet e sëmundjes ose komplikimeve, për mbrojtjen e punësimit dhe mosdiskriminimin, për dhënien e lejës së pushimit gjatë kohës ditore të ushqimit me gji etj. Të gjitha këto probleme janë shqyrtuar nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe janë miratuar më 15.6.2000. Pra, “Konventa Mbrojtja e Amësisë 2000” ndryshon “Konventën Mbrojtja e Amësisë 1952”. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 12.12.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 54 të vitit 2001, në faqen 1698. Ligjit i bashkëlidhet edhe “Konventa nr.1883 “Mbrojtja e Amësisë 2000”.

**Ligji nr.8830, datë 5.11.2001 “Për një shtesë në Ligjin Minerar të Shqipërisë nr.7796, datë 17.2.1994”.** Ligji nr.7796, datë 17.2.1994 është ligji minerar i Shqipërisë. Në Kreun VIII të tij, në pikën “B” flitet për lejet e shfrytëzimit. Neni 69 autorizon të jepen dy tipe lejesh shfrytëzimi karrierash. Tipi i parë i lejës së karrierës është një leje për shfrytëzimin e mineraleve dhe materialeve të ndërtimit nga një karrierë publike, kundrejt pagesës me afat fillestar maksimal njëvjeçar. Tipi i dytë i lejes së karrierës është një leje ekskluzive, për të hapur dhe shfrytëzuar një karrierë për mineralet

ose materialet e ndërtimit me pagesë. Afati fillestar maksimal i tipit të dytë të lejes së karrierës është dhjetë vjet. Me ligjin nr.8830, datë 5.11.2001, në nenin 69 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 shtohet një paragraf në të cilin thuhet se në raste të veçanta, kur afati i dhënies së lejes minerare të shfrytëzimit kërkohet deri në 99 vjet, ministria përkatëse negocion marrëveshjen me lejekërkuesin, miratimin e të cilës e bën Këshilli i Ministrave. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pasi të miratohet edhe nga Kuvendi. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 12.12.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.54 të vitit 2001, në faqen 1704.

**Ligji nr.8831, datë 22.11.2001 “Për pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror”.** Sipas ligjit të lartpërmendur, Ministria e Financave, e përfaqësuar nga Ministri, vepron në emër të shtetit dhe është pronare e bankave tregtare dhe e shoqërive shtetërore të sigurimit të dëmeve dhe të jetës, të cilat janë me kapital tërësisht shtetëror. Me dekretin nr.1430, datë 27.3.1996 (neni 1) është bërë një shtesë në ligjin nr.8033, datë 16.11.1995 “Për transformimin e Bankave Tregtare Shtetërore në Shoqëri Tregtare dhe lejimin e privatizimit tyre”. Kështu, është shtuar neni 6/1 (në ligjin nr.8093, datë 16.11.1995 me këtë përmbajtje: “Ministria e Financave ushtron të drejtën e pronarit të Bankave Tregtare Shtetërore përsa i përket transformimit në shoqëri tregtare dhe privatizimit të tyre.” Me ligjin e lartpërmendur (nr.8831, datë 22.11.2001) neni 1 i dekretit nr.1430, datë 27.3.1996 shfuqizohet dhe zëvendësohet me përmbajtjen që është cituar më lart, në paragrafin e parë. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.1.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 56 të vitit 2001, faqe 1761.

**Ligji nr.8832, datë 22.11.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për parandalimin dhe dënimin e krimeve kundër personave të mbrojtur në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë**

**agjentët diplomatikë”**”. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e bindur për rëndësinë e përfundimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare mbi masat e duhura dhe efektive për parandalimin dhe dënimin e krimeve kundër agjentëve diplomatikë dhe personave të tjerë të mbrojtur në nivel ndërkombëtar dhe duke pasur parasysh kërcënimin serioz, të krijuar nga kryerja e krimeve të tilla, ka miratuar Konventën e lartpërmendur. Në Konventë ritheksohet rëndësia e madhe e rregullave të së drejtës ndërkombëtare, lidhur me paprekshmërinë dhe mbrojtjen që duhet t’u sigurohet personave të mbrojtur në nivelin ndërkombëtar dhe detyrimet e shteteve në lidhje me to. Aneksi i Konventës përcakton në mënyrë taksative se kush konsiderohet “person i mbrojtur në nivel ndërkombëtar”, gjithashtu, ndërmjet të tjerash, vihen detyrime për shtetet palë, ku i pandehuri ndiqet penalisht, për t’i komunikuar rezultatin përfundimtar të gjykimit Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili duhet t’ua transmetojë këtë informacion shteteve të tjera palë. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.1.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 56 të vitit 2001, faqe 1762. Ligjit i bashkëlidhet Konventa dhe Aneksi.

**Ligji nr.8833, datë 22.11.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit të OPEC-ut për zhvillimin ndërkombëtar”**”. Vendet anëtare të OPEC-ut kanë krijuar Fondin e OPEC-ut për të siguruar mbështetje ekonomike për vendet në zhvillim. Ato stimulojnë dhe ndihmojnë lëvizjen e kapitalit dhe financimin e veprimtarive në sektorin privat. Nisur nga kjo, edhe vendi ynë e ratifikoi këtë Marrëveshje. Marrëveshja jep përkufizimet e termave që përdoren në përmbajtjen e saj, jep parimet e përgjithshme në lidhje me krijimin, blerjen, zgjerimin, menaxhimin, drejtimin, operimin dhe shitjen e investimeve. Po ashtu, rregullon problemet e investimeve, duke lajmëruar paraprakisht vendin pritës, investim i cili nuk mund të bëhet në rast se vendi pritës e kundërshton këtë financim. Pas

bërjes së investimit, vendi pritës nuk mundet të shpronësojë investimin, përveç se për interes publik dhe kundrejt shpërblimit e kompensimit. Marrëveshja trajton problemin e pagesave dhe të transferimit të tyre, të taksave, interesave etj., si dhe të konsultimit paraprak në rast të ndonjë konflikti. Nëse këto nuk zgjidhen me konsultime, secila palë ka të drejtë ta dërgojë kërkesën në një gjykatë arbitrazhi, në përputhje me rregullat e së drejtës ndërkombëtare. Të gjitha dokumentet e Marrëveshjes, vlefshmëria, aplikimi dhe investimi i tyre, do të rregullohen nga parimet e së drejtës ndërkombëtare. Kjo Marrëveshje, e nënshkruar më 20.2.2001, do të mbetet në fuqi për një periudhë prej dhjetë vjetësh. Secila palë ka të drejtë të kërkojë mbarimin e Marrëveshjes para këtij afati, por duhet që lajmërimin t'ia bëjë palës tjetër një vit përpara. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.1.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56 të vitit 2001, në faqen 1768. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

**Ligji nr. 8834, datë 22.11.2002 “Për ratifikimin e “Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Europë” (Lisbonë, 1997)”.** Konventa e lartpërmendur është miratuar në Lisbonë, më datën 11 prill 1997. Ajo është përpunuar dhe adoptuar nën patronazhin e përbashkët të Këshillit të Europës dhe të UNESCO-s, duke krijuar një kuadër për zhvillimin e ardhshëm të praktikave të njohjes në Rajonin European. Në hyrje të saj ajo jep shpjegime se kush janë shtytat që nxitën Këshillin e Europës dhe UNESCO-n për të përpunuar një Konventë të tillë, dhe më poshtë jep kuptimin e termave, duke sqaruar me hollësi çdonjërin prej tyre. Në seksionin e dytë flitet për kompetencat e autoriteteve, kurse në seksionin e tretë jepen parimet bazë për vlerësimin e kualifikimeve, duke vënë theksin që çdo palë të kujdeset që procedurat dhe kriteret e përdorura për vlerësimin dhe njohjen të jenë transparente, koherente dhe të besueshme. Në seksionet 4 dhe 5 flitet për detyrimet e palëve për njohjen e kualifikimeve që lejojnë hyrjen në arsimin e lartë dhe për njohjen e periudhave të studimit. Në një seksion të veçantë gjen rregullim njohja e kualifikimeve të refugjatëve, e personave të zhvendosur dhe e personave të krahasuar me refugjatët. Konventa ka edhe

disa seksione të tjera, ndër të cilat edhe ajo që flet për mekanizmat e zbatimit, dhe organe të tilla janë Komiteti i Konventës dhe Rrjeti European i Qendrave Kombëtare të Informacionit. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.1.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56 të vitit 2001, në faqen 1773. Ligjit i bashkëlidhet Konventa.

**Ligji nr. 8835, datë 22.11.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin për shtypjen e veprimeve të paligjshme në aeroportet që i shërbejnë aviacionit civil ndërkombëtar”, shtesë e “Konventës për shtypjen e veprimeve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil”.** Ky Protokoll plotëson Konventën për shtypjen e veprimeve të paligjshme për sigurinë e aviacionit civil, të hartuar në Montreal më 23 shtator 1971. Protokollin dhe Konventa duhet të lexohen së bashku si një instrument i vetëm, sepse Protokollin është inkluduar në Konventë. Miratimi i Konventës dhe më pas i Protokollit është diktuar nga veprimet e paligjshme të dhunës, të cilat rrezikojnë ose mund të rrezikojnë sigurinë e njerëzve në aeroportet që i shërbejnë aviacionit civil ndërkombëtar ose të cilat vënë në rrezik funksionimin e sigurt të aeroporteve të tilla, dobësojnë besimin e popujve të botës në sigurinë e aeroporteve të tilla. Veprime të tilla janë një shqetësim i madh për bashkësinë ndërkombëtare dhe, me qëllim që të pengohen veprime të tilla, ekziston nevoja për marrjen e masave të duhura për ndëshkimin e shkelësve të ligjit. Në Konventë, në Protokoll dhe në një Aneks (Shtojcë) që flet për ndalimin e bombardimeve terroriste, u jepet përgjigje dhe zgjidhje problemeve të parashtruara më lart. Ligji për aderimin në këtë Protokoll ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.1.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56 të vitit 2001, në faqen 1785. Ligjit i bashkëlidhet edhe Protokollin.

**Ligji nr.8836, datë 22.11.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për ndalimin e bombardimeve terroriste”.** Republika e Shqipërisë, duke patur parasysh qëllimet dhe parimet e Kartës

së Kombeve të Bashkuara, lidhur me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe nxitjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe ato të miqësisë, si dhe bashkëpunimin midis shteteve, ka aderuar në këtë Konventë. Kjo Konventë (Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Bombardimeve Terroriste) i është aneksuar Rezolutës së tanishme të datës 4 dhjetor 1994, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, mbi masat për të eliminuar terrorizmin ndërkombëtar. Konventa, ku vendi ynë ka aderuar me ligjin e lartëpërmendur, është miratuar nga Mbledhja Plenare e Asamblesë së Përgjithshme më 15 dhjetor 1997. Neni kryesor i Aneksit (Shtojcë) të Konventës, i cili haset në të gjithë përmbajtjen e saj, është neni 2. Ky nen flet për vendosjen ose plasjen e eksplozivit apo pajisjeve (mjeteve) të tjera në mjedise publike, me qëllim që të shkaktohen vdekje ose dëmtime të rënda trupore ose të shkaktohen dëmtime me humbje të mëdha ekonomike. Konventa parashikon detyrime për shtetet palë lidhur me dhënien e ndihmës për kapjen, hetimin, procedimin dhe ekstradimin e keqbërësve, si dhe për bashkëpunimin për të parandaluar këto veprime keqbërëse. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 6.12.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.57 të vitit 2001, faqe 1801. Ligjit i bashkëlidhet edhe Konventa.

**Ligji nr 8837, datë 22.11.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën Ndërkombëtare Kundër Marrjes së Pengjeve”.** Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 17 dhjetor 1979 miratoi “Konventën Ndërkombëtare Kundër Marrjes së Pengjeve”, e cila iu aneksua Rezolutës ekzistuese nr. 31/103, datë 15 dhjetor 1976. Konventa është hartuar duke pasur parasysh qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, lidhur me ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare dhe nxitjen e marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimin midis shteteve. Konventa u vë detyra shteteve palë që të këmbëjnë informacion, kur ka raste të kërcënimeve për vrasje e për marrje peng. Gjithashtu, shtetet palë, në territorin e të cilit ndodhet shkelësi i pretenduar,

duhet ta mbajnë atë në arrest ose të merren masa të tjera në mënyrë që të sigurohet prania e tij, për aq kohë sa është e nevojshme, për të bërë të mundur ndërmarrjen e çfarëdo procedure penale ose ekstradimi. Kur fillojnë hetimet ose procedurat penale, shtetet palë duhet t'i japin njëri-tjetrit masën më të madhe të ndihmës. Kjo Konventë nuk do të zbatohet atje ku shkelja kryhet brenda një shteti të vetëm, pengu dhe shkelësi i pretenduar janë shtetas të atij shteti dhe shkelësi i pretenduar gjendet në territorin e atij shteti. Mosmarrëveshjet midis dy ose më shumë shteteve, kur nuk zgjidhen me bisedime midis tyre, çdonjëra prej tyre mund të paraqesë mosmarrëveshjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Gjithashtu, çdo shtet palë mund të denoncojë këtë Konventë me anë të njoftimit me shkrim, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Ligji me të cilin aderohet në këtë Konventë ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 6.12.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.57 të vitit 2001, në faqen 1809. Ligjit i bashkëlidhet Konventa.

**Ligji nr.8838, datë 22.11.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e OBPI-së “Për të drejtën e autorit”.** Traktati i lartpërmendur është miratuar në Gjenevë në vitin 1997 dhe është një marrëveshje e veçantë brenda kuptimit të nenit 20 të Konventës së Bernës, për mbrojtjen e punëve artistike dhe letrare për palët kontraktuese që janë vende të Bashkimit Europian. Ky traktat bëhet pjesë organike e Konventës së Bernës të 24 korrik 1971 dhe asgjë në këtë traktat nuk varion nga detyrimet ekzistuese që palët kontraktuese kanë ndaj njëri-tjetrit në Konventën e Bernës, lidhur me mbrojtjen e punëve artistike dhe letrare. Traktati shpjegon se ku shtrihet mundësia e mbrojtjes së të drejtës të autorit, trajton të drejtën e marrjes me qira të veprave, të drejtën e komunikimit me publikun, kufizimet dhe përjashtimet etj. Gjithashtu, aty trajtohen kufizimet e mundshme të mbrojtjes së disa veprave të veçanta të shtetasve të disa vendeve jashtë Bashkimit, të drejtat morale për të deklaruar autorësinë, afatet e mbrojtjes



së veprave të autorësisë së përbashkët, e drejta e përkthimit dhe e riprodhimit, si dhe e drejta për disa përdorime të lira të veprave. Me interes janë dispozitat për të drejtat në veprat muzikore dhe dramatike, të drejtat e radiopërhapjes, komunikimet e tjera me kabëll, e drejta e recitimit publik, e drejta e përkthimit dhe e përshtatjes, e rregullimit dhe ndryshimeve të tjera, të drejtat kinematografike, përshtatja dhe riprodhimi kinematografik. Në fund të Traktatit gjendet shtojca me dispozita të veçanta përsa i përket vendeve në zhvillim, duke mbajtur parasysh situatën ekonomike të tyre, nevojat kulturore dhe sociale etj. Ky Traktat është miratuar me ligjin nr. 8838, datë 22.11.2001, i cili ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi në 6.12.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 57 të vitit 2001, në faqen 1815. Ligjit i bashkëlidhet Traktati, i cili gjendet i botuar në Fletoren Zyrtare nr.61 të vitit 2001, në faqen 1909.

**Ligji nr.8839, datë 22.11.2001 “Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor”.** Ky ligj përcakton rregullat për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor, në shërbim të ruajtjes së rendit dhe të sigurisë publike, si dhe të parandalimit dhe zbulimit të krimeve. Sipas këtij ligji, Policia e Shtetit është zotëruese e informacionit të klasifikuar policor dhe e përdor atë duke respektuar garancitë kushtetuese për liri dhe të drejtat e njeriut. Informacion i klasifikuar policor konsiderohen të gjitha aktet, dokumentet zyrtare, regjistrimet audiovizuale, kompjuterike, si dhe çdo material që ka të dhëna, të cilat lidhen me veprimtarinë e policisë, sidomos me rendin, sigurinë publike, strukturën e policisë, shërbimin e ruajtjes së kufirit shtetëror, sigurimin e personaliteteve të larta shtetërore etj. Në këtë ligj trajtohen gjithashtu edhe probleme të grumbullimit, trajtimit dhe administrimit të këtij informacioni, pasojat e shkeljeve të këtyre rregullave etj. Ligji ka 15 nene dhe ka hyrë në fuqi më 6.12.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 57 të vitit 2001, në faqen 1816.

**Ligj nr.8840, datë 11.12.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999, nr.8519, datë 30.7.1999, nr.8552, datë 18.11.1999, nr.8581, datë 17.2.2000, nr.8651, datë 28.7.2000 dhe nr.8713, datë 15.12.2000”.** Siç shihet nga titulli i ligjit, më datën 28.12.1998 është miratuar ligji nr.8435 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”. Qysh nga ajo kohë e deri në miratimin e ligjit nr.8840, datë 11.12.2001 kanë kaluar plot 3 vjet dhe ligji i parë ka pësuar 7 ndryshime. Në këto kushte do të ishte e vështirë një paraqitje e plotë se çfarë të re sjellin këto shtesa e ndryshime, prandaj do të rishikojmë ato më kryesoret. Kështu, kanë ndryshuar taksat për importimin e automjeteve të përdorura (autovetura, autobuzë, furgonë e traktorë rrugorë (kokat tërheqëse). Po ashtu, kanë ndryshuar taksat vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive, taksat e mbikalimeve ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është vendosur taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë të pasurisë së luajtshme (automjete). Ligji prek edhe taksat portuale, taksat e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve, taksat vendore (sipas klasifikimit e ndarjes së territorit nga zyrat e urbanistikës etj.). Ligjit i bashkëlidhen listat e plota të tipit të automjetit dhe të llojit të shërbimeve si dhe masa e taksës. Ligji ka 9 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.1.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.58 të vitit 2001, faqe 1825.

**Ligj nr.8841, datë 11.12.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ndryshuar me ligjin nr.8711, datë 15.12.2000”.** Me ligjin e lartpërmendur, shtesa e ndryshime janë bërë sidomos në nenin 2, i cili shpjegon përkufizimet që përmenden në përmbajtjen e ligjit. Ky nen ka ndryshuar krejtësisht. Këtu u jepet shpjegim termave si për shembull: “person”, “person fizik”, “person juridik”, “ortakëri”, cilët konsiderohen “persona të lidhur” (duke saktësuar se këtu hyjnë bashkëshortët, prindërit e tyre ose fëmijët e tyre) etj. Në këtë

nen ka edhe disa përkufizime të tjera. Në ligj ka një shtesë edhe në nenin që parashikon dënimet. Kështu, ndërsa në nenin pasardhës (neni 31) shtohet fakti që përbën shkelje plotësimi i pasaktë dhe moskuadrimi i të dhënave të pasqyrave të bilancit kontabël, anekseve të tij dhe të dhënave të tjera të kërkuara nga ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”; në nenin 32 shtohet një pikë (pra një shkelje), e cila dënon me gjobë në masën 25 mijë lekë shkeljet që u përmendën më lart. Me këtë ligj, gjithashtu, shtohet në tatimin mbi të ardhurat edhe pagesa për qiratë, pra, për çdo të ardhur nga qiratë do të paguhet tatim. Me gjithë këto dhe ndryshime të tjera që janë bërë me këtë ligj, ai në mënyrë të shprehur thekson se tatimpaguesit që kanë gëzuar lehtësi dhe përjashtime me ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin” dhe me ligjin nr.8089, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit” si dhe me dekretin nr.782, datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve”, do t’i gëzojnë lehtësitë, sipas kushteve të parashikuara në këto ligje. Ligji ka 12 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.1.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.58 të vitit 2001, faqe 1831.

**Ligj nr.8842, datë 11.12.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, ndryshuar me ligjin nr.8715, datë 15.12.2000”.** Ndryshimet me këtë ligj bëhen kryesisht në nenin 3 dhe kanë të bëjnë me tatimin me kuotë fikse. Me ligjin nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël” është bërë ndarja e qyteteve në tri kategori. Ndarja është për efekt të masës së kuotës së tatimit fiks. Kjo ndarje, që është bërë në vitin 1998, ruhet si kategorizim edhe me ndryshimet që bën ligji i lartpërmendur. Tatimi me këtë kuotë fikse bëhet për biznese të tilla si tregtia me pakicë, riparimet, shërbimet, tregtia ambulante, transporti, si dhe disa shërbime të tjera të thëna në mënyrë taksative. Në përgjithësi, ka shtesë të kuotës fikse dhe kjo kryesisht për qytetet e kategorisë së parë dhe më pak për kategorinë e dytë. Përsa i përket transportit, kuota fikse ndërvaret nga lloji i automjetit, numri i vendeve

për transportin e udhëtarëve dhe nga lloji i automjetit, si dhe tonazhi për transportin e mallrave. Ndryshimet në nenin 9 të ligjit në fuqi kanë të bëjnë me masën e gjobës për shkeljet që bëhen ndaj urdhërimeve të ligjit. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.1.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.58 të vitit 2001, në faqen 1834.

## **Reforms on the security and defence sphere, Albania's priorities**

*Speech of the President of Republic, Dr. Alfred MOISIU,  
delivered in the International Conference  
“Strengthening of Democratic Control in the Armed Forces”,  
Tirana, November 15, 2002*

*Ladies and Gentlemen,*

First of all I would like to thank you for the organisation of this conference and for the invitation to participate and deliver this speech with you, on the issues of country security and reformation of our Armed Forces.

Security issues are complex, but in this introduction I will try to treat of some of the main problems which, in my opinion, play a priority role in security and protection, on domestic or regional levels.

In January 2002, we approved the document “Security Strategy and Defence Policy of the Republic of Albania”. On August 9, 2002, I decreed the document “Military Strategy of the Republic of Albania”, approved by the Parliament of the Republic, on July 25, 2002. These documents are a serious reflection on the current geo-political situation of the environment we live, of the risks and threats of our national security, political, economic, legislative, and military capabilities, thus, being a realistic analysis of our national strength, to prevent and face then when necessary. These Documents are another evidence showing that our country is interested and will work with all its energies for stability and peace in our region, and will likewise confine rigorously to the its international obligations.

The Republic of Albania is located exactly in this geo-political environment, which has historically been characterised by substantial phenomena. Only during the last decade, we experienced consecutive conflicts, which have drastically damaged the reciprocal faith among the countries of the region, have caused innumerable human and material losses, and have damaged the political, economic, social and military institutions of the region. Many of these negative consequences take plenty of time to regenerate.

Today, the opportunity of inter-state conflicts in the region is reduced and security is enhanced and well kept under control from the active presence of NATO and EU. There is a growing awareness of the peoples to give up the logic confrontation, the dominating wish of one ethnic group to the other, the support of those regressive flows which manipulate the patriotic and nationalistic feelings of the people and that view violence as the sole instrument of solution. Important achievements are also seen in the economic, cultural and economic co-operation among the countries of the region, up to the creation of a South-eastern European Brigade. (SEEGRNG)

